

Grup autoresh

Libër për mësuesin

Letërsia

12

BOTIME



BOTIME



Korrektor letrar: Arlon LIKO
Paraqitja grafike: Elvis BEJTJA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë

© Botime Pegi, Qershor 2018

Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht të zotëruara nga Botime Pegi shpk. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim, përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Spektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies për lëndën letërsi përfshin:

- Planifikimin vjetor
- Planifikimin për secilën periudhë (Shtator-Dhjetor; Janar-Mars; Prill-Qershor)
- Planifikimin ditor

Në fillim të vitit shkollor, mësuesi/ja duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndës, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator-dhjetor). Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi/ja mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi/ja mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë, mësuesi/ja planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar te arritjet e kompetencave kyçe dhe të fushës/lëndës.

Planifikimi vjetor i lëndës letërsi

Për planifikimin vjetor të lëndës, mësuesi/ja, përveç programit mësimor duhet të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi/ja sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

Plani vjetor është një plan sintetik. Mësuesi/ja planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tri periudha. Periudhat janë:

- periudha e parë: Shtator-Dhjetor;
- periudha e dytë: Janar-Mars;
- periudha e tretë: Prill-Qershor.

KOMPETENCAT E LËNDËS:

Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.

Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

KOMPETENCAT KYÇE:

- Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit
- Kompetenca e të menduarit
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë
- Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin
- Kompetenca qytetare
- Kompetenca personale
- Kompetenca digjitale

Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së letërsisë gjatë shkallës së gjashtë.

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi/ja:

- shpreh para një audience të caktuar mësimore çështjet kryesore të ngritura në një fjalim ose interpretim të dëgjuar për një temë të caktuar nga fusha të ndryshme, përmes të paktën një forme komunikimi (gjuhës, simboleve, shenjave, kodeve, performancës artistike etj.);
- lexon rrjedhshëm një tekst të panjohur në gjuhën e huaj, i cili përmban 2-3 faqe (tregim letrar, tekst argëtues, artikull gazete ose reviste etj.), identifikon ngjashmëritë dhe dallimet kryesore në strukturën e fjalive në gjuhën e huaj dhe në gjuhën amtare, duke nënvizuar dhe duke ilustruar me shembuj konkretë;
- përdor drejt strukturën dhe rregullat standarde të drejtshkrimit të gjuhës amtare dhe të gjuhës së huaj në një numër të caktuar të konteksteve, si: ese, *e-mail*, letër formale dhe joformale etj.;
- lexon rrjedhshëm një tekst të përbërë prej disa paragrafesh dhe shprehet në forma të ndryshme të komunikimit për organizimin, qëllimin dhe leksikun e përdorur, si dhe argumenton mesazhin që bart çdo paragraf;
- prezanton një temë të caktuar nga arti, nga shkenca, nga jeta e përditshme dhe komunikon në mënyrë efektive me audiencën duke përdorur TIK-un dhe mediat e tjera të shkruara dhe elektronike;
- shpreh mendimin e lirë, opinionin dhe qëndrimin për një temë të caktuar nga jeta, nga shkenca, nga profesioni, nga shoqëria, nga mjedisi, duke përdorur forma të ndryshme të komunikimit me gojë e me shkrim, të artit pamor, muzikor, skenik, krijimin letrar etj.;
- angazhohet dhe kontribuon në një diskutim me të tjerët për një temë të caktuar, si p.sh., për edukimin mediatik, duke paraqitur argumente të bazuara në fakte për rolin dhe ndikimin e televizionit, radios, shtypit dhe mjeteve të tjera të informimit në shoqëri, në procesin e përgatitjes së të rinjve për jetë të pavarur dhe orientim në karrierë;
- përdor në mënyrë efektive programet e TIK-ut gjatë procesit të të nxënit dhe kryerjes së detyrave në një fushë të caktuar mësimore.

Kompetenca e të menduarit

Nxënësi/ja:

- sqaron ecurinë e zgjidhjes së një problemi në klasë apo jashtë saj, duke e vërtetuar zgjidhjen përmes metodës së analizës, dhe e prezanton para moshatarëve apo para të tjerëve;
- analizon në mënyrë të pavarur informacionet e marra nga burimet e ndryshme për një temë ose detyrë të dhënë, vlerëson cilësinë e tyre dhe i radhit ato sipas rëndësisë dhe qëllimit që kanë (temat mund të jenë: orientimi në karrierë, integrimet evropiane, ndryshimet klimatike, rreziqet nga armët konvencionale, armatimi bërthamor, zhvillimi kulturor-artistik në vend etj.);
- hulumton në mënyrë të pavarur për një çështje të caktuar, duke përcaktuar fazat dhe procedurat e hulumtimit, paraqet dhe interpreton rezultatet e fituara në tabela dhe grafikë, duke përdorur teknologjinë e informacionit;
- identifikon burimet e informacioneve të nevojshme dhe i shfrytëzon ato në mënyrën e duhur për të zgjidhur një problem, duke dhënë shembuj konkretë.

Kompetenca e të nxënit

Nxënësi/ja:

- demonstroi shkathtësi të përdorimit të TIK-ut në situata të përditshme dhe në përmbushjen e kërkesave të ndryshme gjatë të nxënit (për ndërtimin e tabelave, grafikëve apo diagrameve, për vizatimin e një

- plani të shtëpisë, për përgatitjen e shkresave dhe prezantimeve etj.);
- diskuton në grup për mënyrat e bashkëpunimit me të tjerët për të zgjidhur një situatë mësimore të re ose një problem nga jeta e përditshme, ose për të menaxhuar konfliktet me bashkëmoshatarë; tregon mënyrën e shfrytëzimit të përvojave paraprake për të zhvilluar njohuritë dhe shkathtësitë e reja në zgjidhjen e situatave dhe problemeve të tilla;
- shfrytëzon në mënyrën e duhur këshillat dhe informacionet e marra për përkrahje në zgjidhjen e një detyre apo problemi të caktuar, pastaj rezultatet i paraqet para të tjerëve;
- përpunon në mënyrë të pavarur dhe efektive informacionet për një temë të caktuar;
- paraqet një plan studimi (në formë skice, vizatimi, shkrimi etj.) për ndonjë çështje të caktuar (p.sh.: për vlerat kulturore të rajonit të vet, për vlerat e edukimit në shoqëri etj.), duke respektuar të gjithë hapat e planit të studimit, dhe e paraqet para të tjerëve;
- përzgjedh punimet kryesore të dosjes së vet për të shpjeguar para një audience të caktuar strategjitë që ka përdorur për të ndjekur avancimin e vet dhe masat e zbatuara për të përmirësuar përparimin në mënyrë të vazhdueshme;
- vlerëson, në mënyrë kritike, punën e vet duke iu referuar qëllimeve fillestare të punës, p.sh., redakton në mënyrë të pavarur një dorëshkrim të tij për përmirësimin e organizimit të shkrimit, qartësisë së mendimit etj.;
- menaxhon në mënyrë produktive burimet që ka në dispozicion (kohën, njerëzit, mjetet e konkretizimit/ të punës etj.), gjatë kryerjes së një aktiviteti ose detyre të caktuar në një fushë mësimore apo në situata të jetës së përditshme.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi/ja:

- paraqet, nëpërmjet njëres prej formave të shprehjes, kompetencat e nevojshme për të përballuar situata të ndryshme jetësore apo për zhvillim të karrierës në një fushë të caktuar;
- merr nisma të suksesshme për organizimin e veprimtarive të ndryshme që nxisin bashkëpunimin e ndërmarrjeve me komunitetin, duke promovuar interesin e dyanshëm.

Kompetenca personale

Nxënësi/ja:

- tregon shkathtësi në organizimin e lojërave me të tjerët, garave sportive, apo veprimtarive kulturore dhe menaxhon me sukses emocionet e veta në situata të ndryshme gjatë jetës së përditshme;
- prezanton, në formë të ndryshme shprehëse, mënyrën e zbatimit të planeve personale të jetës (në shkollim, në karrierë, në sport, në shoqëri, në biznes etj.), vlerëson nivelin e arritjeve të qëllimeve të synuara dhe ilustron shembuj të veçantë të planeve personale për të ardhmen;
- shpreh në formë të ndryshme qëndrimin e vet të pavarur për përgjegjësinë e të qenit prind/ kujdestar, për planifikimin e familjes dhe merr vendime të drejta për të ardhmen e tij.

Kompetenca qytetare

Nxënësi/ja:

- prezanton, në formë të ndryshme, se si i ushtron të drejtat e veta në shkollë dhe në jetën e përditshme dhe si i njeh e i respekton të drejtat e të tjerëve, duke dhënë shembuj konkretë;
- paraqet, në formë të ndryshme të të shprehurit, vlerat kryesore të shumëllojshmërisë në shoqëri apo në mjedisin ku jeton, i diskuton ato me të tjerët duke i krahasuar me shembuj nga jeta e përditshme që tregojnë tolerancë, respekt dhe qëndrim të hapur ndaj dallimeve;
- merr pjesë në proceset demokratike të vendimmarrjes në nivele të ndryshme (në familje, në shkollë, në komunitet etj.), i diskuton me të tjerët përvojat personale dhe paraqet propozime të argumentuara se si të përmirësohet pjesëmarrja demokratike dhe vendimmarrja në shoqëri.

Kompetenca digjitale

Nxënësi/ja:

- përdor në mënyrë efektive programet e TIK-ut për të komunikuar dhe për të bashkëpunuar me bashkëmoshatarët gjatë procesit të të nxënës, duke përfshirë edhe të nxënës në distancë;
- vlerëson cilësinë e informacionit të gjetur nga shumëllojshmëri burimesh dhe mediash;
- është aktiv dhe i pavarur në procesin e të nxënës për gjetjen dhe përdorimin e metodologjive që lehtësojnë këtë proces.

Kompetencat e lëndës dhe përshkrimi i tyre

Lënda e letërsisë synon të formojë dhe të zhvillojë te nxënësit dy kompetenca:

- Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.
- Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

Puna për zhvillimin e këtyre kompetencave nuk duhet të bëhet e ndarë dhe e fragmentarizuar. Në procesin mësimor, gjatë çdo ore mësimore punohet për formimin e të dyja kompetencave. Kështu p.sh., nxënësi analizon dhe interpreton një poemë të Bajronit me të gjitha veçoritë e saj dhe, gjithashtu, gjykon dhe vlerëson tiparet kryesore të krijimtarisë së Bajronit dhe të letërsisë romantike. Pra, nxënësi e studion veprën në thellësi, por edhe raportin e saj me krijimtarinë e autorit dhe me periudhën letrare ose historike.

Përshkrimi i kompetencave

a) Analiza dhe interpretimi i teksteve të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare.

Nxënësit fitojnë teknikat e analizës së veprave letrare, të cilat do t'u shërbejnë në shkollë dhe në jetë. Ata analizojnë dhe interpretojnë, si lexues kritikë dhe të pavarur, vepra të gjinive dhe të llojeve të ndryshme letrare. Duke studiuar tiparet kryesore të gjinive dhe të llojeve letrare, nxënësit marrin njohuritë dhe fitojnë aftësitë e nevojshme për ta kuptuar më mirë natyrën e letërsisë. Këto tipare, nxënësi nuk i mëson thjesht në mënyrë teorike, por të konkretizuara në veprat ose fragmentet letrare. Gjatë tri viteve, nxënësit do të lexojnë dhe do të punojnë me tekste poetike, dramatike dhe tekste në prozë.

Gjatë analizës dhe interpretimit të veprave letrare, nxënësit dallojnë edhe mjetet e shumta e gjuhës, të cilat janë përdorur për të krijuar tekste jo vetëm me kuptim, por edhe estetikisht **të bukura**.

b) Vlerësimi i letërsisë shqipe dhe asaj botërore në periudha të ndryshme letrare dhe historike.

Nxënësit krijojnë një pasqyrë të qartë:

- të fazave të ndryshme të zhvillimit të letërsisë shqipe dhe të letërsisë botërore;
- të lidhjeve mes periudhave të ndryshme historike dhe drejtimeve letrare;
- të gjinive letrare, të autorëve dhe veprave më përfaqësuese të një periudhe historike ose të një drejtimi letrar.

Gjatë arsimit të mesëm të lartë, mësimi i letërsisë përqendrohet në karakteristikat kryesore të një periudhe, duke u dhënë mundësi nxënësve të krijojnë një ide të përgjithshme rreth origjinës, përhapjes dhe tipareve të një drejtimi letrar, si dhe të gjinive e të llojeve që lëvrohen.

Përzgjedhja e veprave letrare që studiohen **përgjatë tri viteve**, bëhet duke respektuar një raport të drejtë mes letërsisë shqipe dhe asaj botërore. Letërsia shqipe do të studiohet paralelisht me letërsinë botërore duke u kushtuar vëmendje të përbashkëtave dhe dallimeve mes tyre. Në këtë mënyrë, nxënësit do të kuptojnë që letërsia shqipe nuk është një njësi e veçantë dhe e ndarë, por pjesë e pasurisë letrare botërore.

PLANI MËSIMOR**FUSHA: GJUHËT DHE KOMUNIKIMI****LËNDA: LETËRSI****KLASA XII****Plani sintetik****34 javë x 2 orë = 68 orë**

	Kompetencat e fushës		Shkathtësitë që do të realizohen në komunikim përmes:	Orë
1.	Kompetencat që do të zhvillojë nxënësi/ja: - E komunikimit dhe të shprehurit - E të menduarit - E të nxënës - Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Personale - Qytetare - Digjitale	68%	Njohuri të reja në: - Rryma letrare - Jetë dhe vepër autori - Analizë vepre - Komente, analizë, gjykim dhe vlerësim fragmentesh nga veprat e autorëve të programit mësimor	46 orë
2.	Përpunim njohurish duke: - Analizuar dhe interpretuar tekste të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare. - Vlerësuar tregues të pjesshëm dhe të plotë nga letërsia shqipe dhe botërore të shekullit XX. - Diskutuar dhe analizuar në biseda letrare dhe duke interpretuar në projekte të ndryshme. - Konkluduar në situata vlerësuese përmes testeve të ndryshme.	32%	Përpunim njohurish	22 orë
			Biseda letrare	2 orë
			Testime	3 orë
			Ese	3 orë
			Projekt	4 orë
			Vlerësim portofoli	2 orë
			Dramatizim	2 orë
			Përgatitje për provimet e Maturës Shtetërore	6 orë
	Gjithsej	100%		68 orë

KOMPETENCA: ANALIZA DHE INTERPRETIMI I TEKSTEVE TË GJINIVE DHE LLOJEVE TË NDRYSHME LETRARE

Rezultatet e të nxënës për këtë kompetencë

Nxënësi/ja:

- bën dallimin mes llojeve dhe gjinive letrare në veprat që studion dhe i analizon ato duke u mbështetur në karakteristikat e llojit dhe të gjinisë;
- analizon lloje të ndryshme prozash, si dhe jep shembuj të autorëve që i kanë lëvruar;
- përcakton temën dhe idetë, analizon personazhet dhe marrëdhëniet mes tyre, i lidh elementet e mësipërme me jetën dhe botën rreth tij, ilustron me detaje nga teksti idetë dhe interpretimet e tij;
- përcakton gjininë dhe motivet kryesore në tekstet poetike, formulon idetë e tij dhe analizon gjuhën e figurshme; shpjegon elementet e tekstit letrar dhe figuracionin letrar dhe i përdor ato gjatë analizës së gjuhës dhe stilit të këtyre veprave.

Njohuritë

Elementet e tekstit letrar

- Fabula dhe subjekti.

Dallimi mes tyre.

- Tema dhe motivet.
- Rrëfimtari, autori dhe lexuesi.
- Format e rrëfimit.
- Sistemi i personazheve.

Marrëdhëniet kryesore mes personazheve.

- Mjedis, koha dhe atmosfera.
- Stili. Gjuha e një veprë letrare.
- Llojet e poezisë lirike.

Shkathësitë

Elementet e tekstit letrar

Fabula dhe subjekti

Nxënësi/ja:

- rrëfen dhe analizon subjektin duke e ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti ose fragmenti;
- përcakton dhe analizon fabulën e një teksti;
- bën dallimin mes fabulës dhe subjektit;
- analizon ngjarjet kryesore të një teksti;
- dallon ngjarjet që shënojnë hyrjen, pikën e lidhjes, zhvillimin, pikën kulmore, zgjidhjen, si dhe shpjegon funksionin dhe rëndësinë e tyre;
- dallon konfliktin/konfliktet në një tekst dhe shpjegon mënyrën se si zgjidhen ato në vepër;
- analizon marrëdhëniet mes skenave të veçanta (skena, episode, pamje) dhe tekstit si i tërë;
- përshkruan strukturën narrative në një tekst dhe jep argumentet e tij rreth përzgjedhjes së saj nga autori;
- shpjegon efektet e teknikave të tilla në organizimin ose strukturën e tekstit letrar, si p.sh.: dukurinë e anakronisë (flashback-ut), paralajmërimit etj.

Personazhet

Nxënësi/ja:

- analizon dhe vlerëson personazhet duke u bazuar në përshkrimet e autorit dhe në mendimet, fjalët, veprimet, bindjet etj.;
- analizon se si ndryshon ose zhvillohet një personazh;

- evidenton ngjashmëritë dhe dallimet mes personazheve (karakteri, sjelljet etj.);
- analizon marrëdhëniet mes personazheve, si p.sh., ndikimi që ka një personazh te një personazh tjetër;
- dallon llojet e personazheve (realë, historikë, të trilluar, mitologjikë, të jashtëzakonshëm, kryesorë, dytësorë);
- shpreh dhe argumenton pëlqimet e tij për një personazh;
- interpreton simbolikën e një personazhi (nëse ka të tillë);
- analizon ndërlikimin e marrëdhënieve njerëzore dhe të sjelljes së njeriut përmes studimit të personazheve.

Mjedisi, koha dhe atmosfera

Nxënësi/ja:

- përshkruan dhe analizon mjedisin dhe kohën në një vepër letrare;
- veçon mjetet artistike që përdor autori për të dhënë mjedisin dhe kohën;
- përshkruan ndikimin e tij emocional dhe psikologjik nga leximi i një vepre letrare;
- analizon gjendjen emocionale që krijohet nga mjedisi, koha apo rrethanat e një teksti.

Tematika

Nxënësi/ja:

- dallon temën dhe motivet e një teksti;
- analizon dhe shpjegon mënyrën që zgjedh autori për të shtjelluar një temë ose një motiv të caktuar;
- demonstroi vetëdije në lidhje me faktin që zhvillimi i një teme (ose motivi) nga një shkrimtar zbulon një pamje ose një aspekt të veçantë të jetës.

Stili dhe gjuha

Nxënësi/ja:

- veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst;
- analizon dhe vlerëson gjuhën e figurshme;
- vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti.

Konteksti historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror

Nxënësi/ja:

- gjykon rreth kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror në të cilin është shkruar një tekst;
- shpjegon se si konteksti ndikon në vepër.

Lidhja mes tekstit dhe lexuesit

Nxënësi/ja:

- tregon se si përvojat personale, vlerat, besimet e tij mund të ndikojnë në mënyrën se si ai e kupton dhe e interpreton një tekst;
- tregon se si një tekst e informon lexuesin rreth natyrës njerëzore.

Reflektimi ndaj tekstit

Nxënësi/ja:

- formulon mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij rreth tekstit, duke e lidhur atë me njohuritë e mëparshme;
- reflekton në mënyrë kritike përmes analizave, interpretimit, vlerësimit, krahasimit dhe sintezës së tekstit;
- shprehet në mënyra të ndryshme për tekstet që lexon, si p.sh.: dramatizime, ese, punë krijuese me shkrim, muzikë, pikturë etj.

Ndërtimi dhe komunikimi i argumenteve

Nxënësi/ja:

- mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti;
- organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me gojë dhe me shkrim).

**KOMPETENCA: VLERËSIMI I LETËRSISË SHQIPE DHE ASAJ BOTËRORE NË PERIUDHA TË
NDRYSHME LETRARE DHE HISTORIKE**

Rezultatet e të nxënit për këtë kompetencë

Nxënësi/ja:

- analizon dhe vlerëson karakteristikat kryesore të letërsisë së shekullit XX, drejtimet kryesore letrare, gjinitë letrare që u lëvruan, si dhe autorët përfaqësues dhe veprat e tyre;
- analizon dhe vlerëson periudhat kryesore në letërsinë shqipe të shekullit XX, grupimet dhe drejtimet letrare, autorët përfaqësues dhe veprat e tyre;
- analizon në rrafsh krahasues vlerat e letërsisë shqipe dhe asaj evropiane dhe botërore;
- analizon dy vepra letrare dhe përcakton të përbashkëtat dhe ndryshimet mes tyre;
- gjykon për vlerat njerëzore, etike dhe estetike që gjejnë shprehje në krijimtarinë letrare, si dhe shpjegon preferencat ose pëlqimet e tij në letërsi.

Shënim: 6 orë mësimore do të përdoren për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore. Këto orë mund të planifikohen përgjatë vitit shkollor ose në fund të tij.

TEMATIKA	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES LËNDORE		
	SHTATOR-DHJETOR (26 orë)	JANAR-MARS (24 orë)	PRILL-MAJ (18 orë)
Elementet e tekstit letrar	Elementet e tekstit letrar - Fabula dhe subjekti. Dallimi mes tyre. - Tema dhe motivet. - Rëfimtari, autori dhe lexuesi. - Format e rëfimit. - Sistemi i personazheve. Marrëdhëniet kryesore mes personazheve. - Mjedisi, koha dhe atmosfera. - Stili. Gjuha e një veprë letrare. - Llojet e poezisë lirike. - Poema epike. - Rimi dhe vargu (edhe vargu i lirë). Rima dhe llojet e saj. Strofa, funksioni dhe llojet e saj.		
Letërsia botërore e shekullit XX	Letërsia botërore gjatë gjysmës së parë të shekullit XX Kushtet historike dhe shoqërore të gjysmës së parë të shekullit XX. Zhvillimet e shkencës në shekullin XX që patën ndikim në letërsi. Veçoritë e përgjithshme të letërsisë së shekullit XX, si: larmia e drejtimeve letrare, individualitetet krijuese të spikatura dhe origjinale, veçori kombëtare të krijesve. Prija realiste e letërsisë së shekullit XX. Lidhja me letërsinë e traditës dhe risitë. Drejtimit, përfaqësuesit kryesorë, gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan. Prija moderniste e letërsisë. Pararendësit e letërsisë moderne. Përfaqësuesit kryesorë. Gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan. Franc Kafka. Momentet kryesore të jetës së Kafkës, të cilat ndikuan në krijimtarinë letrare të tij. Faktorët objektivë historikë që ndikuan në veprën e Kafkës. Qëndrimi i Kafkës ndaj burokratizmit, gjyqit dhe vetëgjyqësisë, lirisë etj. Tematika kryesore e krijimtarisë letrare të Kafkës. Veçoritë kryesore të krijimtarisë së Kafkës (konceptimi universal, humanizmi, situatat absurde etj).		
Letërsia botërore gjatë gjysmës së parë të shekullit XX			

TEMATIKA	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES LËNDORE		
	SHTATOR-DHJETOR (26 orë)	JANAR-MARS (24 orë)	PRILL-MAJ (18 orë)
	Albert Kamy. Momentet kryesore të jetës dhe të veprës së Kamysh. Evoluimi krijues i Kamysh. Ekzistencializmi në artin e Kamysh. Absurdi i qenies njerëzore, vetmia etj.		
Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shekullit XX	Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shekullit XX. Kushtet historike e shoqërore gjatë gjysmës së parë të shekullit XX. Risetë e letërsisë së kësaj periudhe. Shkrimtarët që me krijimtarinë e tyre janë urë lidhëse me letërsinë e shekullit XIX (Asdreni, Mjeda). Krijimtaria letrare e kësaj periudhe dhe përfaqësuesit, si: Konica, Fishta, Noli, Migjeni, Poradeci, Migjeni, Koliqi, Kuteli etj. Gjergj Fishta. Kontributi i Gjergj Fishtës në botën shqiptare (publicistikë, letërsi, politikë etj.). Momentet kryesore të jetës së Fishtës që ndikuan në krijimtarinë e tij. Veprat letrare të Fishtës në poezi dhe dramë. Idetë universale në veprën e Fishtës dhe mesazhet që i sjellin kohës sonë. Lasgush Poradeci. Poeti modern i shqipes. Momentet më të rëndësishme të jetës së Poradecit që ndikuan në krijimtarinë e tij. Veprat e Poradecit. Vendlindja dhe dashuria në jetën e Poradecit. Mbështetja në trashëgiminë poetike të Naimit dhe në letërsinë moderne të Evropës. Përsëritje për Maturën Shkretërore; bisedë letrare; testim; ese; projekt.	Migjeni. Fryma e re që solli Migjeni në letërsinë shqipe (në formë dhe në përmbajtje), si p.sh.: shprehja nga tradita, temat e ndaluara, vargu i lirë, shembja e kulteve politike, fetare etj. Burimet kryesore që përcaktuan formimin e Migjenit. Momentet kryesore të jetës dhe të veprës së tij. Njeriu në letërsinë e Migjenit (jeta në situata ekzistenciale).	
Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore		Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore. Kushtet historike, shoqërore dhe politike pas Luftës së Dytë Botërore. Dukuritë letrare. Letërsia shqipe në Kosovë dhe në diasporë. Dritëro Agolli. Risetë që solli Agolli në letërsinë shqipe. Momentet kryesore të jetës së Dritëro Agollit që ndikuan në krijimtarinë e tij. Veprimtaria shoqërore dhe politike e Agollit. Krijimtaria letrare e Agollit në poezi, prozë dhe dramë. Krijimtaria e Agollit pas viteve '90. Veçoritë e prozës së Agollit.	Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore. Martin Camaj. Momentet kryesore të jetës së Martin Camajt që ndikuan në krijimtarinë e tij. Risetë që solli Camaj në letërsinë shqipe. Fazat e krijimtarisë së Camajt. Camaj si poet dhe si prozator. Azem Shkreli. Momentet kryesore të jetës së Shkreli që ndikuan në krijimtarinë e tij. Veprat kryesore të Shkreli (në prozë dhe në poezi). Risetë që solli Shkreli në letërsinë shqipe.

TEMATIKA	SHPËRNDARJA E PËRMBAJTJES LËNDORE		
	SHTATOR-DHJETOR (26 orë)	JANAR-MARS (24 orë)	PRILL-MAJ (18 orë)
		Ismail Kadare. Veprimtaria e Kadaresë si artist dhe intelektual. Vendi që zë Kadare në letërsinë shqipe. Momentet kryesore të jetës së Kadaresë që ndikuan në krijimtarinë e tij. Poeti dhe prozatori. Krijimtaria letrare e Kadaresë para dhe pas viteve '90. Dramatizim; Përsëritje për Maturën Shretërore; bisedë letrare; testim; ese; projekt.	Tiparet e poezisë së Shkrelit. Dramatizim; Përsëritje për Maturën Shretërore; testim; ese; projekt.

Shënim: *Njohuritë mbi **Elementet e tekstit letrar** merren gjatë studimit dhe analizës së veprave letrare. prandaj janë konceptuar të shtrira përgjatë tri periudhave tremujore.*
Planifikimi sipas periudhave

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi/ja të përcaktojë me kujdes përmbajtjet mësimore që do të zhvillojë gjatë kësaj periudhe, orët mësimore brenda të cilave ato do të realizohen, duke planifikuar paraprakisht situatat e të nxëniet përmes të cilave do të mundësohet zhvillimi i kompetencave, burimet e të nxëniet, metodologjitë e mësimdhënies si dhe llojet e vlerësimit dhe instrumentet vlerësues.
Plani i një periudhe është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi/ja harton planin e periudhës përkatesë në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit mësimor përkates.
Në planet sipas periudhave planifikohen të gjitha orët. Mësuesit janë të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi në varësi të specifikave të lëndës së tyre.

Plani analitik

PËR TREMUJORIN E PARË (SHTATOR-DHJETOR)

	Njohuri të reja	Përpunim njohurish							
	Njohuri të reja	Përsëritje	Punë me projekt	Biseda letrare	Ese	Dramatizime	Vlerësim portofoli	Test	Totali
	20	1	2	1	1	-	-	1	26
Përqindja	76%	24%							

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe						
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës						
Nr .	Tematika/kapitulli	Temat mësimore	Situata e të nxënës	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1	Letërsia botërore e shekullit XX Letërsia botërore gjatë gjysmës së parë të shekullit XX	Letërsia botërore gjatë gjysmës së parë të shekullit XX. (1 orë)	Nxënësi/ja kupton se rrethanat historike, politike, shoqërore ndikojnë në letërsi.	Informacion i ri Stuhi mendimesh Reflektim dhe rifreskim njohurish-praktikë e drejtuar-punë e pavarur Diskutim Analizim Praktikë e pavarur Stuhi mendimesh Piramida e mendimit	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Teksti mësimor Fragmente të ndryshme nga letërsia e huaj dhe ajo shqiptare
2		Franc Kafka (4 orë) Momentet kryesore të jetës së Kafkës. Tematika kryesore e krijimtarisë letrare Veçoritë kryesore të krijimtarisë së Kafkës Analizë “Metamorfoza” Sfondi. Tematika, Personazhet, Gjuha dhe stili, Mesazhe.	Nxënësi/ja kupton, nëpërmjet kontekstit, se si përvoja letrare ndikon në ndërtimin e përvojave personale, vlerave dhe qëndrimeve që vlejnë më vonë në qasjen ndaj botës dhe perceptimin e saj.			Teksti mësimor Vepra artistike
3		<i>Studim teksti</i> “Metamorfoza” Zgjidhja e Gregorit	<i>Diskutohet mbi</i> frikën e ekzistencës që buron nga realiteti i përditshëm. Nevoja për t’u larguar nëpërmjet metamorfozës.	Kubimi Pesëvargëshi Diagrami i Venit Pyetje-përgjigje Hartë koncepti Hartë personazhesh Lexim i drejtuar	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike
4		<i>Studim teksti</i> “Metamorfoza” Fragmenti “Episodi i mollës”	<i>Studim teksti</i> Si do të silleshit nëse një ditë vëreni se ka		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti

			ndodhur një ndryshim i madh të ju?			Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish	
5		<i>Studim teksti “Metamorfoza”</i> Fragmenti “Vdekja e Gregorit	<i>Diskutim:</i> Çfarë i bën njeriut vetmia? Vetmia është zgjidhje, ndëshkim apo protestë?			Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
6		<i>Punë me projekt. Faza e parë. ora 1.</i> Përcaktohet tematika së bashku me nxënësit dhe ndahen grupet	Nxënësit diskutojnë dhe përzgjedhin temën e punës me projekt.				Portofoli i nxënësit
7		Albert Kamy (5 orë) Momentet kryesore të jetës dhe të veprës së Kamysë. Ekzistencializmi në artin e Kamysë. Absurdi i qenies njerëzore, vetmia etj.	Nxënësi/ja kupton, nëpërmjet kontekstit, se si përvoja letrare ndikon në ndërtimin e përvojave personale, vlerave dhe qëndrimeve që vlejné më vonë në qasjen ndaj botës dhe perceptimin e saj.	Informacion i ri Stuhi mendimesh Reflektim dhe rifreskim njohurish-praktikë e drejtuar-punë e pavarur Diskutim Analizim		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	
8		<i>Analizë “I huaji”</i> Sfondi. Tematika, Personazhet, Gjuha dhe stili, Mesazhe.	<i>Bisedë me temë:</i> Përplasja e këndvështrimeve të ndryshme çon drejt tragjedisë.			Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Teksti mësimor Vepra artistike
9		<i>Studim teksti</i> Fragmenti “Filmi i të dieles”				Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
10		<i>Studim teksti</i> Fragmenti “Porta e fatkeqësisë”	<i>Bisedë me temë:</i> Njeriu duhet të jetë	Diagrami i Venit Pyetje-përgjigje Hartë koncepti		Vlerësimi i punës në grup	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti

11		<i>Studim teksti</i> Fragmenti “Realiteti i huaj”	përgjegjës për veprimet e tij.	Hartë personazhesh Lexim i drejtuar	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
12		<i>Ese</i>	<i>Reflektim mbi temat që trajtohen në veprat e Kafkës dhe Kamysë</i>			Fletore të punëve me shkrim
13	Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shekullit XX	Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shekullit XX Gjergj Fishta (5 orë) Momentet kryesore të jetës së Fishtës. Veprat letrare të Fishtës në poezi dhe dramë. Idetë universale në veprën e Fishtës dhe mesazhet që i sjellin kohës sonë.	<i>Diskutim me temë:</i> Tradita epike në letërsinë tonë	Informacion i ri Stuhi mendimesh Reflektim dhe rifreskim njohurish- praktikë e drejtuar-punë e pavarur	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Teksti mësimor Vepra artistike
14		<i>Analizë</i> “Lahuta e Malcis” Rrethanat e lindjes së veprës, qëllimi. Konflikti bazë. Kulti i trimërisë. Idetë. Mesazhet. Personazhet e larmishëm.	Lahuta vegla arkaike muzikore me të cilën malësori i këndoi heroit, gëzimit, por dhe problematikave së jetës.	Diskutim Analizim Praktikë e pavarur Stuhi mendimesh	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup	Teksti mësimor Vepra artistike
15		<i>Studim teksti</i> Kënga I “Cubat”	Lexo hyrjen e “Iliadës” dhe të “Histori e Skënderbeut” të Naim Frashërit si dhe hyrjen e këngëve të Ciklit të Kreshnikëve.	Piramida e mendimit Kubimi Pesëvargëshi Diagrami i Venit Pyetje-përgjigje Hartë koncepti Hartë	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
16		<i>Studim teksti</i> Kënga II “Oso Kuka”	<i>Diskutim me temë:</i> Fataliteti heroik - Vetëflirimi në	personazhesh Lexim i drejtuar	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti

			letërsinë shqipe gojore dhe artistike. <i>Studim teksti</i>			
17		<i>Studim teksti</i> Kënga XXV “Gjaku i marrun”				Vlerësimi i punës në grup Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
18		Punë me projekt . Faza e parë. ora 2. Nxënësit paraqesin planin e punës individual.	Nxënësit paraqesin planin e punës individual dhe diskutojnë për hartimin e planit të grupit.			Portofoli i nxënësit
19		Lasgush Poradeci (5 orë) Momentet më të rëndësishme të jetës së Poradecit. Veprat e Poradecit. Vendlindja dhe dashuria në jetën e Poradecit.	Poeti modern i shqipes. Bisedë me temë: Vlerat e artit varen nga sasia apo cilësia? Kërkesat e larta të Lasgushit ndaj artit.	Informacion i ri Stuhi mendimesh Reflektim dhe rifreskim njohurish-praktikë e drejtuar-punë e pavarur Diskutim	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Teksti mësimor Vepra artistike
20		<i>Analizë</i> “Ylli i zemrës”	Poezia lirike si formë e shprehjes së unit të brendshëm		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup	Teksti mësimor Vepra artistike
21		<i>Studim teksti</i> “Vdekja e Nositit”	<i>Bisedë me temë:</i> Kontributi/Misioni i artistit, qytetarit të vetëdijshëm për rolin e tij në shoqëri dhe i prindit.	Analizim Praktikë e pavarur Stuhi mendimesh Piramida e mendimit Kubimi Pesëvargëshi Diagrami i Venit	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
22		<i>Studim teksti</i> “Poradeci”	Identifikimi i shpirtit të poetit me vendlindjen dhe atdheun		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti

23		<i>Studim teksti</i> “Ti po vjen që për së largu”	Diskutim me temë: Dashuria është jetë. Mali është pjesë e pandarë i dashurisë.	Pyetje-përgjigje Hartë koncepti Hartë personazhesh Lexim i drejtuar	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
24		Test (tremujori i parë)		<i>Punë e pavarur individuale</i>	<i>Vlerësim</i>	
25		Bisedë letrare	“Vallja e yjeve” Lasgush Poradeci	<i>Diskutim, Interpretim Shkrim funksional</i>	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	
26		Përsëritje për maturën shtetërore	<i>Letërsia botërore gjatë gjysmës së parë të shekullit XX.</i>		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	<i>Dosje e Maturës</i>

Plani analitik

PËR TREMUJORIN E DYTË (JANAR-MARS)

	Njohuri të reja	Përpunim njohurish							
	Njohuri të reja	Përsëritje	Punë me projekt	Biseda letrare	Ese	Dramatizime	Vlerësim portofoli	Test	Totali
	16	2	1	1	1	1	1	1	24
Përqindja	67%	33%							

Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe					
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave të fushës					
Nr.	Tematika/kapitulli	Temat mësimore	Situata e të nxënës	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi Burimet
27	Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shekullit XX	Migjeni (5 orë) Fryma e re që solli Migjeni në letërsinë shqipe (në formë dhe në përmbajtje). Burimet kryesore që përcaktuan formimin e Migjenit. Momentet kryesore të jetës dhe të veprës së tij.	Diskutim me temë: Vepra i parapriu jetës së autorit.	Informacion i ri Stuhi mendimesh Reflektim dhe rifreskim njohurish-praktikë e drejtuar-punë e pavarur Diskutim Analizim Praktikë e pavarur	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Teksti mësimor Vepra artistike
28		<i>Analizë</i> “Novelat e qytetit të veriut” dhe “Vargjet e lira”	Diskutim me temë: roli i mashkullit në familjen e shoqërinë tradicionale shqiptare. Femra inferiore.	Stuhi mendimesh Piramida e mendimit Kubimi Pesëvargëshi Diagrami i Venit Pyetje-përgjigje Hartë koncepti Hartë personazhesh Lexim i drejtuar	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup Teksti mësimor Vepra artistike
29		Studim teksti “Studenti në shtëpi” nga “Novelat e qytetit të veriut”	<i>Studim teksti</i>		Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
30		<i>Studim teksti</i> “Poema e mjerimit” nga vepra “Vargjet e lira”	Bisedë me temë: Mjerimi fizik sjell pasojë dhe në aspekte të tjera duke e çuar individin drejt rënies morale e mendore.		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti

31		<i>Studim teksti “Një natë pa gjumë” nga vepra “Vargjet e lira”</i>	Si ndihet një njeri i cili kupton se po prek fundin (po shkon drejt vdekjes) në planin personal dhe kur nuk sheh të realizuara ëndrrat e tij për shoqërinë ku jeton?		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
32		Bisedë letrare “Vargjet e Lira” <i>Migjeni</i>	Llojet e vargjeve Shpirti i lirë i një të riu me vetëdije të lartë gjen shprehjen e tij te vargu i lirë në formë dhe përmbajtje.	Diskutim <i>Punë e pavarur individuale</i>	<i>Diskutim Interpretim Shkrim funksional</i>	Portofoli i nxënësit
33	Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore	Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore (1 orë) Kushtet historike, shoqërore dhe politike pas Luftës së Dytë Botërore. Dukuritë letrare. Letërsia shqipe në Kosovë dhe në diasporë.	Nxënësi/ja kupton, nëpërmjet kontekst, se si përvoja letrare ndikon në ndërtimin e përvojave personale, vlerave dhe qëndrimeve që vlejnë më vonë në qasjen ndaj botës dhe perceptimin e saj.	Informacion i ri Stuhi mendimesh Reflektim dhe rifreskim njohurish-praktikë e drejtuar-punë e pavarur Diskutim Analizim Praktikë e pavarur Stuhi mendimesh Piramida e mendimit Kubimi Pesëvargëshi Diagrami i Venit Pyetje-përgjigje Hartë koncepti Hartë personazhesh	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Teksti mësimor Fragmente të ndryshme nga letërsia e huaj dhe ajo shqiptare

34	Dritëro Agolli (5 orë) Risitë që solli Agolli në letërsinë shqipe. Momente kryesore të jetës së Dritëro Agollit që ndikuan në krijimtarinë e tij. Veprimtaria shoqërore dhe politike e Agollit. Krijimtaria letrare e Agollit në poezi, prozë dhe dramë.	Nxënësi/ja kupton, nëpërmjet kontekstit, se si përvoja letrare ndikon në ndërtimin e përvojave personale, vlerave dhe qëndrimeve që vlejnë më vonë në qasjen ndaj botës dhe perceptimin e saj.	Lexim i drejtuar	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Teksti mësimor Vepra artistike
35	<i>Analizë</i> “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”	Bisedë me temë: A janë gjithnjë të evidentuar njerëzit e aftë? Pse disa njerëz edhe pse të paaftë ngjisin shkallët e karrierës?		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
36	<i>Studim teksti</i> Fragmenti “Zylua shkëlqen në konferencën e madhe”	<i>Studim teksti</i>		Vlerësimi i punës në grup	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
37	<i>Studim teksti</i> Fragmenti “Shoku Zylo pret ftesë”	<i>Studim teksti</i>		Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
38	<i>Studim teksti</i> Fragmenti “Esetë e Zylos”	Bisedë me temë: Cili është më tragjik fati i atij që nuk di të		Vlerësimi i punës në grup	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti

			zbulojë aftësitë e tij apo i atij që nuk është i aftë, por që di të shfrytëzojë aftësitë e tjetrit?				
39			Ese		Punë e pavarur individuale	Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Fletore e punëve me shkrim
40			Dramatizim	Nxënësit inskenojnë fragment nga “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo”	Interpretim	Vlerësim mes nxënësish	Fragment nga vepra
41		Ismail Kadare (5 orë) Veprimtaria e Kadaresë si artist dhe intelektual. Vendi që zë Kadare në letërsinë shqipe. Momentet kryesore të jetës së Kadaresë që ndikuan në krijimtarinë e tij. Poeti dhe prozatori. Krijimtaria letrare e Kadaresë para dhe pas viteve ‘90.	Nxënësi/ja kupton, nëpërmjet kontekstit, se si përvoja letrare ndikon në ndërtimin e përvojave personale, vlerave dhe qëndrimeve që vlejnë më vonë në qasjen ndaj botës dhe perceptimin e saj.	Informacion i ri Stuhi mendimesh Reflektim dhe rifreskim njohurish-praktikë e drejtuar-punë e pavarur Diskutim Analizim Praktikë e pavarur Stuhi mendimesh Piramida e mendimit Kubimi Pesëvargëshi Diagrami i Venit Pyetje-përgjigje Hartë koncepti Hartë personazhesh Lexim i drejtuar	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Teksti mësimor	
42		Analizë “Pallati i ëndrrave”	Kujto ndërtimin e ferrit të Dantes			Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Teksti mësimor Vepra artistike

43		<i>Studim teksti</i> Fragmenti “Botë e çngjyrosur”	<i>Studim teksti</i>		Vlerësimi i punës në grup	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
44		<i>Studim teksti</i> Fragmenti “Bisedë me kafëtarin”	<i>Studim teksti</i>		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
45		<i>Studim teksti</i> Fragmenti “Darkë me Vezirin”	<i>Studim teksti</i>		Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
46		Test (tremujori i dytë)		<i>Punë e pavarur individuale</i>		
47		Projekt. Faza e dytë. Përgjdhja e materialeve	Përgjdhja e materialeve	Diskutim Prezantim Punë individuale Punë në grupe	Vlerësim mes nxënësish	Portofoli i nxënësit
48		Përsëritje matura Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore	Krijimtaria e Agollit pas viteve ‘90. Veçoritë e prozës së Agollit.		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	<i>Dosje e Maturës</i>
49		Përsëritje matura Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore	Bota shqiptare në veprën e Kadaresë.		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	<i>Dosje e Maturës</i>
50		Vlerësim portofoli			Vlerësim me notë mbi punimet e nxënësit që përmban portofoli	Portofoli i nxënësit

Plani analitik

PËR TREMUJORIN E TRETË (PRILL-MAJ)

	Njohuri të reja	Përpunim njohurish							
	Njohuri të reja	Përsëritje	Punë me projekt	Biseda letrare	Ese	Dramatizime	Vlerësim portofoli	Test	Totali
	10	3	1	-	1	1	1	1	18
Përqindja	56%	44%							

Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe					
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të fushës					
Nr.	Tematika/kapitulli	Temat mësimore	Situata e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi Burimet
51	Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore	Martin Camaj (5 orë) Momentet kryesore të jetës së Martin Camajt që ndikuan në krijimtarinë e tij. Risitë që solli Camaj në letërsinë shqipe. Fazat e krijimtarisë së Camajt.	Nxënësi/ja kupton, nëpërmjet kontekstit, se si përvoja letrare ndikon në ndërtimin e përvojave personale, vlerave dhe qëndrimeve që vëjnë më vonë në qasjen ndaj botës dhe perceptimin e saj.	Informacion i ri Stuhi mendimesh Reflektim dhe rifreskim njohurish-praktikë e drejtuar-punë e pavarur Diskutim Analizim Praktikë e pavarur Stuhi mendimesh Piramida e mendimit Kubimi Pesëvargëshi Diagrami i Venit Pyetje-përgjigje Hartë koncepti Hartë personazhesh	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Teksti mësimor Vepra artistike
52		<i>Analizë</i> “Njeriu më vete e me tjerë”	Diskutim me temë: Njeriu ndalet për pak kohë, harron problematikën dhe rrëmon brenda vetes të gjeje kujtimet dhe ndjesitë e së shkuarës.	Vlerësim diagnostikues Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)	Teksti mësimor Vepra artistike

53	<i>Studim teksti “Nata e koncertit”</i>	<i>Studim teksti</i>	Lexim i drejtuar	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
54	<i>Studim teksti “Mospërfillje”</i>	<i>Studim teksti</i>		Vlerësimi i punës në grup	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
55	<i>Studim teksti “Një ditë e ka dhe korb”</i>	<i>Studim teksti</i>		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
56	<i>Ese</i>	Njeriu në kërkim të vetvetes	Punë e pavarur individuale	Vlerësim me shkrim	Fletore të punëve me shkrim
57	Azem Shkreli (5 orë) Momentet kryesore të jetës së Shkrelit që ndikuan në krijimtarinë e tij. Veprat kryesore të Shkrelit (në prozë dhe në poezi). Tiparet e poezisë së Shkrelit.	Nxënësi/ja kupton, nëpërmjet kontekstit, se si përvoja letrare ndikon në ndërtimin e përvojave personale, vlerave dhe qëndrimeve që vlejné më vonë në qasjen ndaj botës dhe perceptimin e saj.	Informacion i ri Stuhi mendimesh Reflektim dhe rifreskim njohurish-praktikë e drejtuar-punë e pavarur Diskutim Analizim Praktikë e pavarur	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Teksti mësimor Vepra artistike

58	<i>Analizë</i> “Lirikë me shi”	<i>Diskutim me temë: Portreti i shqiptarit në histori</i>	Stuhi mendimesh Piramida e mendimit Kubimi Pesëvargëshi Diagrami i Venit Pyetje-përgjigje Hartë koncepti Hartë personazhesh Lexim i drejtuar	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup	Teksti mësimor Vepra artistike
59	<i>Studim teksti “ Këngë pa miq”</i>	<i>Studim teksti</i>		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
60	<i>Studim teksti “Një minutë heshtje”</i>	<i>Studim teksti</i>		Vlerësimi i punës në grup	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
61	<i>Studim teksti “Ditiramb”</i>	<i>Studim teksti</i>		Vlerësimi i përgjigjeve me gojë Vlerësimi i punës në grup Vlerësim mes nxënësish	Teksti mësimor Vepra artistike Fragmenti
62	Projekti Faza e tretë. Ora 4. Prezantimi dhe vlerësimi i produktit	Prezantimi dhe vlerësimi i produktit	<i>Prezantim Vetëvlerësim</i>	<i>Vlerësim me shkrim</i>	Portofoli i nxënësit
63	Dramatizim	<i>Dramatizojnë fragment nga Studenti në shtëpi</i>	<i>Interpretim</i>	Vlerësim mes nxënësish	<i>Fragment nga vepra</i>
64	Test (tremujori i tretë)		<i>Punë e pavarur individuale</i>		
65	Vlerësim portofoli		<i>Prezantim</i>	Vlerësim me notë mbi punimet e nxënësit që	Portofoli i nxënësit

						përmban portofoli	
66	Përsëritje matura Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore	Camaj si poet dhe si prozator.	Diskutim Analizim Praktikë e pavarur	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Dosje e Maturës		
67	Përsëritje matura Letërsia shqipe pas Luftës së Dytë Botërore	Risite që solli Shkreli në letërsinë shqipe.	stuhia mendimesh Kubimi Pesëvargëshi Diagrami i Venit	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Dosje e Maturës		
68	Përsëritje matura Letërsia shqipe dhe ajo botërore gjatë shekullit XX	<i>Krahaso zhvillimin e letërsisë shqipe dhe asaj botërore gjatë shekullit XX</i>	Pyetje-përgjigje Hartë koncepti Hartë personazhesh Lexim i drejtuar	Vlerësimi i përgjigjeve me gojë	Dosje e Maturës		

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 1

Dt. __/__/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: Letërsia botërore gjatë gjysmë së parë të shekullit XX.		Situata e të nxënësve: Faktorët historiko-politiko-shoqërore të gjysmë së parë të shekullit XX.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënësve • Personale • Qytetare			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - rendit përfaqësuesit kryesorë të letërsisë së gjysmës së parë të shekullit XX të vendeve të ndryshme, si dhe veprat e tyre letrare; - përcakton gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan në letërsinë moderne të shekullit XX; - përshkruan rrethanat historike dhe realitetin shoqëror në të cilat u zhvillua letërsia e kësaj periudhe; - analizon dhe gjykon pasojat që shkaktuan dy luftërat botërore; - rendit disa nga zbulimet e mëdha në shkencat e natyrës, të cilat ndikuan në jetën e njeriut; - përcakton dhe analizon zhvillimet në shkencat shoqërore, si: psikologjia, filozofia, sociologjia; - gjykon për ndikimet e Frojdit, Sartrit, Kamysë etj., në letërsinë e shekullit XX.		Fjalët kyçe: ▪ Kushte historike ▪ Realitet shoqëror ▪ Individualitete krijuese ▪ Prirje realiste ▪ Letërsi moderne ▪ Larmi drejtimesh ▪ Shpikje ▪ Psikologji ▪ Filozofi ▪ Sociologji	
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Fragmente të ndryshme nga letërsia e huaj e gjysmë së parë të shekullit XX		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Historia ▪ Qytetaria ▪ Psikologji ▪ Tik	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Informacion i ri - Reflektim dhe rifreskim njohurish - Hartë koncepti - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh - Diagrami i Venit			
Organizimi i orës së mësimi Reflektim dhe rifreskim njohurish - Hartë koncepti - Cilat janë ngjarjet më të rëndësishme, historike-shoqërore në të cilat u zhvillua letërsia e gjysmës së parë të shekullit XX? Rrethanat historike Gjysma e parë e shekullit XX Kushtet shoqërore Zhvillimi i letërsisë			

Pyetje-përgjigje

- Lufta e parë Botërore e ndan periudhën 1903-1925, nga pikëpamja ekonomike dhe politike, në dy faza.
 - o Shpjego karakteristikat kryesore të tyre.
 - o Si ndihet njeriu i kësaj kohe? Çfarë pasojash solli Lufta e parë botërore?

- Përmend disa nga shpikjet apo zbulimet e shekullit XX që patën ndikim në jetën e njeriut të kësaj periudhe.

Shpikjet e shek. XX, si automobili, aeroplani, kinemaja, llamba elektrike, radio, i dhanë një përshpejtim të madh komunikimeve, fantazisë, mënyrës së jetesës së njerëzve në gjithë botën dhe transformuan perceptimin e hapësirë kohës.

- o Trego se çfarë efekti patën ato:
 - a) në mënyrën e jetesës;
 - b) në letërsi.

Analizim

- Analizo zhvillimin e shkencave shoqërore, si:

▪ Psikologjia

Vetëdija përfaqëson vetëm pjesën e dukshme, majën e ajsbergut. Frojdi analizoi pjesën irracionale të njeriut, ëndrrat, kujtimet e fëmijërisë më të largët të zhytur në labirintet e kujtimit, shoqërimin e ideve, sferën e seksualitetit. Sipas tij, metoda psikanalitike mund të aplikohet me sukses për të hetuar jetën e artistit dhe veprat e tij. Mbi gjurmët e mendimit frojdian, u zhvillua kritika letrare psikanalitike.

▪ Filozofia

Interesi i saj u përqendrua te subjektivizmi dhe bota e brendshme shpirtërore, te shkencat humane, historia, feja, arti.

▪ Sociologjia

Lufta standardizoi burokracinë: çdo aspekt i jetës civile dhe sociale sundohej nga nevojat administrative. Nevoja për disiplinë, për racionalitet në shërbime, për rregull në ekonomi, përcaktuan krijimin e një aparati të madh burokratik.

Punë me grupe

- Cilat janë llojet letrare që u lëvruan në shekullin XX? Thoni emrat e përfaqësuesve kryesor të letërsisë së shekullit XX dhe vepra të njohura të tyre. Në ç'aspekte sollën risi këta autorë?

Llojet letrare që u lëvruan në shekullin XX: Proza, romani dhe novela.

Grupi 1

- o temat dhe motivet e romanit të shekullit XX;
- o tendencat e romanit të shek. XX, përfaqësuesit.

Grupi 2

- o përfaqësuesit e romanit realist;
- o karakteristika e përbashkëta dhe dallimet mes novatorëve të romanit të shek. XX.

Grupi 3

- o linjat e poezisë së shek. XX, karakteristikat e tyre dhe përfaqësuesit e secilës linjë;
- o protagonistet e teatrit të shek. XX.

Reflektim - Ditari dypjesësh

- Çfarë e karakterizonte letërsinë e shekullit XIX? Po letërsinë e shekullit XX?

Letërsia e shekullit XIX, karakteristikat kryesore	Letërsia e shekullit XX, karakteristikat kryesore

Diagrami i Venit – Krahajo zhvillimet e letërsisë botërore gjatë shekullit XIX dhe shekullit XX. Evidentoni të përbashkëtat dhe dallimet mes letërsive të zhvilluara përgjatë dy shekujve.



Vlerësimi: Përgjatë kësaj rubrike, mësuesi/ja mban shënime në lidhje me përgjigjet e nxënësve. Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)
Detyrat dhe puna e pavarur: a) Përshkruaj shkurtime (duke iu referuar informacionit në tekst, por dhe informacioneve që ju keni) realitetin shoqëror në të cilin u zhvillua letërsia gjatë shekullit XX. b) A keni lexuar ju ndonjë vepër të kësaj periudhe? A do t'ia sugjeronit për ta lexuar një shokut tuaj? Përse?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 2


Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: Letërsia botërore gjatë gjysmë së parë të shekullit XX. Avangardat e shekullit XX		Situata e të nxënësve: Nxënësi kupton se rrethanat historike, politike, shoqërore ndikojnë në letërsi.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënësve • Personale • Qytetare			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përcakton dhe analizon tiparet e letërsisë që vijoi traditën realiste të shekullit XIX; - analizon risitë që sollën shkrimtarët që ndoqën rrugën e letërsisë realiste të shekullit XIX; - dallon dhe analizon drejtimet (rrymat) kryesore letrare të letërsisë moderne të shekullit XX; - analizon gjinitë dhe llojet letrare që u lëvruan në letërsinë moderne të shekullit XX; - krahason zhvillimin e letërsisë të shekullit XIX me letërsinë moderne të shekullit XX.			Fjalët kyçe: ▪ Realiste ▪ Risi ▪ Moderne ▪ Avangardë ▪ Ekspresionizmi ▪ Futurizmi
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Fragmente veprash të shekullit XX ▪ Studime dhe kritika letrare ▪ Interneti			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Histori ▪ Psikologji ▪ Sociologji ▪ Arte
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Reflektim dhe rifreskim njohurish - Hartë koncepti - Lexim dhe shpjegim nga teksti - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh			

Organizimi i orës së mësimit

Reflektim dhe rifreskim njohurish - Hartë koncepti

- Cilat janë avangardat artistike të shekullit XX?



Të gjitha avangardat i kundërvihen Natyralizmit dhe dekadentizmit, e konceptojnë artin si aktivitet grupi dhe kanë karakter ndërartistik.

Ditari dypjesësh

- Çfarë idesh refuzojnë dhe çfarë pohojnë avangardistët?

Pohojnë	Mohojnë
1.	1.
2.	2.
3.	3.

- Shpjegoni në ç'raport qëndrojnë Ekspresionizmi dhe Futurizmi me civilizimin e makinave.
- Shprehja "Duke pritur Godonë" është bërë sinonim i një lloj pritje të caktuar. I cilës?

Mungesë e kohës dhe të historisë ku zhvillohen biseda mes dy personazheve që presin të tretin i cili nuk vjen.

- Lidh pohimin me avangardën përkatëse:

1. Arti duhet të shprehë nënvetëdijen	a. Ekspresionizëm
2. Arti duhet të kuptojë dhe të lartësojë bukurinë e shpejtësisë	b. Surrealizëm
3. Arti shpreh ulërimën e ankthit të unit	c. Futurizëm

Diskutim - Çfarë është shoqëria e masave?

- Popullsia shtohet me shpejtësi.
 - Masat kërkojnë që të kenë peshë në jetën politike.
 - Fabrika, zyra, qyteti bëjnë uniforme mënyrën e jetës së njerëzve.
 - Në shoqëri zhduken ndarjet klasore.
- "Sikleti i civilizimit": kush e krijoi këtë shprehje dhe për çfarë aludon?
 - Çfarë është "belle époque"?

Lexim dhe shpjegim nga teksti - Analizim - Pyetje-përgjigje

- Si ndryshon gjendja e intelektualëve në përgjithësi dhe e shkrimtarëve në veçanti?
- Çfarë ndikimi sjellin në planin kulturor zhvillimet e teknologjisë, fizikës dhe të matematikës?
- Çfarë është vetëdija për Frojden? Si ndikoi në letërsi dhe në art psikanaliza?
- Cilat janë teknikat e përdorura nga romancierët e fillimshkullit XX?
- Flisni për shkrimtarët që e refuzojnë romanin sepse është formë e vjetër e shek. XIX dhe cilët e reformojnë atë?

Ditari dypjesësh

- Trego risitë e romanit të fillimshkullit XX përkundrejt atij të shek. XIX.

romani XIX	romani fillimshkullit XX
strukturë e mbyllur	
narrator i gjithëdijshëm	
paraqitje objektive re realitetit	
ecuri kronologjike dhe e ngjarjeve	

- Cilët janë autorët e këtyre romaneve dhe cilat janë temat e tyre?

Romani	Autori	Tema
Njeriu pa cilësi		
Në kërkim të kohës së humbur		
Uliksi		

Vlerësimi: Përgjatë kësaj rubrike, mësuesi/ja mban shënime në lidhje me përgjigjet e nxënësve. Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruaj në një tabelë veçoritë kryesore të avangardave të shekullit XX.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 3

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: Franc Kafka. Momentet kryesore të jetës së Kafkës. Tematika. Veçoritë kryesore të krijimtarisë së Kafkës.		Situata e të nxënit: Lexim i letrës “Letër babait” Kafka	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit • Personale • Qytetare • Digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përshkruan dhe analizon faktorët historikë objektivë që ndikuan në veprën e Kafkës; - analizon dhe gjykon qëndrimin e Kafkës ndaj burokratizmit, gjyqit dhe vetëgjyqësisë, lirisë etj.; - veçon veprat kryesore të Kafkës (tregime, novela, romane, ese); - analizon temat kryesore të veprave të Kafkës; - përshkruan dhe analizon veçoritë kryesore të krijimtarisë letrare të Kafkës; - vlerëson rëndësinë që ka krijimtaria e Kafkës në letërsinë e shekullit XX.		Fjalët kyçe: ▪ Risi ▪ Tregime ▪ Novela ▪ Romane ▪ Ese ▪ Gjyq ▪ Vetëgjyqësi	
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Vepra artistike “Metamorfoza” ▪ Studime dhe analiza letrare		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Historia ▪ Qytetaria ▪ Psikologji ▪ Sociologji ▪ Tik	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			

Hartë koncepti - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh

Organizimi i orës së mësimit

Harta e koncepteve - Pyetje-Përgjigje

- Ndërtoni shkurtimisht kontekstin historik, politik, kulturor në të cilin u zhvillua krijimtaria letrare e Kafkës.

Faktorët që ndikuan në krijimtarinë e Kafkës

- **perandoria austro-hungareze** (kërcënim i kudondodhur, mbi kombet dhe minorancat e shtypura);
- **teknologjia** (sundimi i saj shkakton tjetërsimin e njeriut);
- **gjendja hebraike e të “çrrënjësuarit”** (ndjen në vetvete përplasjen mes kulturave të ndryshme);
- **vetëdija e ankthshme e dështimeve** (“një imazh i jetës sime do të ishte ai i një purteke të kotë ...”);
- **shqetësimet që mbart me vete qytetërimi modern** (pamundësia e shpëtimit nga çdo shoqëri);

- Cilët janë faktorët objektivë historikë dhe letrarë që ndikuan në veprën e Kafkës?

Faktorët objektivë historikë dhe letrarë që ndikuan në veprën e Kafkës.

Origjina

Shkollimi

Puna si nëpunës

Sëmundja

Në Pragë, qendër e kulturës së Evropës Qendrore, Kafka gjeti një ambient kulturor shumë të gjallë ku përplaseshin, në një integrim dhe pasurim reciprok tre kultura: sllave (çeke), gjermane dhe hebraike.

- Kafka, me veprën e tij, i parapriu disa lëvizjeve letrare. A mund të përcaktojmë krijimtarinë e Kafkës në një rrymë letrare specifike? Përgjigjen argumentojë duke iu referuar karakteristikave kryesore të krijimtarisë së tij.

- Flisni për momentet kryesore të jetës së Kafkës, të cilat ndikuan në krijimtarinë letrare të tij, duke u ndalur në të dhëna/informacione që lidhen me:

Origjinën

Franc Kafka lindi në Pragë në 3 korrik 1883, në një familje me origjinë çifute.

Shkollimin. *Ai frekuentoi liceun gjerman dhe, mbas mëdyshjes për të studiuar kimi ose gjermanistikë, u diplomua në Fakultetin e Drejtësisë në vitin 1906. Ai u edukua me etikën e fitimit dhe të suksesit pasqyrë e së cilës ishte aktiviteti tregtar fathum i babait Herman. Ai studioi gjuhën hebraike dhe tregoi interes për Hasidizmin.*

Punën si nëpunës

Mbas praktikës së detyrueshme pranë gjykatave të Pragës dhe punës në filialin triestin të Sigurimeve të Përgjithshme, ai punoi në vitet 1908-1922 pranë Institutit të sigurimeve për fatkeqësitë në punë.

Sëmundjen

Kafka qëndroi shpesh në sanatoriume dhe qendra kuruese në Çekosllavaki, Gjermani, Austri etj. Ai e shihte sëmundjen si ndëshkim për fajet ndaj babait dhe të dashurës së tij Felisës, por edhe si çlirim nga çdo detyrim mondan dhe garanci e lirisë së tij. Në vitin 1924 u kthye në Pragë, por shëndeti i tij u përkeqësua. Ai u shtrua në një sanatorium pranë Vienës (Kierling) ku u nda nga jeta në 3.06.1924; u varros në Varrezën e hebrenjve në Pragë.

Diskutim:

- Si ndikuan në krijimtarinë e Kafkës marrëdhëniet me:

o gratë

Lidhja torturuese pesëvjeçare (1912-1917) me berlinezen Felisë Bauerin ndikoi në krijimtarinë e tij.

Në vitin 1919, Kafka njohu Julia Vohrizek, por, babai nuk e lejoi që të martohej me një vajzë nga familje e thjeshtë.

Më 1920 Milena Jesenskaja filloi përkthimin e veprës së tij në gjuhën çeke. Lidhja me Milenën rishfaq problemën e raportit të Kafkës me universin femëror: martesë i prishte vetminë që ishte premisë e domosdoshme për aktivitetin si shkrimtar.

Kafka e gjeti qetësinë vetëm në vitin e fundit të jetës së tij me Dora Diamantin, me të cilën kaloi në Berlin muajt e fundit të jetës vetëm duke shkruar

o **babain**

Kafka e shprehu mllëfin e tij në Letër babait (nëntor 1919), ku ai përshkruan arsyet e kontradiktave me babanë si dhe moskuptimin dhe mungesën e komunikimit normal me të.

Kafka pati një raport të mundimshëm me babanë dhe me vajzat me të cilat nuk mundi të martohet.

Listimi

- Listo me tituj veprat kryesore të Kafkës. Klasifikoji ato sipas llojeve të tyre.

Tregime dhe novela.

Romane

Ditarët, Aforizma e Fletore

Letra, ese, shkrime pune.

Analizim

- Cili është personazhi kryesor i romanit “Amerika”? Në ç’rrethanë jeton e vepron ky personazh? Ç’ndodh me të? (si përfundon ai dhe pse?)

- Një nga veprat më të mira, që shkroi Kafka, është “Procesi”. Përse autori e ka titulluar kështu romanin e tij? Çfarë fshihet pas procesit absurd ndaj personazhit kryesor Jozef K.? Si jepet, nëpërmjet këtij romani, por jo vetëm, ideja e fajësisë së përgjithshme?

- Çfarë simbolizon kështjella në romani me të njëjtin titull? Kështjella është seli e një burokracie të tmerrshme, e rregulluar nga një hierarki e komplikuar, që e drejton fshatin me ligje në kundërshtim me çdo moral dhe logjikë.

Ditari dypjesësh

- Cili është problemi ose pengesa në romanet e mëposhtme dhe çfarë shkakton ajo?

Romanet	Shkaku/mjedisi	Pasoja
Amerika		
Metamorfoza		
Kështjella		
Procesi		

Pyetje-përgjigje

- Ndaj kujt drejtohen akuzat e Kafkës në veprat e tij?

Kafka akuzon në veprat e tij sistemin shoqëror burokratik antinjerëzor si dhe kritikon sistemin e drejtësisë.

- Si paraqitet jeta njerëzore në përfytyrimin e Kafkës? Cili është fati i heronjve të tij?

- Cilat janë rrugët që ai sugjeron për t’u çliruar nga kjo botë pa dritë?

- Zbërtheni karakterin humanist të veprës së Kafkës.

Veprat e Kafkës shprehin vuajtjen shpirtërore e fizike të njeriut të vetmuar, të tjetërsuar e të pashpresë, i cili shtypet, poshtërohet, nëpërkëmbet nga sistemi dhe nga familja. Por njëkohësisht në mënyrë të tërthortë dhe shprehëse, ato tregojnë me insistim aspiratën e njeriut për të jetuar në një botë të lirë, të sigurt e humane, ku gjithkush e gjen diku kuptimin dhe qëllimin më të lartë të jetës.

- Cilat janë temat e krijimtarisë letrare të Kafkës? Cila është tema kryesore që trajtohet në gjitha veprat e tij?

Temat e kanë burimin në kontrastin e thellë mes protagonistëve dhe realitetit që i rrethon të cilin personazhet e Kafkës janë të paafte ta pranojnë. Në krijimtarinë e tij gjenden tema, si: moskuptimi, papërshtatshmëria me ambientin rrethues dhe pamundësia për të qenë pjesë aktive e botës; ankthi konflikti me babanë; sundimi shtypës i teknologjisë mbi njeriun; elefantiaza burokratike e shoqërisë moderne; sikleti i qytetërimit; vetmia; absurdi; tjetërsimi; mungesa e autenticitetit; përjashtimi; brishtësia e njeriut etj.

- Përse Kafka konsiderohet si një **shkrimtar emblematik** i shekullit XX?

Për shkak të veçorive letrare, të tilla si konceptimi universal, misteri, absurdi, problematika fetare, gjuha e pastër dhe rigoroze.

- Çfarë parashtron termi kafkian?

Ky term parashtron kompleksitetin ekstrem të një shkrimtari i cili paraqet krizën e identitetit të njeriut modern të vetmuar e të paaftë për ta interpretuar realitetin si dhe nevojën e jashtëzakonshme për raportin me të vërtetën, me të mbinatyrshmen, me ligjin e jetës.

Punë e pavarur - Punë me grupe

Grupi 1 - Me ç'mjete stilistike arrin Kafka të realizojë vërtetësinë e padiskutueshme dhe karakterin përgjithësues të veprës së tij?

Grupi 2 - Ku e gjen Kafka rrugën për çliruar forcat e shpirtit të tij? - Çfarë qëndrimi mban ai ndaj personazheve të tij?

Grupi 3 - Pse Valter Benzhamin e quan alegorizimin e shkrimtarit “bosh”. - Si shfaqet problematika fetare në veprat e tij?

Grupi 4 - Çfarë rëndësie pati krijimtaria e Kafkës në letërsinë e shekullit XX?

Reflektim - Diskutim

- A duhet të gjykojmë të tjerët?

- Si ndiheni kur e dini se çdo veprim i juaji gjykohet nga kushdo, kurdoherë, kudo?

- A e çon kjo drejt mbylljes në vetvete, shkëputjes nga bashkësia njerëzore, drejt dëshirës:

për të mos rënë në sy, për t'u zvogëluar, për të qenë askushi, për të mos pasur marrëdhënie me askënd, për të mos vepruar, për të shmangur që të tjerët të ngarkojnë me faj dhe të gjykojnë?

- Vetëgjyrimi është i dëmshëm apo një lloj katarsisi? Argumento përgjigjen tënde.

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish

Detyrat dhe puna e pavarur:

Në romanin “Procesi”, personazhi kryesor nuk e ka të qartë akuzën ndaj tij. Procesi pëstillet prej një fshehtësie misterioze. Por përtej kësaj situatë absurde, ai nis të vetëgjykojë veten për qëndrimet e tij, si zyrtar, ndaj të tjerëve. Çfarë fshihet pas këtij procesi absurd?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 4

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: Analizë “Metamorfoza” Sfondi. Tematika, Personazhet, Gjuha dhe stili, Mesazhe		Situata e të nxënit: Nxënësi kupton, nëpërmjet kontekstit, se si përvoja letrare ndikon në ndërtimin e përvojave personale, që vlejnë më vonë në qasjen ndaj botës dhe perceptimin e saj.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit • Personale • Qytetare • Digjitale			

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit; - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; - zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit; - identifikon në tekst veçoritë e stilit të autorit; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike;	Fjalët kyçe: • Metamorfozë • Reale • Fantastike • Marrëdhënie • Interes								
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Vepër artistike “Metamorfoza” ▪ Studime dhe analiza letrare	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Sociologji ▪ Psikologji ▪ Tik								
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Organizuesi grafik - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Punë e pavarur individuale - Ditari dypjesësh									
Organizimi i orës së mësimin Diskutim - Pse Kafka e ka titulluar novelën “Metamorfoza”? A mund të zëvendësohet me termin “transformim”? Organizuesi grafik - Në sa kapituj është organizuar novela “Metamorfoza”? Trego shkurtimisht thelbin e secilit kapitull/çfarë ndodh në secilin kapitull. <table border="1" data-bbox="277 1182 1276 1323"> <thead> <tr> <th>Kapituj</th><th>Ngjarja kryesore për secilin kapitull</th></tr> </thead> <tbody> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> <tr><td> </td><td> </td></tr> </tbody> </table> Pyetje-përgjigje - Ku dhe kur zhvillohen ngjarjet? Çfarë i ndodh personazhit kryesor? Si reagon ai ndaj transformimit fizik që ka pësuar? Ç’tregon ky qëndrim i tij ndaj gjendjes së re fizike? Ku zhvillohet ngjarja _____ Kur zhvillohet _____ Çfarë i ndodh Gregorit _____ Si reagon ai _____ Ç’tregon ky lloj reagimi _____ - Çfarë simbolizon metamorfoza që pësoi Gregori? - Bërthama psikologjike e Metamorfozës është te pohimi i Kafkës “Unë jam (si) kacabu”. Mendon që figura stilistikore e novelës është metaforë apo krahasim? Punë me grupe - Diskutim dhe prezantim i detyrës Grupi 1 - Si e realizon shkrimtari transformimin e kategorive kohore në novelë. Grupi 2 - Cila është vlera simbolike e dyerve dhe e hapjes së tyre? Grupi 3 - Si shtjellohen temat e fajit, e ndëshkimit, e pafajësisë dhe e asgjësimit në këtë novelë. Grupi 4 - Gjej në vepër elemente reale dhe fantastike. Si ndërthuren në vepër këto elemente? Reale: _____ Fantastike: _____		Kapituj	Ngjarja kryesore për secilin kapitull						
Kapituj	Ngjarja kryesore për secilin kapitull								


Punë e pavarur individuale Formulo me në fjali mesazhin që përcjell vepra. Shpjego natyrën dhe rolin e përshkrimit në vepër. Përse Gregori përbën kërcënim për normalitetin e personazheve?			
Analizim -Vepra është e hapur për shumë interpretime. Si e realizon Kafka pështjellimin e lexuesit?			
Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish			
Detyrat dhe puna e pavarur: Shpjegoni raportet mes personazheve të veprës.			
<u>Gregori</u>	<u>Nëna</u>	<u>Babai</u>	<u>Greta</u>
Raporti me familjarët Gregori–nëna Gregori–babai Gregori–motra			
Raporti me të tjerët			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 5

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Studim teksti “Metamorfoza”</i> Fragmenti: “Zgjimi i Gregor Zamzës”		Situata e të nxënit: <i>Diskutohet mbi frikën e ekzistencës që buron nga realiteti i përditshëm. Nevoja për t’u larguar nëpërmjet metamorfozës.</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare • Digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit; - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; - zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit; - identifikon në tekst veçoritë e stilit të autorit; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike; - realizon përshkrimin e personazheve në plane e aspekte të ndryshme.		Fjalët kyçe: ▪ Transformim ▪ Vonesë ▪ Shqetësim ▪ Pranim ▪ Ndjenjë detyre ▪ Komunikim ▪ Realitet shfrytëzues	
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Vepra artistike “Metamorfoza”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Psikologji ▪ Sociologji	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Përmbledhja - Hartë koncepti - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh			

Përmbledhja



- Përmbledhni përmbajtjen e tekstit në dhjetë rreshta.

Pyetje-përgjigje

- Në ç'vetë është rrëfimi? Përcakto pozicionin e rrëfimtari.

Veta e rrëfimit: *veta e tretë*

Rrëfimtari: *i jashtëm*

Punë e pavarur individuale - Analizim

- Identifiko në tekst detaje të cilat ndërtojnë sfondin e zhvillimit të ngjarjes. Dallo pjesët përshkruese nga ato narrative.

Dhoma e tij, dhomë e vërtetë njerëzish, edhe pse e vogël, ndodhej si gjithmonë midis atyre katër mureve të mirënjohura.

Përmbi tryezë, mbi të cilën ishte shpërhapur një koleksion mostrash të ndryshme, nga ato që tregtonte Samsa si komisioner, rrinte varur portreti që ai kishte prerë para disa kohësh nga një revistë me ngjyra dhe e kishte vendosur në një kornizë të pruar.

- Paragrafi i parë e njeh lexuesin me çfarë ka ndodhur. Në cilën hapësirë zhvillohet metamorfoza tronditëse?

- **Ku ndodhet Gregori** Në dhomën e tij

- **Ç'kohë është:**

Koha si pjesë e ditës — *Një mëngjes, teksa u zgjua në shtratin e tij nga ëndrra të shqetësuar.*

Koha lidhur me motin — *vështrimi i Gregorit u drejtua për nga dritarja, aty ku moti i ngrysur – mbi llamarinën e dritares dëgjoheshin pikat e shiut*

- Cili është kuptimi i të dhënave për kushtet atmosferike të ditës kur ndodh ngjarja?

- Çfarë paralajmëron Kafka me grupin emëror ëndrra të shqetësuar?

Punë e pavarur individuale

- Përshkruaje Gregorin (duke përdorur detajet nga teksti) pas transformimit.

kurrizi _____

barku _____

këmbët _____

trupi _____

- Paragrafi i dytë të përvijon imazhin e dhomës së Gregorit. Nënvizoji në tekst këto detaje.

- Shpjego rolin e fjalisë pyetëse “Ç’të ketë ndodhur vallë me mua?”

- Si reagon Gregori pasi konstaton ndryshimin fizik që ka pësuar? Jep shkallë-shkallë, me anë të foljeve, sjelljen e tij.

- Identifiko mjetet stilistike dhe shpjego funksionin e tyre, në fjalinë:

Oh Perëndi’, mendoi, ‘ç’profesion të mundimshëm kam zgjedhur.

- Çfarë zanati ka Gregor Samsa? Çfarë raporti ka ai me punën e tij? E ka ndjenjën e detyrës? Ku del ajo në tekst?

- Gjej detaje në tekst të cilat na njohin me rutinën e përditshme të Gregorit para transformimit. Plotëso më tej frazat e mëposhtme.

ditë për ditë _____

tensionet lart e poshtë _____

gjithmonë andrallat _____
frika se _____
ushqimi _____
komunikimi _____

Përgjigjet janë përmbledhur në fragmentin e mëposhtëm:

'Oh Perëndi', mendoi, 'ç'profesion të mundimshëm kam zgjedhur! Ditë për ditë në udhëtim. Tensionet lart e poshtë janë shumë më të mëdha se vetë tregtia në qytetin tim, pastaj gjithmonë andrallat e udhëtimeve, frika se nuk kap dot trenat, ushqimi i çrregullt e i keq, komunikimi njerëzor që nuk është asnjëherë i vijueshëm, asnjëherë i ngrohtë.

Analizim

- Përcakto funksionin e lokucionit pasthirmor dhe shpjego funksionin e përdorimit në këtë moment.

Vafshin të gjithë në djall!

- Interpretu kuptimin e fjalive të shkëputura nga fragmenti: *'E ka fajin ky zgjimi i hershëm', mendoi, 'ia mpin trutë fare njeriut të shkretë'. Pa e bërë gjumin e plotë, s'ka kuptim.*

- Gregori bën krahasimin me komisionerët e tjerë. Si i përshkruan ata? Si sillen ata? Po ai? Ç' do të ndodhte nëse do të sillej dhe ai ashtu?

- Gregori
- Komisionerët e tjerë
- Nëse Gregori do sillej me shefin e tij si ata ç' do të ndodhte?


Komisionerë të tjerë jetojnë si gratë e haremit. Ja, kur vete unë bie fjala gjatë paradites në ndonjë kafene për t'i rishikuar porositë e kërkuara, i gjej aty ata zotërinj që hanë më nge mëngjesin e tyre. Pa ta provoj njëherë unë ashtu me shefin tim! Do të fluturoja brenda ditës nga puna.

Diskutim

- Përse Gregori ka vijuar të punojë në atë vend pune? Nëse nuk do të ishte ai problem si do sillej me shefin? Ç'tregon kjo për gjendjen emocionale dhe psikologjike të Gregorit?

- *Do të kisha ikur prej kohësh nga ajo punë po të mos kisha hallin e prindërve, do të kisha kërkuar takim me shefin e do t'ia kisha thënë në fytyrë të gjitha ç'ka më brejnë në zemër.*
-

- Cilët janë faktorët që e çojnë Gregorin të pranojë natyrshëm gjendjen e re? - Pse Gregori nuk duket i çuditur nga metamorfoza e pësuar? Për çfarë çështjesh reflekton ai?



Punë e pavarur

- Autori alternon në fragment tri kohë. Përcaktoji ato dhe shpjego si lidhen mes tyre.

- Çfarë nënkupton Gregori me fjalinë *"Pastaj vjen shndërrimi i madh."*?

- Shpjego rolin e orës me alarm *"Vështroi orën me alarm që ndodhej përmbi komo"*. Çfarë kuptimesh marrin shqetësimet e tij për vonesën?

Treni i radhës nisej në orën shtatë; po të kërkonte ta kapte, do duhej të vraponte si i marrë, pale pa nuk kishte mbledhur ende koleksionin, pos që ndihej i lodhur e si i mpirë. Edhe po ta kapte atë tren, s'u shpëtonte dot dokëndisjeve të shefit, sepse shërbyesi i punës patjetër që do kishte pritur te treni i orës pesë e pastaj do kishte njoftuar për mosardhjen e tij.

- Si sillej shefi me ata që mungonin në punë me njoftimin se ishin sëmurë? Si i ndante ai njerëzit? Kë përfaqëson shefi?

Shefi patjetër do të kërkonte ekspertizën e mjekut të sigurimeve shëndetësore, do t'u ankohej prindërve për dembelizmin e djalit të tyre e çdo kundërshtimi do t'i binte shkurt me kujtesën për mjekun e sigurimeve shëndetësore, njeri që i mbante të gjithë njerëzit e tjerë për të shëndetshëm, duke dalluar syresh vetëm nga ata që duan t'i bëjnë bisht punës

- Zbuloni një shprehje frazeologjike (në fragmentin kur Gregori flet për shefin e tij).

- Cili ishte roli i shërbyesit të punës? Përse Gregori e quan kështu? Po më parë çfarë ka menduar për të?

- Kafka komenton: "...sepse Gregori, pavarësisht gjumit të gjatë që kishte bërë dhe një përgjumje pa vend, ndihej për bukuri, kishte bile edhe një uri të fortë". A mund të ishte përgjumja dhe ndjesia pozitive, tregues i dëshirës për t'u larguar realitetit shfrytëzues dhe për të shijuar ato ç'ka nuk kishte mundur më parë?

Ditari dypjesësh

- Si reagojnë familjarët e tij teksa konstatojnë vonesën jo të zakonshme të Gregorit? Përgjigjen jepe duke u bazuar te mënyra si komunikojnë mes tyre familjarët e Gregorit me të.

zëri	karakteristika	ç'tregon
zëri i nënës	- sa të butë e kishte zërin nëna	
zëri i Gregorit	- zëri i tij i zakonshëm, vetëm disa ishin përzier aty një si fishkëllimë e dhimbshme, e cila i nxirrte njëherë fjalët të plota në trajtën e tyre, i shpërbënte pastaj aq keq sa nuk kuptohej më asgjë e sigurt	
zëri i babait	nga dyert anësore i ati, lehtë, por sidoqoftë me grusht. "Gregor, Gregor", bërtiti ai, "si është puna?" Pas një grime u dëgjua përsëri zëri i tij paralajmërues: "Gregor! Gregor!"	
zëri i motrës	ndërsa nga dera tjetër anësore u ndje zëri i shqetësuar i motrës: "Gregor, nuk je mirë? Ke nevojë për gjësend?"	

- Ka analogji mes figurës së eprorit dhe të babait?

- Klasifiko në tabelën e mëposhtme detaje reale dhe fantastike.

Reale	Fantastike

- Çfarë vlere merr vërejtja për mbylljen e derës?

Gjeni në tekst pjesët ku Gregori flet për ndjenjën e fajit.

- Autori nuk e shpjegon arsyen e metamorfozës së Gregorit. Nga elementet e dhëna në tekst bëni hipoteza:

- Dëshirë regresioni
-
-

Babai i Gregorit

Babai i Kafkës

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish

Detyrat dhe puna e pavarur:

Krahaso tekstin me letrën e Kafkës drejtuar babait dhe gjej elemente që mund të ndihmojnë në kuptimin e situatës së Gregorit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 6

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Studim teksti “Metamorfoza”</i> Fragmenti “Gregori sulmohet nga babai”		Situata e të nxënit: Si do të sillleshit nëse një ditë vëreni se ka ndodhur një ndryshim i madh te ju?	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - identifikon në tekst detaje, mjete gjuhësore dhe stilistike në funksion të karakterizimit të personazheve dhe ndërtimit të sfondit; - interpreton kuptimin mjeteve stilistike të përdorura në fragment; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore dhe stilistike; - zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit; - analizon, gjykon, vlerëson novelën “Metamorfoza”.		Fjalët kyçe: ▪ Transformim ▪ Zemërim ▪ Kënaqësi ▪ Përballje ▪ Forcë ▪ Sulm ▪ I dobishëm ▪ I padobishëm	
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Vepra artistike “Metamorfoza”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Psikologji ▪ Sociologji	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh			
Organizimi i orës së mësimi <i>Situata rrokulliset me shpejtësi kur motra vendos të zhvendosë të gjitha mobilet dhe Gregori, atëherë, gjen strehë sipër tablosë së zonjës me peliçe të varur në mur. Duke parë këtë skenë, nënës i bie të fikët dhe Greta ngre grushtin mbi vëllanë. Kur babai i kthyer në shtëpi shikon gruan që i ka rënë të fikët dhe vajzën e frikësuar, pa e ditur me saktësi se çfarë ka ndodhur, i mjafton një lojë vështrimesh për të vendosur që Gregori duhet ndëshkuar.</i> - shkëputur nga përmbledhja e paragrafit në tekstin e nxënësit. Analizim - Pyetje-përgjigje - “Në shtëpi nuk pipëtinte asgjë, por befas bie zilja”. Çfarë ka ndodhur gjatë kohës që babai nuk ishte në shtëpi? <i>Nënës i ra të fikët, por tani është më mirë. Ka dalë Gregori nga dhoma.”</i> - Përse “Shërbyesja sigurisht që ishte kyçur në kuzhinë”? - Me vështrimin e kujt vëzhgohet skena? - Shpjego kuptimin e fjalës së nënvizuar në fjalinë “Kaloj kësisoj një copë herë e Gregori rrinte aty i <u>flashkur</u>.” - Gregori mendon se tani e tutje duhej të ishte i përgatitur shpirtërisht për rrethana të ndryshuara. Për çfarë e paralajmëron lexuesin ky refleksim i Gregorit?			

- Cili është mjeti stilistik që përftohet nga përballja e fjalëve zemërim e kënaqësi të përdorura në fjalinë: “Ah!” briti ai sapo hyri, me një zë ku dëgjohej zemërim e kënaqësi njëherësh.

Mjeti stilistik _____

Përse babai transmeton dy gjendje të ndryshme njëkohësisht? Jep sqarimin për secilin rast:

Zemërim _____

Kënaqësi _____

- Metamorfoza e Gregorit i ka shërbyer atij të zbulojë natyrën e vërtetë të familjarëve të tij. Çfarë imazhi përfton babai në sytë e djalit? Cilat janë shenjat e forcës së babait? Si përshkruhet skena e “përballjes” së babait me Gregorin?

- *Mirëpo babai nuk e kishte aspak atë humor që të vinte re stërhollime të tilla. “Ah!” briti ai sapo hyri, me një zë ku dëgjohej zemërim e kënaqësi njëherësh. Gregori e tërhoqi kokën nga dera dhe e ngriti për nga babai. Nuk e kishte përfytyruar babanë kështu siç po e shihte tani; por nga ana tjetër, me gjithë ato tutjetëhura që bënte nëpër mure kohët e fundit nuk kishte pasur më mendjen të ndiqte ndodhitë në pjesën tjetër të banesës, kështu që duhej të ishte i përgatitur shpirtërisht për rrethana të ndryshuara.*

- *E prapëseprapë, ishte ky vërtet babai? Ishte ky po ai burrë që rrinte si i groposur nga lodhja në krevat, dikur kur Gregori nisej për në udhëtimet e tij; ai që e gjente në mbrëmje kur kthehej në shtëpi, në robdëshambër, të mbështetur pas ndenjës së pjerrët, i pazoti për t’u ngritur në këmbë, por që vetëm çonte krahët në shenjë gëzimi, ai që në shëtitjet e rralla të përbashkëta, në nja dy-tri të diela në vit e në ndonjë festë të veçantë, ecte midis Gregorit dhe nënës, që hidhte hapa të ngadalte, edhe më ngadalë se ata, i mbështjellë në pallton e tij të vjetër, gjithmonë duke hapur rrugën me kujdes me bastunin e tij, e që, kur donte të thoshte diçka, mbante thujasë përherë këmbët dhe priste sa të mblidheshin rreth tij shoqëruesit?*

Nuk e kishte përfytyruar babanë kështu siç po e shihte tani. E prapëseprapë, ishte ky vërtet babai?

Por nuk ndenji të priste, sepse qysh nga dita e parë e jetës së tij të ndryshuar ai e dinte se ndaj tij babai shikonte si të vetmen punë të arsyeshme përdorimin e rreptësisë më të madhe.

- Babai para shndërrimit të Gregorit
- Babai pas shndërrimit të Gregorit

Punë me grupe

Grupi 1 - Si ka ndikuar marrëdhënia e Kafkës me të atin për të modeluar babain e Gregorit?

Grupi 2 - Përse Gregori thotë që “mjaftonte që të hapet porta dhe ai do të zhdukej”?

Grupi 3 - Përse Gregori nuk ia mbath për t’i shpëtuar gjuajtjes në objektiv të babait?

Punë e pavarur individuale

- Gjej shprehjet frazeologjike të përdorura në tekst. Shpjego kuptimin dhe funksionin e përdorimit të tyre.

_____	_____
_____	_____
_____	_____
_____	_____

- Individualizoni rolin e nënës në skenë: i kundërvihet burrit apo është në fakt një bashkëpunëtoare e tij? Përse?

- Portretizo Gregorin (duke përdorur detaje nga teksti) në disa plane:

në planin fizik _____

në planin emocional _____

në planin psikologjik _____

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish

Nxënësi vlerësohet për përgjigje të ndryshme me gojë, në punët e pavarura me shkrim, pjesëmarrje në diskutime.

Detyrat dhe puna e pavarur: Çfarë e shqetëson më së shumti Gregorin:

- Nuk e pranon dot pamjen e re _____
 Nuk e pranojnë të tjerët se u ngjall frikë _____
 Nuk e pranojnë se ai tashmë është i padobishëm _____
 Nuk përpiqen ta kuptojnë _____
 Po ju çfarë do t'u shqetësonte dhe përse?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 7

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Studim teksti “Metamorfoza”</i> Fragmenti “Vdekja e Gregorit”		Situata e të nxënësve: <i>Diskutim:</i> Çfarë i bën njeriut vetmia? Vetmia është zgjidhje, ndëshkim apo protestë?	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënësve • Personale • Qytetare			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit; - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; - zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit; - identifikon në tekst veçoritë e stilit të autorit; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike; - realizon përshkrimin e personazheve në plane e aspekte të ndryshme.		Fjalët kyçe:	
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Vepra artistike “Metamorfoza”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Psikologji ▪ Gjuhë shqipe ▪ Tik	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Analizim - Pyetje-përgjigje - Përmbledhje e strukturuar - Punë e pavarur individuale - Ditari dypjesësh			
Organizimi i orës së mësimi Njeriu-insekt me ndjenja njerëzore, i refuzuar nga shoqëria, i braktisur nga familja, ngjall neveri dhe tmerr. Tashmë gjithçka vazhdon në një indiferencë reciproke. Por një mbrëmje, ndërsa motra i bie violinës për nder të miqve që jetojnë në shtëpinë e tyre, ai del nga dhoma e tij, dhe meqë po qëndron mes njerëzve, provon një moment lumturie. Mirëpo, kur njëri nga qiraxhinjtë e kupton praninë e njeriut buburrec, trembet. Gregori provokon një frikë të madhe tek tre qiraxhinjtë. Situata precipiton dhe Greta shpall dënimin me vdekje për vëllanë e saj. Gregorin e lënë të vdesë në dhomën e tij. - shkëputur nga përmbledhja e paragrafit në tekstin e nxënësve			

- Në fjalët e motrës vërejmë se ajo nuk e sheh më Gregorin si vëllanë e saj, madje e quan atë përbindësh. *“Unë nuk dua ta shqiptoj para këtij përbindëshi emrin e vëllait tim,”* Ky qëndrim paraprin kërkesën e saj *“duhet të përpiqemi ta heqim qafe. Ne bëmë gjithë ç’mund të bëjë njeriu për ta mbajtur e toleruar, ndaj mendoj se askush nuk mund të na qortojë as dhe me një fjalë.”*

Pyetje-përgjigje - Analizim - Interpretim

- Përse motra shprehet *“Por si mund të ishte ky Gregori? Po të ishte vërtet Gregori, ai do ta kishte kuptuar se njeriu e ka të pamundur të jetojë me një kafshë të tillë dhe do të kishte ikur vullnetarisht.”*

- Si duhet të ishte Gregori dhe si ishte në sytë e motrës? Çfarë vlere merr insistimi i Gretës në fjalën “kafshë”?

Gregori

Kafsha

Motra shprehet: - *Por si mund të ishte ky Gregori? Po të ishte vërtet Gregori, ai do ta kishte kuptuar se njeriu e ka të pamundur të jetojë me një kafshë të tillë dhe do të kishte ikur vullnetarisht. Atëherë nuk do të kishim më një vëlla, por do mund të jetonim siç është për të jetuar dhe do ta ruanim me nder kujtimin e tij.*

- Cili është funksioni i motrës në dekretimin e fatit të Gregorit? Cili është gjesti i saj që e sanksionon atë?

“Duhet të përpiqemi ta heqim qafe”, foli motra, këtë herë duke iu drejtuar vetëm babait, sepse nëna nuk dëgjonte asgjë mes kollitjeve të saj. “do të na çojë të gjithë në varr, jam e sigurt. Nuk mund ta durojmë edhe këtë torturë në shtëpi, pasi jemi sfilur në punë gjithë ditën e ditës. Unë s’mundem më.” E aty u shkreh e pashpresë në vaj, aq sa lotët e saj rrodhën mbi fytyrën e nënës, e cila i fshiu ato me një veprim mekanik të dorës.

- Çfarë konvergjence/marrëdhënie krijohet mes babait dhe bijës? Si mund ta emërtoni këtë aleancë mes tyre?

- Përshkruaj marrëdhëniet mes:

Babait-vajzës

babait-Gregorit

Gregorit-familjarëve

- Vihet re shqetësimi për gjykimin e të tjerëve, por mungon shqetësimi për pjesëtarin e familjes.

Po babai si reagon ndaj sjelljes së vajzës? Ç’qëndrim mban nëna ndaj Gregorit?

E prisja”, tha babai “ju pata thënë gjithmonë ju grave, por nuk donit të më dëgjoni.”

-Nëse dy personazhet (motra dhe babai) e shprehin me fjalë dhe veprime qëndrimin e tyre ndaj Gregorit, po nëna si e shpreh pozicionin dhe gjendjen e saj? Ç’tregon gjendja e nënës?

Punë e pavarur individuale- Diskutim

- Identifiko, në fragment, një rast që dëshmon se edhe brenda anëtareve të një familjeje ndërtohen marrëdhënie interesash.

Ndërsa kështu kjo kafshë na përndjek gjithë kohën, i dëbon qiraxhinjtë, kërkon me sa duket ta ketë gjithë banesën për vete dhe të na nxjerrë ne të flemë në rrugë

- Ç’tregon fakti se ndërkohë që babai dhe motra janë të alarmuar nënën e kishte zënë gjumi *“Vështrim i tij i fundit fshiku nënën, e cila tani po flinte.”*

- Shpjegoni përse Gregori vdes duke menduar me “mallëngjim dhe dashuri” për familjarët që e kanë dënuar?

- Si e pranon Gregori fundin e pashmangshëm?

Sidoqoftë shpejt Gregori e kuptoi se s’do ta duronte gjatë as këtë lloj vrap, sepse ndërkohë që babai hidhte vetëm një hap, atij i duhej të bënte një shumësi lëvizjesh. Filloi të ndjente marrje fryme, ai që edhe dikur nuk shquhej për mushkëri të forta. Teksa kalamendej kësisoj, që të mblidhte sa më shumë forca për vrapim, sytë thuajse i mbante mbyllur, nuk mendonte, se ishte i mpirë, se mund të kishte ndonjë tjetër shpëtim veç vrapit; deri dhe kishte harruar se për qark muret ishin të lira për të, edhe gjysmë të mbuluara me mobilie të gdhendura me shumë kujdes, plot të dala e thepa

- Përse autori thekson orën tre të mëngjesit? Pse pikërisht në kohën kur vinte pastruesja? A ka rëndësi mënyra e sjelljes së pastrueses së shtëpisë?

- Shpjego funksionin e fjalës cofi (Ajo mbart konotacion negativ). Cila do ishte fjala e duhur në këtë rast? *“Pa ejani shikoni pak, cofi; shikoni se si ka cofur i tëri!”*

Përmbledhje e strukturuar

- Zbuloni, në fragment, veçori të stilit të Kafkës dhe organizojini ato.

Tema dhe motive	Natyra dhe roli i dialogut	Roli i përshkrimit	Veçori të gjuhës	Veçori të stilit

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish

Detyrat dhe puna e pavarur: Shkruani një ese me temë: Askush nuk do të ngjitet në kurrizin tënd nëse ti nuk përulesh.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 8

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Punë me projekt. Faza e parë. ora 1.</i> Përcaktohet tematika së bashku me nxënësit si dhe ndahen grupet.		Situata e të nxënit: Nxënësit diskutojnë dhe përzgjedhin temën e punës me projekt	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare • Digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - liston tema të mundshme për projekt; - diskuton mbi përzgjedhjen e temës së përshtatshme; - argumenton mbi arsyet e përzgjedhjes së bërë nga ai; - shpjegon mënyrën e realizimit të projektit sipas konceptimit vetjak; - përzgjedh detyrat dhe rolin e tij në punën në grup.		Fjalët kyçe: ▪ Projekt ▪ Listë ▪ Ide ▪ Rol ▪ Detyra ▪ Rrugë	
Mjetet: ▪ Mjete kancelarie ▪ Modele punësh me projekt		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Arte ▪ Histori ▪ Gjeografi ▪ Tik ▪ Gjuhë shqipe ▪ Qytetari	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Listë me tema - Hartë koncepti
Organizimi i orës së mësimi Paraprakisht nxënësit janë njohur nga mësuesi/ja mbi qëllimin e kësaj ore mësimi. Secili nga nxënësit liston tema të mundshme për projekt (në përmbushje të kompetencave kyçe dhe të fushës si dhe interesave të nxënësit). Diskuton mbi përzgjedhjen e temës së përshtatshme. Argumenton mbi arsyet e përzgjedhjes së bërë nga ai. Shpjegon para shokëve dhe mësuesit/es mënyrën e realizimit të projektit sipas konceptimit vetjak. Përzgjedhin temën më të përshtatshme. <i>(shënim “nëse nxënësit nuk ofrojnë tema të duhura mësuesi/ja sugjeron”)</i> Përzgjedh detyrat dhe rolin e tij në punën në grup duke argumentuar arsyet e kësaj përzgjedhjeje. Bëhet ndarja në grupe. Përzgjidhen kryetarët e grupeve. Ndahen detyrat në bazë të punës individuale dhe në grup.
Vlerësimi: Mësuesi/ja mban shënime, nuk vlerëson orën e parë, por orën e dytë të planifikuar në këtë periudhë semestrale.
Detyrat dhe puna e pavarur: ▪ Secili nxënës prezanton planin e punës individuale. ▪ Secili kryetar grupi prezanton planin e punës në grup.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 9

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: Albert Kamy Momentet kryesore të jetës dhe të veprës së Kamysë. Ekzistencializmi në artin e Kamysë. Absurdi i qenies njerëzore, vetmia etj.		Situata e të nxënësve: Nxënësi kupton, nëpërmjet kontekstit, se si përvoja letrare ndikon në ndërtimin e përvojave personale, vlerave dhe qëndrimeve që vlejnë më vonë në qasjen ndaj botës dhe perceptimin e saj.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënësve • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Digjitale			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - përshkruan gjendjen absurde të Francës në kushtet e pushtimit nazist; - formulon idenë e Kamysë për absurdin; - analizon raportin: absurd, shpërfillje, shpresë, revoltë, në veprën e Kamysë.		Fjalët kyçe: ▪ Ekzistencializëm ▪ Absurd ▪ Shpërfillje ▪ Shpresë ▪ Revoltë	

Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Vepra artistike “I huaji”	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Arte ▪ Histori ▪ Gjeografi; ▪ Tik Gjuhë shqipe ▪ Qytetari																									
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Brainstroming - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh																										
Organizimi i orës së mësimi - Cilat janë momentet kryesore të jetës së Kamysë që ndikuan në tematikën e veprës së tij? - Si ndikoi përvoja e dhimbshme e sëmundjes të Kamyja në kuptimin/vështtrimin e tij mbi jetën? - Ndërto një hartë mendimi me temë “<i>veprimtaritë letrare dhe jolettrare të Kamysë</i>”. - Klasifiko vepra të Kamysë sipas llojit të tekstit. Si konkretizohet në vepër përvoja jetësore e Kamysë, veprimtaria e tij e shumanshme? <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; margin-top: 10px;"> <tr> <th style="width: 33%;">Ese</th> <th style="width: 33%;">Romane, novela</th> <th style="width: 33%;">Drama</th> </tr> <tr> <td style="height: 40px;"></td> <td></td> <td></td> </tr> </table> - Krijimtaria e Kamysë kalon në disa faza të zhvillimit të saj. Shkruani së paku nga dy vepra për secilën fazë, si dhe tregoni se cilat janë temat dhe motivet kryesore. <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse; margin-top: 10px;"> <thead> <tr> <th style="width: 33%;">Fazat</th> <th style="width: 33%;">Veprat</th> <th style="width: 33%;">Temat dhe motivet</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td rowspan="2">Faza _____</td> <td>1.</td> <td rowspan="2"></td> </tr> <tr> <td>2.</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">Faza _____</td> <td>1.</td> <td rowspan="2"></td> </tr> <tr> <td>2.</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">Faza _____</td> <td>1.</td> <td rowspan="2"></td> </tr> <tr> <td>2.</td> </tr> <tr> <td rowspan="2">Faza _____</td> <td>1.</td> <td rowspan="2"></td> </tr> <tr> <td></td> </tr> </tbody> </table> - Çfarë kuptoni me shprehjen “<i>lumturi pagane</i>”, në cilën fazë shfaqet ajo, dhe në cilat vepra të Kamysë? kuptimi i shprehjes _____ faza në të cilën shfaqet _____ vepra _____ - Cili është kuptimi i absurdit për Kamynë dhe në cilat vepra e trajton? Absurdi vepra ku trajtohet: - Si shfaqet absurdi dhe indiferenca në veprat e fazës së dytë? - Çfarë shpreh nocioni i revoltës dhe ç’raport është ai me absurdin? - Krahazo krijimtarinë e Kamysë në fazën e dytë dhe fazën e tretë për të zbuluar ndryshimet mbi mendimin/filozofinë e tij për njeriun. <u>Njeriu dhe fati i tij</u> - Çfarë kuptoni me <i>letërsi të angazhuar</i>? Ku del ajo në veprën e Kamysë? - Çfarë është filozofia ekzistencialiste dhe si shfaqet ajo te Kamyja? - Si e kuptoni shprehjen e Kamysë: “<i>Rebelohem pra jemi?</i>” - Flisni për personazhet emblematike të veprave të Kamysë. Çfarë i karakterizon këto personazhe? - Në cilat vepra dalin temat themelore të veprës së Kamysë? Plotësoni tabelën e mëposhtme.		Ese	Romane, novela	Drama				Fazat	Veprat	Temat dhe motivet	Faza _____	1.		2.	Faza _____	1.		2.	Faza _____	1.		2.	Faza _____	1.		
Ese	Romane, novela	Drama																								
Fazat	Veprat	Temat dhe motivet																								
Faza _____	1.																									
	2.																									
Faza _____	1.																									
	2.																									
Faza _____	1.																									
	2.																									
Faza _____	1.																									

Temat themelore dhe motivet	Veprat
Miti i diellit, i natyrës, i lumturisë	
Miti i njeriut ose i shenjtorit pa Perëndi	
Mërgimi dhe vetmia	
Një vetëdije e shqetësuar: nga tehuajtja te solidariteti	

Në cilat vepra del tema e dashurisë të Kamyja?
 - Si e kuptoni absurdin e teorizuar në esetë dhe të aktualizuar në vepra nga Kamyja?

- Ku e ka burimin revolta në veprën e Kamysë? Çfarë ka si objektiv revolta? Si e arrin fitoren kundër irracionalitetit?

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur:
 Cili është mesazhi i veprave të Kamysë? Sa aktual është moralizimi i Kamysë?
 Shkruaj një ese me temë mesazhin e shkruar prej jush, për veprat e Kamysë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 10

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Analizë “I huaji”</i> Sfondi. Tematika, Personazhet, Gjuha dhe stili, Mesazhe		Situata e të nxënit: <i>Bisedë me temë:</i> Përplasja e këndvështrimeve të ndryshme çon drejt tragjedisë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit; - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; - analizon gjuhën, mjetet e teknikat me anë të të cilave Kamy shfaq revoltën e Mersosë; - gjykon dhe vlerëson qëndrimin humanist të Kamysë në romanin “I huaji”.		Fjalët kyçe: ▪ Figurë komplekse ▪ Qëndrim humanist ▪ Revoltë ▪ Absurd ▪ Shpërfillje ▪ Shpresë	
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Vepra artistike “I huaji” ▪ Analiza dhe studime ▪ Interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Arte ▪ Histori ▪ Gjeografi ▪ Tik ▪ Gjuhë shqipe ▪ Qytetari	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Hartë koncepti - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh

Organizimi i orës së mësimit

Informacion i ri

- Romani “*I huaji*” Kamyja e ka shkruar dhe botuar në vitin 1942. Duke iu referuar vitit të botimit ndërtoni kontekstin historik-politik të Francës së viteve ‘40.

- Në sa pjesë është organizuar/strukturuar vepra? Përcakto numrin e kapitujve për secilën pjesë.

Pjesa 1					Pjesa 2				
Kapituj					Kapituj				
E veçanta e rrëfimit e pjesës së parë					E veçanta e rrëfimit e pjesës së dytë				

- Flisni për stilin, për ndryshimet mes pjesës së parë dhe të dytë, për ndikimet e Kamysë nga autorë të tjerë.

- Ku zhvillohen ngjarjet në vepër? Në ç’kohë zhvillohen ngjarjet (a e ka përcaktuar autori kohën në roman?)?

Cilat janë të dhënat, për të na ndihmuar ne si lexues, të kuptojmë se për ç’kohë flitet? Përcakto kohën e brendshme në vepër.

- vendi _____
- koha e jashtme _____
- koha e brendshme _____ - _____

Punë e pavarur individuale

- Përmblihdh me tri fjali fabulën e romanit

- Cili është personazhi kryesor i romanit? Si quhet ai? Cili është statusi i tij shoqëror? Si jeton ai? personazhi kryesor _____

kush është ai

- Përse themi se kemi të bëjmë me një figurë komplekse kur i referohemi atij? Kur bëhet e qartë dykuptimësia e personazhit? Çfarë ka bërë në të vërtetë e përse gjykohej?

Punë me grupe

- Interpretu kuptimin e titullit të romanit “*I huaji*”. Analizoni raportin e Mersoit me:

Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Grupi 4
• me ne • me veten • me mjedisin ku jeton	• me trupin gjykues • me lirinë	• me botën algjeriane • me jetën • me Zotin	• me diellin • me krimin • me vdekjen

- Listo temat dhe motivet e trajtuara në vepër.

- Cila është filozofia e romanit?

- Si del qëndrimi humanist i Kamysë në këtë roman?

- Me ç’mjete e teknika Kamy shfaq revoltën e Mersosë?

- Në ç’mënyrë Kamyja zbulon absurdin te ky roman?

- Sartri nuk e ka pranuar përcaktimin e stilit të Kamysë si “*Kafka i shkruar me stilin e Hemingueit*”. Ju si mendoni?

Bisedë: Dinjiteti i njeriut mbështetet në parimin: “Njeriu është farkëtar i fatit të tij”.

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi i punës në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur:

- Kritikë të ndryshëm janë përpjekur të heqin paralele mes Mersosë dhe Zhuljen Sorelit të Stendalit, Raskolnikovit të Dostojevskit. Bëni një kërkim për dy personazhet dhe thoni mendimin tuaj në lidhje me këtë. Ku takohen dhe në ç’aspekte ndryshojnë ata?

- Në lidhje me zgjedhjen e emrit të personazhit, janë bërë shumë hamendësime. Bëni një kërkim dhe jepni mendimin tuaj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 11

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Studim teksti</i> Fragmenti “Filmi i të dielës/Asgjë nuk kishte ndryshuar”		Situata e të nxënit: <i>Bisedë me temë:</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • Personale • Qytetare • Digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit; - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; - zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit; - identifikon në tekst veçoritë e stilit të autorit; -shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike; - realizon përshkrimin e personazheve në plane e aspekte të ndryshme.		Fjalët kyçe: ▪ Absurd ▪ Raport ▪ Mosndryshim ▪ Ftohtësi ▪ Vetmi	
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Vepra artistike “I huaji”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Tik ▪ Gjuhë shqipe ▪ Qytetari	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Përmbledhja - Hartë koncepti - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë e pavarur individuale - Punë me grupe - Ditari dypjesësh			
Organizimi i orës së mësimi Përmbledhja - Përmbledhni përmbajtjen e tekstit në dhjetë rreshta. Analizim - Pyetje-përgjigje - Komentoni titullin e fragmentit: <i>Filmi i së dielës</i> . Çfarë tregon ai? Çfarë bën Merso gjatë ditës dhe si rrëfen veprimtarinë e së dielës? Referimet kohore (mëngjes, ora dhjetë, drekë, mbasdite,) - Përse Merso shprehet “ <i>e diela nuk më pëlqen</i> ”? - Në mëngjes Maria kishte ikur. E diela nuk më pëlqen. Kërkova nëpër jastëk aromën e kripur që kishin lënë flokët e Maries dhe fjeta deri në orën dhjetë. Pastaj piva cigare, gjithnjë shtrirë, deri në drekë. Nuk doja ta haja drekën te Çeleste si zakonisht sepse, me siguri, do të më bënin pyetje e kjo gjë s’më pëlqen. Skuqa vezë dhe i hëngra në tigan, pa bukë, se s’kisha dhe s’doja të zbrisja për të blerë. - Pas drekës, s’kisha ç’të bëja dhe shëtita nëpër shtëpi. Ajo ishte e rehatshme kur ishte mamaja. Punë e pavarur individuale - Portretizo Mersonë duke iu referuar atyre ç’ka ai bën dhe relacioneve me njerëzit dhe sendet? Punë me grupe Grupi 1 - Si i duket tani shtëpia Mersosë? A është e rehatshme? Kur i jepte rehati? A na ndihmon ky detaj për të kuptuar lidhjen mes Mersoit dhe mamasë? • fjala kyçe për shtëpinë			

Grupi 2 - Përshkruaj me detaje nga teksti shtëpinë.

- A është e rehatshme? (përgjigju me po ose jo) Po / Jo
- Kur i jepte rehati _____
- Raporti me nënën _____

- Jep ngjyresat kuptimore që sugjeron fjala e madhe në fjalinë “Tani është tepër e madhe për mua dhe m’u desh të çoja tavolinën e bukës në dhomën time të gjumit.”

p.sh. e madhe - e ftohtë
e madhe - vetmi
e madhe - _____ etj.

Grupi 3 - Çfarë tregon nevoja e Mersoit për aromën e kripur që kishin lënë flokët e Maries? Pse pikërisht aromë e kripur?

- Cila është trajta e ligjëritimit dominues në këtë fragment? Cili është roli i përdorimit të saj?

Detaje që përvijojnë veprimet e Mersoit	Detaje që zbulojnë gjendjen e Mersoit	Detaje që zbulojnë mendimet e Mersoit

Lexim nga teksti - shpjegim

- Identifiko në tekst raste të përdorimit të kontrastit. Shpjego funksionin e përdorimit të këtij mjeti.
- Cili është qëllimi i përshkrimit të banorëve të lagjes nga ballkoni i Mersoit?

- Zbuloni veçori të gjuhës dhe të stilit të Kamysë:

- në aspektin gjuhësor:
 - aspekti leksikor;
 - aspekti morfologjik;
- në lidhje me figuracionin;
- në lidhje me teknikën e rrëfimit;
- në lidhje me kuptimet filozofike që përcjell vepra.

- Interpreto kuptimin e fjalisë së fundit të fragmentit:

“Po mendoja, kaloi dhe kjo e diel, mamaja ishte varrosur, unë do të rifilloja punën dhe tek e fundit, asgjë s’kishte ndryshuar.”

Diskutim

Çfarë nuk kishte ndryshuar nga të dielat e tjera?

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi i punës në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përshkruaj veprimtaritë e një dite të diele të kaluara nga ju. A ndryshon e diela juaj nga ajo e Mersoit?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 12

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: Studim teksti Fragmenti “Porta e fatkeqësisë. Vrasja e arabit”		Situata e të nxënës: Bisedë me temë: Njeriu duhet të thotë të vërtetën	

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit; - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; - zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit; - identifikon në tekst veçoritë e stilit të autorit; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike; - realizon përshkrimin e personazheve në plane e aspekte të ndryshme.	Fjalët kyçe: ▪ Diell ▪ Mit ▪ Absurd ▪ Vrasje ▪ Natyrë ▪ Efekt
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Vepra artistike “I huaji”	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Gjuhë shqipe ▪ Qytetari ▪ Psikologji
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Punë e pavarur individuale - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh - Hartë koncepti	
Organizimi i orës së mësimi Punë e pavarur individuale - Inkuadroje fragmentin në lidhje me gjithë veprën (<i>jemi në fund të pjesës së parë</i>). <i>Është e diel. Mersò dhe Marie ftohen nga Rajmondi ta kalojë ditën në një kabinë të miqve në plazh. Një mëngjes me diell, rreth orës 11.30 një shëtitje në plazh. Rajmondi dhe Merso u ndoqën nga një grup arabësh, mes të cilëve ndodhet vëllai i ish të dashurës së Rajmondit, të cilët dalin papritur. Rajmondin e plagosin me thikë. Më vonë, nën shpërthimin e diellit, Mersò shëtit sërish në plazh, me pistoletën që i ka dhënë Rajmondi; papritur sheh sërish arabin me thikën në dorë. Skena zhvillohet në plazhin e Algjerit. Në gjithë episodin vihet re përdorimi i lidhëzave kundërshtuese të cilat sanksionojnë kalimet nga mosveprimi në veprim dhe anasjelltas, nga ana tjetër tregojnë armiqësinë që bota shfaq përkundrejt çdo objekti njerëzor. - shkëputur nga teksti</i> Pyetje-përgjigje - Analizim - Nëpërmjet fjalisë “<i>Po ai vezullim i kuq</i>”, autori kërkon ta përfshijë lexuesin ta shohë diellin nga bota e Mersoit. - Që në fjalinë e parë të fragmentit kemi takimin e Mersoit me diellin “<i>...dielli vezulloi mbi të</i>”. A mendoni se është i rastësishëm konstatimi i pranisë së tij në sfond apo i qëllimshëm? Pse? - Autori do të na sjellë imazhin e diellit disa herë përgjatë fragmentit. A ka kontroll Merso mbi diellin apo dielli mbi Mersoin? Cili është efekti që ka ai? (a e përballon dot?) • dielli mbi Mersoin apo • Merso mbi diellin efekti që ka _____	

- Duke iu referuar fjalive të shkëputura nga fragmenti interpretoni përshkallëzimin veprimit dhe gjendjes së brendshme. A ka mundur Kamy, përmes kësaj teknike, të zbërthejë botën e brendshme të Mersoit? Përse dielli i ngjason me diellin e ditës kur nëna vdiq? Ç'tregon ky fakt?

- *"Ishte shtrirë në kurriz, duart nën zverk, balli nën hijen e shkëmbit, i gjithë trupi në diell."*
- *Po ai diell, po ajo dritë mbi po atë rërë që shtrihej deri këtu.*
- *"Por një plazh i tërë që fërgëllonte nga dielli, ngjeshej pas meje"*
- *"Dielli ishte si atë ditë kur varrosa mamanë dhe si atëherë, balli më dhimbte e të gjitha venat rrihnin fort nën lëkurë"*
- *"Nxehtësia e diellit po më përvëlonte faqet dhe ndjeva bulëza djerse të më grumbulloheshin mbi vetulla."*
- *"Nuk mund ta duroja më përvëlimin e diellit dhe bëra një hap përpara".*
- *E dija që ishte marrëzi e një hap nuk më shpëtonte dot nga dielli.*
- *Këtë herë arabi, pa luajtur nga vendi, nxori thikën dhe e drejtoi nga dielli.*
- *Ndjeja vetëm goditjet e diellit mbi ballë dhe në mënyrë të turbullt tehun vezullues të thikës para fytyrës sime*

- Listoni disa nga efektet që dielli ka mbi Mersoin.

_____	_____
_____	_____
_____	_____

- *"Nxehtësia e diellit po më përvëlonte faqet dhe ndjeva bulëza djerse të më grumbulloheshin mbi vetulla."*
- *"Nuk mund ta duroja më përvëlimin e diellit dhe bëra një hap përpara".*
- *E dija që ishte marrëzi e një hap nuk më shpëtonte dot nga dielli.*
- *Ndjeja vetëm goditjet e diellit mbi ballë dhe në mënyrë të turbullt tehun vezullues të thikës para fytyrës sime.*

- Përse Merso i mendon "Si të rrija, si të ikja ishte e njëjta gjë" ?

- Cili është mjeti stilistik që përftohet nga pranëvënia e dy fjalive: *"Në breg deti rënkonte nën frymëmarrjen e shpejtë e të mbytur të valëve të tij të vogla. Ecja ngadalë drejt shkëmbinjve e ndjeja dejet në ballë që fryheshin nën nxehtësinë e diellit."*

- Kontrasti
- apo
- Paralelizmi

Shpjego qëllimin e përdorimit të këtij mjeti.

qëllimin i përdorimit _____

Ditari dypjesësh

- Evidento mjete të tjera të përdorura dhe shpjego funksionin e përdorimit të tyre.

Figurat letrare	Funksioni i përdorimit

Punë e pavarur individuale

- Përshkruaje Mersoin mes veprimit dhe mosveprimit.

- Si jepet në fragment raporti i Mersoit me natyrën, prishja e harmonisë, miti i diellit, i natyrës?

- Vetë Merso i pohon:

“E kuptova se e kisha prishur ekuilibrin e ditës, qetësinë e jashtëzakonshme të plazhit ku kisha qenë i lumtur.”

Zbërtheni kuptimin filozofik që të përcjellë Kamyja me këtë sentencë kuptimore.

Punë me grupe

- Zbuloni veçori të gjuhës dhe të stilit të Kamysë:

Grupi 1

- në aspektin gjuhësor:
 - aspekti leksikor;
 - aspekti morfologjik.

Grupi 2

- në lidhje me figuracionin.

Grupi 3

- në lidhje me teknikën e rrëfimit.

Grupi 4

- në lidhje me kuptimet filozofike që përcjell vepra.

Prezantim dhe diskutim i punës në grup

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish

Detyrat dhe puna e pavarur:

Krahaso veçori të gjuhës së fragmentit:

- Porta e fatkeqësisë/Vrasja e arabit;
- Filmi i së dielës/Asgjë nuk kishte ndryshuar.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 13

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Studim teksti</i> Fragmenti “ Realiteti i huaj ”		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit • Personale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit; - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; - zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit; - identifikon në tekst veçoritë e stilit të autorit; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike; - realizon përshkrimin e personazheve në plane e aspekte të ndryshme.			Fjalët kyçe:
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Vepra artistike “I huaji”			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Gjuhë shqipe ▪ Qytetari ▪ Psikologji

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Lexim i tekstit - Punë e pavarur individuale - Hartë koncepti - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe
- Ditari dypjesësh

Organizimi i orës së mësimit

Lexim i tekstit - Punë e pavarur individuale

Ndani fragmentin në sekuenca dhe vendosni nga një titull për secilën sekuenca.

Pjesa

Titulli

Pyetje-përgjigje

Merso citon në ligjëratë të drejtë fjalët e prokurorit:

“Unë ju kërkoj kokën e këtij njeriu, tha ai, dhe jua kërkoj me zemër të lehtësuar. Sepse nëse gjatë karrierës sime shumëvjeçare më ka ndodhur të kërkoj dënime me vdekje, kurrë nuk e kam ndjerë më shumë se sot se detyra ime e vështirë po shpërblehet, po ndriçohet nga ndërgjegjja e një urdhri të prerë e të shenjtë dhe nga neveria që ndjej përballë një fytyre njeriu ku nuk lexoj veçse tmerr.”

- Përse me zemër të lehtësuar?
- Përse prokurori mendon se detyra e tij e vështirë po shpërblehet?

Përse sot më shumë se kurrë?

Analizim

Shpjego kuptimet e frazave:

- *ndriçohet nga ndërgjegjja e një urdhri të prerë;*
- *ndriçohet nga ndërgjegjja e një urdhri të shenjtë.*

Përse theksohet ndjesia e prokurorit (*neveria që ndjej*) përballë një fytyre njeriu.

A ka tentuar prokurori të shkojë përtej fytyrës/asaj ç’ka duket së jashtmi?

- ☐ Po
- ☐ apo
- ☐ Jo
- ☐

A rrjedhin pasoja nga kjo formë gjykimi

- “Unë isha i trulllosur nga vapa dhe habia.” - thotë Merso . Përse ai është i habitur?


- Ndërkohë që prokurori kërkon kokën e tij, ai tërhiqet nga tingujt e burisë së një akulloreshitësi .Ç’tregon kjo?

- Cili është mesazhi që do të përcjell nëpërmjet konstatimit që bën Merso “Më mbërthyen kujtimet e një jete që s’më perkiste më, por ku unë kisha gjetur gëzimet më të vogla e më të forta: aromat e verës, lagjen e dashur, qiellin e veçantë të mbrëmjeve, të qeshurën dhe fustanet e Maries.

- Çfarë e ka bërë Mersoin t’i shohë gjërat me sy tjetër?

Punë e pavarur individuale - Organizuesi grafik

- Përshkruaj raportin e Mersoit me prokurorin, të tjerët, mamanë, priftin, Zotin.



Punë në grupe

- Zbuloni veçori të gjuhës dhe të stilit të Kamysë:

Grupi 1

- në aspektin gjuhësor:
 - aspekti leksikor;
 - aspekti morfologjik;
 - aspekti sintaksor.

Grupi 2

- në lidhje me figuracionin;
- në lidhje me teknikën e rrëfimit.

Grupi 3

- në lidhje me kuptimet filozofike që përcjell vepra.

Diskutim

- Përse Merso uron që ditën e ekzekutimit të kishte sa më shumë njerëz dhe ta prisnin me britma urrejtjeje?

Vlerësimi:

Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi i punës në grup. Vlerësim mes nxënësish

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruaj një ese me temë: Njeriu është e vetmja krijesë që refuzon të jetë ajo që është.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 14

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: ESE		Situata e të nxënit: Reflektim mbi temat që trajtohen në veprat e Kafkës dhe Kamysë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - E komunikimit dhe të shprehurit - E të menduarit - Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Personale - Qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore		Fjalët kyçe:	
Nxënësi/ja: - veçon tiparet e stilit dhe analizon e shpjegon se si ndikojnë ato te lexuesi dhe në tekst; - analizon dhe vlerëson gjuhën e figurshme;		- Sprovë - Reflektim - Interpretim - Risi - Opinion	

- vlerëson cilësitë estetike të gjuhës së një teksti; - reflekton në mënyrë kritike përmes analizave, interpretimit, vlerësimit, krahasimit dhe sintezës së tekstit; mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - organizon qartë, saktë dhe në mënyrë logjike mendimet, ndjenjat dhe opinionet e tij (me shkrim).	▪ modern ▪ Mendim ▪ Organizim ▪ Strukturë ▪ konkluzion																
Burimet: ▪ Vepra të Kafkës dhe Kamysë ▪ Analiza dhe studime ▪ Interneti Mjeti – fleta e esesë	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Gjuhë shqipe ▪ Filozofi ▪ Qytetari																
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Hartë koncepti/Organizuesi grafik - Punë e pavarur individuale me shkrim																	
Organizimi i orës së mësimit Hapat që do të ndiqen: ▪ Lista e ideve ▪ Organizimi i ideve/Harta e ideve/shkallëza ▪ Shkrimi i esesë duke respektuar rregullat për aspektin strukturor dhe gjuhësor																	
<table><tr><th>Struktura</th><th>Ideja</th><th>Gjuha-stili</th><th>Drejtshkrimi</th></tr><tr><td>Hyrja: Konteksti i përgjithshëm Konteksti specifik Problemi Teza blueprinti</td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>Zhvillimi: Argumenti: Fjali drejtuese Zhvillimi i paragrafit Përmbyllja e paragrafit</td><td></td><td></td><td></td></tr><tr><td>Paragrafi përmbyllës: Konkluzionet Rimarrja e tezës Perspektiva</td><td></td><td></td><td></td></tr></table>	Struktura	Ideja	Gjuha-stili	Drejtshkrimi	Hyrja: Konteksti i përgjithshëm Konteksti specifik Problemi Teza blueprinti				Zhvillimi: Argumenti: Fjali drejtuese Zhvillimi i paragrafit Përmbyllja e paragrafit				Paragrafi përmbyllës: Konkluzionet Rimarrja e tezës Perspektiva				
Struktura	Ideja	Gjuha-stili	Drejtshkrimi														
Hyrja: Konteksti i përgjithshëm Konteksti specifik Problemi Teza blueprinti																	
Zhvillimi: Argumenti: Fjali drejtuese Zhvillimi i paragrafit Përmbyllja e paragrafit																	
Paragrafi përmbyllës: Konkluzionet Rimarrja e tezës Perspektiva																	
Vlerësimi: Vlerësim i punës me shkrim. Vlerësim i vazhduar.																	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 15


Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi		Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: Letërsia shqipe e gjysmës së parë të shekullit XX. Gjergj Fishta Momentet kryesore të jetës së Fishtës. Veprat letrare të Fishtës në poezi dhe dramë. Idetë universale në veprën e Fishtës dhe mesazhet që i sjellin kohës sonë.			Situata e të nxënit: Diskutim me temë: Tradita epike në letërsinë tonë	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - E komunikimit dhe të shprehurit - E të menduarit - E të nxënit - Personale - Qytetare - Digjitate				
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - vlerëson kontributin e Fishtës në publicistikë, politikë, çështjet kombëtare, teologji, letërsi; - përshkruan momentet kryesore të jetës që ndikuan në krijimtarinë letrare të Fishtës; - rendit veprat kryesore të Fishtës (poema “Lahuta e Malcis, poezitë, dramat etj.); - analizon idetë universale në veprën e Fishtës dhe përshkruan mesazhet që i sjellin kohës sonë.			Fjalët kyçe: - Romantizëm - Realizëm - Kontrast - Idealizim - Kritikë - Mesazhe universale - Forcë shprehëse	
Burimet: - Teksti mësimor - Vepra artistike - Analiza dhe studime letrare - Interneti			Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Arte Histori Gjeografi Gjuhë shqipe Tik	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Hartë koncepti/Organizuesi grafik - Lexim i drejtuar - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë e pavarur individuale - Ditari dypjesësh				

Organizimi i orës së mësimit

Organizuesi grafik

- Veçoni momentet kryesore të jetës së Fishtës të cilat mundësuan zhvillimin e një krijimtarie të larmishme.



Lexim i drejtuar

- Në krijimtarinë letrare të Fishtës evidentohen elemente të romantizmit, realizmit dhe klasicizmit.


Ç'tregon/Ç'dëshmon kjo?

Hartë mendimi

- Ndërto një hartë mendimi me veprat duke i klasifikuar ato sipas drejtimit letrar, llojit, gjinisë, tematikës.

- Çfarë gjinish lëvroi Fishta me krijimtarinë e tij? Cila janë temat mbizotëruese në lirikën e Fishtës?

- Paraqitni karakteristikat kryesore sipas klasifikimit të bërë më parë.



Informacion i ri - Lexim i drejtuar - Pyetje-përgjigje

1. Çfarë teme trajton lirika "Burrnia"? Autori përball në këtë poezi elemente të kundërta si jeta dhe vdekja. Cili nuk i përkulet vdekjes? Ç'mesazh ka dashur të përcjellë autori?
2. Cilat ishin shtysat që e nxitën Fishtën të lëvronte gjininë dramatike?
3. Cilat janë melodramat më të njohura të Fishtës? Për këtë pyetje do të sugjeroja

Analizim

Veçoni, nga vepra dramatike e Fishtës, ato më të njohurat. Ç'karakteristika vërehen te këto vepra? Me ç'qëllim i ka shkruar autori?

- Nga i marrin subjektet e tyre veprat dramatike të Fishtës? A gjejmë raste të tjera në letërsinë botërore që i marrin subjektet e tyre nga burime fetare?

- Cilat ishin burimet që Fishta shfrytëzoi në shkrimin e veprave të tij dramatike?

Punë e pavarur individuale

- Gjuha dhe stili i përdorur në veprat e tij dëshmon nga njëra anë njohjen e letërsisë gojore shqiptare si dhe asaj klasike evropiane, por nga ana tjetër spikatin talentin, mendjemprehtësinë, ndjeshmërinë e lartë, origjinalitetin krijues. Argumento, përmes krijimeve të Fishtës, ekzistencën e këtyre vlerave.

Pyetje-përgjigje

- Si është interpretuar poezia "Nji lule vjeshtet" nga studiuesit?

- Kujt i kushtohet poezia një lule vjeshte? Çfarë ju sugjeron titulli? Cilat janë motivet e trajtuara në poezi?

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi i punës në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Detyrë shtëpie - Vepra e Fishtës përcjell mesazhe universale. Sa aktual është ai? Mendimin konkretizojë duke iu referuar poezisë "Surgite mortui"! (Çohuni të vdekur!)

Ose

Si shkrimtar Fishta himnizoi Shqipërinë dhe shqiptarët, por njëkohësisht pati kurajon të drejtonte shigjetat e kritikës për nga problematika të kohës. Kjo qasje ndaj realitetit solli një qëndrim të ashpër (për një periudhë gjysmëshekullore) kundrejt figurës së tij. Sillni në klasë informacion për të dëshmuar përpjekjen për të lënë në haresë krijimtarinë e tij.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 16

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Analizë</i> “Lahuta e Malcis” Rrethanat e lindjes së veprës, qëllimi. Konflikti bazë. Kulti i trimërisë. Idetë. Mesazhet. Personazhet e larmishëm		Situata e të nxënit: Lahuta vegla arkaike muzikore me të cilën malësori i këndoi heroit, gëzimit, por dhe problematikave të jetës.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit • Personale • Digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - përshkruan realitetin shqiptar në kohën kur shkruan Fishta; - formulon idetë e Fishtës për ndryshimin e gjendjes; - analizon mesazhet që përcjell poema “Lahuta e Malcisë”.		Fjalët kyçe: ▪ Romantizëm ▪ Realizëm ▪ Kontrast ▪ Idealizim ▪ Kritikë ▪ Mesazhe universale ▪ Forcë shprehëse	
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Poema “Lahuta e Malcis”.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Arte ▪ Histori ▪ Gjeografi ▪ Gjuhë shqipe ▪ Tik	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Hartë koncepti - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Diagrami i Venit			
Organizimi i orës së mësimi Diskutim - Përse autori zgjedh ta titullojë “Lahuta e Malcis” veprën e tij? - Sa kohë iu desh Fishtës për të realizuar të plotë veprën “Lahuta e Malcis”? Kur u botua vepra e plotë? Ç’regon ky fakt? Lexim i drejtuar - Pyetje-përgjigje Cilat janë këngët e para të shkruara dhe të botuara nga vepra “Lahuta e Malcisë”? Kur u botua vepra e plotë? Cili ishte konteksti historik kur u shkrua kjo vepër? Cili ishte qëllimi jashtë letrar që e shtyu Fishtën të shkruajë eposin? Cili ishte qëllimi jashtë letrar që e shtyu Fishtën të shkruajë eposin? Përshkruaj rrethanat historike, kulturore në të cilat u krijua vepra. Vepra është cilësuar model i eposit poetik kombëtar. Cilat janë ato elemente që e klasifikojnë si të tillë këtë poemë?			

Punë në grupe

Grupi 1 - Cili është mesazhi artistik i veprës? Cilat janë konfliktet mbi të cilat është ndërtuar vepra?

Grupi 2 - Përmendni tri momentet kryesore kohore në të cilat është përqendruar veprimi artistik?

Grupi 3 - Si paraqiten ngjarjet historike në veprën letrare?

Diskutim

Pse “Lahuta e Malcisë” quhet vepër epiko-historike?

Pse mund të themi se kjo vepër mësohet lehtë përmendësh?

Analizim

Nga i merr Fishta figurat fantastike?

Diagram i Venit Përmendni elementet e ngjashmërisë mes eposit fishtian dhe eposeve homerike? Cilat ndryshime janë ndryshimet me eposet homerike?



Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi i punës në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur: Lahuta e Malcisë është quajtur nga shumë studiues “Iliada” shqiptare. Përse studiuesit mendojnë kështu?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 17

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: Studim teksti kënga “Cubat”		Situata e të nxënit: Lexo hyrjen e “Iliadës” dhe të “Histori e Skëndërbeut” të Naim Frashërit si dhe hyrjen e këngëve të Ciklit të Kreshnikëve.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare • Digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit; - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; - zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit;		Fjalët kyçe: ▪ Histori ▪ Ngjarje historike ▪ Figura mitologjike ▪ Forcë shprehëse ▪ Figuracion popullore ▪ Tema atdhetare ▪ Epos	

- identifikon në tekst veçoritë e stilit të autorit; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike; - realizon përshkrimin e personazheve në plane e aspekte të ndryshme.	
Burimet: ▪ Teksti ▪ Vepra	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Gjeografi ▪ Histori ▪ Gjuhë shqipe
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Hartë koncepti - Analizim - Pyetje-përgjigje - Analizim - Punë e pavarur - Diskutim - Prezantim	
Organizimi i orës së mësimi Organizuesi grafik - Si klasifikohen personazhet në këtë vepër? - Sa lloje personazhesh veprojnë në vepër? Listo disa prej tyre sipas llojit. Cili është funksioni i gërshetimit të tyre? Klasifikimi i personazheve > - Si i ka zgjedhur dhe si i ka ndërtuar Fishta personazhet e veprës së tij? - Ç’rol luajnë figurat mitologjike? Ç’ndryshim kanë këto personazhe nga ato të Ciklit të Kreshnikëve dhe krijimeve të tjera të folklorit? Pyetje-përgjigje - Analizim - Cilat janë ato veçori të gjuhës e të stilit që i japin veprës karakterin e një eposi kombëtar? Punë e pavarur individuale - Diskutim - Fjala dhe përdorimi i saj - Gjej në 15 vargjet e para, figurën e hiperbolës. Diskutoni në lidhje me qëllimin e saj. Shpjego funksionin e përdorimit të këtij mjeti stilistik Analizim - Me çfarë figure letrare kemi të bëjmë në këto vargje: Po a s'ta mbushë synin Shqipnia,/me ato male të madhnueshme,/me ato fusha të blerueshme,/qi kurrkund s'jè kah orvate. Punë e pavarur - Gjeni shembuj të tjerë të kësaj figure në këtë këngë. - Gjeni/identifikoni dy lloje figurash letrare në këto vargje (një figurë kuptimi dhe një figurë të shqiptimit poetik): Edhë flamuri i Shqypnís,/Si fletë Engj’lli t’Perendís,/Si ajo flaka e rrfësë zhgjetare,/Me u suvalë prap m’ tokë shqiptare. Diskutim dhe prezantim i detyrës	
Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësim i punës së pavarur	
Detyrat dhe puna e pavarur: Realizoni përmbledhjen e këngës “Cubat” në prozë (përmbledhja nënkuptohet në prozë a mos do ishte më mirë të orientohej nxënësi ku do ta vinte theksin).	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 18

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa:12
Tema mësimore: Studim teksti “Oso Kuka”		Situata e të nxënit: <i>Diskutim me temë: Fataliteti heroik - Vetëflijimi në letërsinë shqipe gojore dhe artistike. Studim teksti</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit; - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; - zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit; - identifikon në tekst veçoritë e stilit të autorit; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike; - realizon përshkrimin e personazheve në plane e aspekte të ndryshme.		Fjalët kyçe: ▪ Trim ▪ Histori ▪ Traditë ▪ Idealizim ▪ Konflikt ▪ Elemente epike	
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Vepra “Lahuta e Malcisë”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Gjeografi ▪ Histori ▪ Gjuhë shqipe	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lexim - Shpjegim teksti - Analizim përmes shembujve - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh			
Organizimi i orës së mësimi Lexim - shpjegim teksti Cila është fyerja që i bën Avdi Pasha shqiptarëve? Ç’mjet stilistik ka përdorur autori? Mendoni se kjo fyerje e tij është e paramenduar për të ngacmuar aty ku duhet, duke ditur krenarinë e shqiptarëve? * Çfarë emocionesh ndjen Oso Kuka kur dëgjon pashën “turçeli” të thotë “paska mbetë Shqipnia n’vasha”? * Nga janë 40 djemtë shqiptarë të zgjedhur në çetën e Oso Kukës? Ku qëndrojnë elementët epikë në përshkrimin e këtyre heronjve? Analizë përmes shembujve - Punë me grupe Grupi 1 - Fishta nxjerr në pah mënyrën arbitrare të sjelljes së Evropës ndaj shqiptarëve. Analizoji këto fakte nëpërmjet vargjeve: n’krye t’javës dielli kur u cue,/për me shndëritë mi kobë t’shëklit,/kù e perbuxnë shuen e Drëjta,			

Grupi 2 - Analizoni vargjet (në ç'aspekt do të analizohen?): Ehu! Bre Oso, Oso-rrfeja,/ç' kan me t' name dy vasha t' reja/ç' kan me t' nam dy bija nane. Pse do ta nëmin Oso Kukën? Çfarë parashikojnë këto vargje?

Grupi 3 - Komentoni betimin e Oso Kukës duke u nisur nga koha kur zhvillohen ngjarjet. “qi për Mbret e troje t' veta/nuk u dhimbet gjâja as jeta:/e kû i lypë besa e burrnia,/Kû i lypë Mbreti e i lypë Shqypnija”. Për çfarë është gati të sakrifkohet ai?

Diskutim - vlerësim dijesh - Ç'përfaqëson Oso Kuka dhe 40 djemtë që e ndjekin dhe ç' përfaqëson Vulo Radoviq-i me cubat e tij? Ku qëndron ndryshimi mes tyre?

Punë e pavarur Gjenerali në këto vargje, figurën letrare tipike për “Lahutën e Malcisë”. Gjenerali raste të tjera të kësaj figure në këtë këngë. qi po vrasin djelmët e rí/qi po marrin lopët me viça,/qi po presin dhënt me oqiça,/qi po dëgjin kulla e stane,/e po thajnë kaq zëmra nane! Ku e keni hasur tjetër përdorimin e kësaj figure? Çfarë tregon kjo pikëlidhje?

Analizë përmes shembujve. Fishta kërkon që poema e tij të jetë më shumë se histori. Heronjtë, ndonëse njerëz të vërtetë janë ngritur në nivelin e legjendës. Aj është Çoku i Mar Kolë Dinit Prej Kabashit t' Dukagjinit: Trim i çartun, trim si Zânë. Përveç figurës së krahasimit çfarë figure tjetër kemi në këto vargje? Analizojeni mënyrën sesi është ndërtuar (në ç'aspekt ndërtimi? Përsëritja, aliteracioni, asonanca apo emër + mbiemër dhe emër + emër prandaj duhet të adresohet qartë).

Ditari dypjesësh Vëreni me kujdes detajet që përdor shkrimtari në përshkrimin e djemve që bëjnë pjesë në çetën e Oso Kukës. Gjenerali në tekstin e këngës disa krahasimet foljore, dhe disa krahasime emërore.

Krahasime emërore	krahasimet foljore

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësimi i punës së pavarur

Detyrat dhe puna e pavarur:

- Gjenerali figura të tjera të historisë së kombit të cilët janë vetëflijuar për lirinë e kombit:

- Gjenerali informacion për figurën historike të Oso Kukës dhe krahasojini ato me përshkrimin dhe vizionin që krijoni nga vepra e Fishtës.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 19

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: Kënga e XXV Studim teksti “Gjaku i marrun”		Situata e të nxënit: <i>Diskutim me temë:</i> Fataliteti heroik - Vetëflijimi në letërsinë shqipe gojore dhe artistike. <i>Studim teksti</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - E komunikimit dhe të shprehurit - E të menduarit - Personale - Qytetare			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit; - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; - zbulon mesazhet që përcillen me anë fragmentit; - identifikon në tekst veçoritë e stilit të autorit; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike; - realizon përshkrimin e personazheve në plane e aspekte të ndryshme.	Fjalët kyçe: Figura mitologjike ▪ Zana ▪ Orë ▪ Hakmarrje ▪ Konflikt ▪ Luftëtar
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Vepra “Lahuta e Malcisë”	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Gjeografi ▪ Histori ▪ Gjuhë shqipe ▪ Psikologji
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Hartë koncepti - Analizim - Organizuesi grafik - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh	
Organizimi i orës së mësimi Lexim i tekstit - Pyetje-përgjigje - Çfarë roli merr përsipër të luajë Ora e Durmitorit në këtë këngë të “Lahutës së Malcisë”? - Kë vendos rrëfimtari përballë Orës së Durmitorit? Çfarë i bashkon ato njëra me tjetrën? - Çfarë efekti ka kapja dhe lidhja e Orës së Durmitorit nga Zana e madhe tek ushtria malazeze? - Kujt ja kushton Zana e madhe mundjen e ushtrisë së Malit të Zi dhe vdekjen e shumë ushtarëve malazezë në luftime? Analizim - Analizoni titullin e këngës “Gjaku i marrun” dhe forcën e madhe që nxit hakmarrja në veprimet e orëve dhe zanave. Organizuesi grafik Si qëndron raporti i rolit që luajnë njerëzit dhe figurat mitologjike në këtë këngë? Njerëzit <u>Raporti</u> Figurat mitologjike Analizë përmes shembujve - Zana dhe orët malazeze nxisin njerëzit për luftë. Zanat dhe orët shqiptare marrin hak për Tringën. Çfarë tregojnë këto veprime për marrëdhëniet që kanë këto qenie mitologjike me njerëzit? - Luftëtarët e Mark Milanit paraqiten si burra shumë të fortë. Cili është funksioni i theksimit të forcës së tyre fizike në poemë?	

Punë e pavarur individuale

Gjeni në tekst epitete që përshkruajnë Orën e Durmitorit. Si paraqitet pamja dhe forca e saj fizike?

Reflektim dhe vlerësim dijesh

- Çfarë tregojnë këto vargje për marrëdhënien e shqiptarëve me sllavët: si gjithmonë Shqiptarë e Shkja/janë la n'gjak, q'se fati i zi/flakë e agzot vuni përbri/vu përbri Shqypni e Mal t'Zi!

- Interpretoni fjalët e Mark Milanit për mënyrën sesi ju fal toka shqiptare malazezve: n'Shkamb të Pejës e ku rreh deti/ ata në me gisht e letër/na e kanë falë Krahajat e Mbreti.

Punë me grupe

Grupi 1

Në veprën “Lahuta e Malcisë” ndeshim shpesh me vargje mungesën e një fjale ose më shumë fjalëve. Gjeni këtë figurë të sintaksës poetike në këto vargje dhe shpjegoni funksionin e saj. Ora e Zana ashtu përllá,/Ç' t' janë dermishë shoqe me shoqe!/M' dhâmë e m' thoj se ç' janë lvyrë ! Ç' po u shkon gjaku rrëkajë ndër ftyrë!

Grupi 2

Në këtë këngë është shumë e pranishme figura e Asindentit, e cila konsiston në mungesën e lidhëzës mes dy gjymtyrëve. Gjeni shembuj dhe diskutoni për mënyrën e ndërtimit të tyre.

Grupi 3

Çfarë efekti përdorimi ka figura e krijuar në këto dy vargje: Ká marrë kangen e po këndon;/Po këndon m'kep t' Vizitorit,/Larg me u ndi m' Boka t'Kotorrit:. Me ç'figurë të shqiptimit poetik kemi të bëjmë?

Diskutoni për aktualitetin e poemës “Lahuta e Malcisë” dhe problematikat që diskutohen në të.

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësim i punës së pavarur. Vlerësim mes nxënësve

Detyrat dhe puna e pavarur: Krahasoni orët dhe zanat në këngën e Lahutës me perënditë greke në “Iliadën” e Homerit.

orët dhe zanat në këngën e Lahutës	perënditë greke në “Iliadën” e Homerit

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 20

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Punë me projekt. Faza e parë. Ora 2.</i> Nxënësit paraqesin planin e punës individual		Situata e të nxënit: Nxënësit paraqesin planin e punës individual dhe diskutojnë për hartimin e planit të grupit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit			

• Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare • Digjitale	
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - komunikon në grup duke dhënë ide vetjake; - dëshmon aftësi bashkëpunuese në punën grup dhe merr role dhe përgjegjësi; - demonstroi aftësi hulumtuese/kërkuese, zbuluese të materialit interesant; - evidenton drejt problematikat dhe i trajton ato me objektivitet; - ofron rrugëzgjdhje; - dëshmon se di të menaxhojë burimet njerëzore dhe materiale etj.; - bashkëpunon me një grup të caktuar duke sjellë produkte të plota; - prezanton plan projektin e punës individuale.	Fjalët kyçe: ▪ Projekt ▪ Sipërmarrje ▪ Individuale ▪ Në grup ▪ Role ▪ Përgjegjësi ▪ prezantim
Burimet: ▪ Portofoli i nxënësit ▪ Interneti ▪ Tekste të ndryshme ▪ Biblioteka ▪ Mjetet: CD, mjete shkollore ▪ Materiale të ndryshme të nevojshme për punën me projekt	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Arte ▪ Histori ▪ Gjeografi ▪ TIK ▪ Gjuhë shqipe ▪ Shkenca shoqërore ▪ Matematikë
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve prezantim, pyetje-përgjigje - bashkëbisedim. Metoda dhe teknika të nevojshme përgjatë realizimit të produktit: vërtetimi, punë e individuale, punë në grup, organizuesit grafik, diskutim, analiza, hulumtimi/kërkimi, pyetësorë, zbatim, intervista, Role të specializuara në diskutime, kërkime në internet dhe burime të tjera informative, shkrimi i lirë.	
Organizimi i orës së mësimi Nxënësit paraprakisht janë ndarë në grupe. Nxënësit paraqesin: planin vetjak dhe i përgjigjen pyetjeve drejtuar nga nxënësit dhe mësuesi/ja. Kryetarët e grupeve paraqesin planin e grupit dhe shpjegojnë rreth angazhimit të anëtareve të grupit. Portofoli/dosja i/e punës do të përmbajë: Planin e projektit Personat që do të jenë pjesë e punës Planet e punës së nxënësve dhe grupeve Shënimet e mbajtura gjatë punës Literaturën apo burimet e informacionit	

Vlerësimi: Vlerësimi i punëve të nxënësve do të bëhet duke pasur parasysh disa pika: planin e projektit kurrikular për çdo nxënës dhe grup menaxhimin e informacionit etikën e punës në grup punët krijuese të çdo grupi mënyrën e prezantimit Vlerësim i nxënësve 40% puna në grup -60% puna individuale
Detyrat dhe puna e pavarur: Detyrat për fazën tjetër

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 21

Dt. __/__/__

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: Lasgush Poradeci Momentet më të rëndësishme të jetës së Poradecit. Veprat e Poradecit. Vendlindja dhe dashuria në jetën e Poradecit.		Situata e të nxënit: Poeti modern i shqipes. Bisedë me temë: Vlerat e artit varen nga sasia apo cilësia? Kërkesat e larta të Lasgushit ndaj artit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - E komunikimit dhe të shprehurit - E të nxënit - Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Personale - Digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - analizon risitë dhe origjinalitetin që solli Poradeci në poezinë shqipe; - përshkruan momentet kryesore të jetës së Poradecit që ndikuan në krijimtarinë e tij; - rendit veprat kryesore të Poradecit; - analizon motivet kryesore të poezisë; - veçon dhe gjykon ndikimet që pati Poradeci nga krijimtaria e Naim Frashërit dhe nga poezia moderne e Evropës.		Fjalët kyçe: - Origjinalitet - Simbolizëm - Figuracion i pasur - Risi - Ndjeshmëri - Imazhe - Dashuri - Filozofi - Peizazh	
Burimet: - Teksti mësimor - Analiza dhe studime - Veprat e Poradecit - Interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Gjuhë shqipe - Arte - Filozofi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			

Rifreskim njohurish - Organizuesi grafik/Hartë koncepti - Përgjigje e strukturuar - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh

Organizimi i orës së mësimit

Rifreskim njohurish - Organizuesi grafik - Në ç'kohë e nis krijimtarinë e tij Lasgush Poradeci? Përshkruaj shkurtimisht karakteristikat e letërsisë shqiptare të gjysmës së parë të shekullit XX.

letërsia shqiptare të gjysmës së parë të shekullit XX

përfaqësuesit

Rrymat/shkollat letrare

Veçoritë

Pyetje-përgjigje

- Cilat janë momentet kryesore të jetës së Lasgushit që ndikuan në formimin e tij letrar? Ndërto një hartë konceptesh me anë të së cilës të përvijohet veprimtaria e Lasgushit në disa aspekte.

- Në veprimtarinë e Lasgushit me letrat një vend të veçantë zë përkthimi. Listoni disa nga kryeveprat botërore të përkthyer nga ai.

Përgjigje e strukturuar - Pyetje-përgjigje - Punë e pavarur individuale

- Listo me tituj veprat letrare të Poradecit. Përcakto llojin e tyre (shkrime letrare apo joletrare). Thoni se cila është koha e shkrimit të tyre. Trego çfarë përmbajnë.

Krijimtaria e Lasgushit	Titujt e veprave	Koha e shkrimit dhe botimit	Çfarë përmbajnë
Veprat joletrare			
Veprat letrare			

Punë e pavarur individuale - Çfarë i sjell letërsisë shqipe botimi i dy përmbledhjeve poetike: “Vallja e yjeve” “Ylli i zemrës”? Si u vlerësua për këto prurje letrare?

p.sh. vetëdije estetike të re

u quajt themelues i _____

- Për nga veçoritë kryesore të autori ku do të klasifikohet krijimtaria e tij? Përse e klasifikuat si të tillë? A e ka pranuar vetë poeti këtë përcaktim/klasifikim?

Punë në grupe

- Lasgushin e kanë vlerësuar si themelues i poezisë moderne shqipe. Ç'risi solli Lasgushi në letërsinë shqipe duke iu referuar formës, tematikës, mjeteve gjuhësore dhe stilistike?

risitë në:

Grupi 1 - formë

a) strofa _____

b) rima _____

- c) ritmi _____
d) metri _____

Grupi 2 - tematikë _____

Grupi 3 - mjete gjuhësore

- e) leksiku _____
f) neologjizmat _____
g) bipolariteti _____

Grupi 4 - mjete gjuhësore

- h) trajtat zvogëluese _____
i) shtimi apo heqja e fonemave _____
j) lidhjet sintaktike _____

Grupi 5 - mjete stilistike _____

Grupi 6 - në lidhje me shkallën e ndjeshmërisë dhe paraqitjen e saj _____

- Cilat janë temat dhe motivet kryesore të trajtuara në poezitë përbërëse të dy përmbledhjeve poetike?

- Përbërësja tjetër e poetikës lasgushiane, poezia popullore. Duke u mbështetur në poezitë e tij dëshmoni praninë e elementeve të poezisë popullore.

Analizim

- Zbërtheni kuptimin e Lasgushit për dashurinë si një ndjenjë universale. Cili është një nga motivet i gjithpranishëm në lirikën e dashurisë së Lasgushit?

- Analizoni raportin e Lasgushit me vendlindjen.

Diskutim

- Çfarë mesazhesh transmetojnë dy poemat: “Kamadeva”, “Ekskursioni teologjik i Sokratit” të botuara për herë të parë, për lexuesin shqiptar, në vitin 1990?

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësim i punës së pavarur. Vlerësim i punës në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur:

- Ç`vend zë dashuria në poezinë e Lasgushit? Cili është kuptimi i Lasgushit për dashurinë? Me kë poet ngjason Lasgushi në portretizimin e femrës? Duke iu referuar poezive të dy autorëve argumentoni përgjigjen tuaj.
- Evidentoni pika takimi mes poezisë së Lasgushit dhe Naimit. Në ç`aspekte dëshmohet mbështetja në trashëgiminë poetike të Naimit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 22

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Analizë “Ylli i zemrës”</i>		Situata e të nxënit: Poezia lirike si formë e shprehjes së unit të brendshëm Poezia lirike si formë e shprehjes së unit të brendshëm	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare • Digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përdor organizuesit grafikë në funksion të të kuptuarit të koncepteve e ideve të tekstit; - shpjegon se cilat janë karakteristikat kryesore; - gjykon mbi risitë që sjell vepra e Lasgushit; - vlerëson vëllimin poetik “Ylli i zemrës”; - bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme.		Fjalët kyçe: ▪ Modern ▪ Simbolizëm ▪ Emocion ▪ Imazh ▪ Figuracion i pasur ▪ Neologjizma	
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Analiza dhe studime ▪ Vëllimi poetik “Ylli i zemrës”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Arte ▪ Gjuhë shqipe ▪ Filozofi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Informacion i strukturuar - Diagrami i Venit - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh			
Organizimi i orës së mësimi Informacion i strukturuar - Kur u shkrua dhe u botua vëllimi poetik “Ylli i zemrës”? Pse mund të thuhet se botimi i tij ishte një sukses edhe më i madh se i pari? vëllimi poetik "Ylli i zemrës"? Koha e botimit Konteksti kulturor Pyetje-përgjigje - A patën sukses dy përmbledhjet poetike “Vallja e yjeve” “Ylli i zemrës”. Mund të themi që librat u pritën mirë nga lexuesi i kohës? ○ Po ○ Jo Shpjegimi Diagrami i Venit Cilat janë tiparet e përbashkëta mes librit të parë “Vallja e yjeve” dhe “Ylli i zemrës”? Po dallimet mes tyre? Paraqiti ato nëpërmjet Diagramit të Venit.			

Vallja e

Ylli i zemrës

Analizim

- Pse nuk mund të klasifikohen poezitë për liqenin thjesht si poezi peizazhi? Nënvizoj detaje që portretizojnë subjektin lirik në planin emocional.

Punë me grupe

Grupi 1

Shpjegoni si e kuptoni përshkrimin e dashurisë në poezinë lasgushiane si një ndjenjë bipolare. Lexoni vargjet e mëposhtme dhe identifikoni fjalët që ndërtojnë bipolaritetin.

Me zjarr ju flas..., me zjarr.

Në gjirin t'ëm kam hapur varr...

Që t'i jap shpresë-edhe t'j-a marr... Vdekja e nositit

Dashuri! Heu! Mall i ri!

Dashuri! këng' e durimit!

Që më bën kur mënt' e mija rëgëtitjnë varg e varg

Të të ndjej aq fare pranë, të më jesh aq shumë larg. Kur në flakë

Grupi 2

Ç'domethënie ka fakti që poezia e dashurisë së Lasgushit evokon figurat e “vashës” dhe “trimit”? Evidento në vargjet e shkëputura nga poezi të tij, detaje që konkretizojnë mjedisin idilik, në të cilin lind dashuria. Shpjego kuptimin e përdorimit të emrave vasha, trim duke i lidhur me kontekstin.

Vate prill' i trimërisë,

Më zu maj i dashurisë.

M'u shti vashëza në gjumë,

E-ëmbra-mi-shoqe-shumë. “Vate prilli”

Kush po shkon ashtu me bujë?

Kush po vjen ashtu për ujë?

Po shkon trimi si dragua,

Po vjen vasha për në krua.

“Kush po shkon ashtu”

Thotë vasha me mëri:

Trimin do ta mbaj në gji!

Thonë shoqet me zili:

Ay trimi ti moj ti,

Po të djeg, po të bën hi,

Po të fut në dhe të zi. “Po qan vasha në shtëpi”

E përmi detin që pushon

Del Vashëza dhe Trimi...–

Dh'ashtu filluam më të von

Një këngë dëshërimi. Vdekja jonë

Grupi 3

Cilat janë disa nga karakteristikat e lirikës filozofike të Lasgushit, te vëllimi poetik “Ylli i zemrës”? Evidento në vargjet e mëposhtme, të poezisë “Përjetësia”, karakteristika të poezisë filozofike.

Jam sot,
Si vjet,
Si mot,
Si përgjithënjë

“Kur jam në trupin t’ënd,
Jam domosdo
Kur jam në zemër t’ënde,
Jam vetiu
Kur jam në shpirtin t’ënd
Jam domosdo” “Përjetësia”

Prezantim dhe diskutim i detyrës

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësim i punës në grup

Detyrat dhe puna e pavarur: Ndërtoni profilin e Lasgushit poet, duke iu referuar asaj ç’ka përcjell poezia e tij.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 23

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: Studim teksti “Vdekja e Nositit”		Situata e të nxënit: Bisedë me temë: Kontributi/Misioni i artistit, qytetarit të vetëdijshëm për rolin e tij në shoqëri dhe i prindit.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: - E komunikimit dhe të shprehurit - E të menduarit - Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin - Personale - Qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - zbulon mesazhet që përcillen me anë të poezive; - identifikon në tekst veçoritë të poezisë filozofike të autorit; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike; - analizon funksionin e simbolit të përdorur në poezi dhe interpreton kuptimet që merr; - ndërton me anë të një grafiku përshkallëzimin emocional.		Fjalët kyçe: - Sakrificë - Vetësakrifikim - Ideal - Jetë - Vdekje - Përjetësi - Përsosmëri - Dashuri - Cikël	
Burimet: - Teksti mësimor - Poezia		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Arte - Gjuhë shqipe - Filozofi	

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Hartë koncepti - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh

Organizimi i orës së mësimi

Nositi – është një zog/shpend i cili jeton në liqen. Pogradecarët emërtojnë kështu pelikanin.

Duke i pranëvënë fjalën **vdekja**, (në titullin e poezisë) **Nositi** personifikohet dhe merr kuptime simbolike:

- poeti sakrifikon në funksion të artit dhe trashëgimisë kulturore;
- individi sakrifikon në funksion të një shoqërie më të zhvilluar emancipuar.

Lexim - Identifikim - Pyetje-përgjigje - Organizuesi grafik i informacionit

- Cilës vetë i drejtohet poeti që në vargun e parë? Përse e bën ai këtë? Identifiko mjetin gjuhësor me të cilin subjekti lirik identifikon vetveten, dhe mjetin gjuhësor me të cilin identifikon marrësin.

Subjektet	Mjeti gjuhësor me të cilin identifikohet
Ligjëruesi	
Lexuesi	
Mjedisi	

- Si e realizon autori lidhjen e poetit me vendlindjen, lexuesin?

- lidhja me vendlindjen _____
- lidhja /raporti me lexuesin _____

- Vargu i parë nis me fjalën **zjarr** dhe përmbillet po me të njëjtën fjalë. Në ç'shikallë jepet gjendja emocionale. Përcakto kuptimin e fjalës, në secilin nga rastet:

- zjarr (në fillim të vargut) _____
- zjarr (në fund të vargut) _____

- Shpjego funksionin e përdorimit të reticencës në vargun e parë dhe në poezi.

Shembuj të përdorimit të reticencës	Funksioni i përdorimit

- Në ç'kohë dhe vetë është folja e vargun: *Në gjirin tim kam hapur varr...*

Koha _____

Veta _____

Si e kuptoni ju këtë varg _____

- Cili është mjeti stilistik i përdorur në vargun *Që t'i jap shpresë-edhe t'ja marr...*

Lidhja sintagmatike siguron lidhjen ndërvepruese ndërmjet veprimeve (marr-jap).

- mjeti stilistik i përdorur _____
- kujt po ia merr shpresën _____
- kujt po i jep shpresë _____

- Ç'pjesë ligjërata është fjala e nënvizuar në vargun *Un' ik liqerit **zemërak***

Si pjesë ligjërata _____

Shpjego ndryshimin kuptimor ndërmjet fjalës zemërak dhe i zemëruar

zemërak _____ i zemëruar _____

- Çfarë imazhi ju përvijojnë vargjet e mëposhtme? Përse Nositi ndihet fatlum dhe i pastër?

Fatlum dhe i pastër si zëmbak,

Po zemra ime kullon gjak

- Autori nuk përgjak së jashtmi tablonë, por orienton lexuesin të hetojë dhimbjen e brendshme. Cili është qëllimi i një procedimi të tillë?

- Poezia nis e mbyllet me të njëjtin varg (*ka ndryshuar vendi i reticencës*). Çfarë efekti krijon kjo dhe si mund të motivohet?

- Komentoni dyvargëshin:

"Ahere-helmohet e zë buçet

Pas mallit tim liqeri-i shkret".

- Vëreni paralelizmin që sendërtohet nga imazhi i gjirit të hapur të Nositit-poet dhe gjirit të hapur të liqerit. Çfarë emocioneesh e idesh përcjell ky paralelizëm?

- Përse Nositit - poet i kësaj poezie vdes me gaz? Çfarë e bën vdekjen e tij të lumtur:

- fakti që vdes pranë liqenit të dashur;
- fakti që po vetësakrifikohet për zogjtë e vet;
- ideja se po shkon në parajsë;
- ideja se moskuptimet do të zgjidhen pas vdekjes.

Motivoni secilën nga përgjigjet tuaja.

Diskutimi

- Cila është atmosfera që mbizotëron në këtë poezi, pesimizmi apo optimizmi. Motivoni secilën nga përgjigjet tuaja.

Punë e pavarur individuale

- Ndërttoni një fjalorth të shkurtër me fjalë tipike lasgushiane.

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësim i punës së pavarur. Vlerësim i punës në grup

Detyrat dhe puna e pavarur:

- Rikujtoni poezinë e njohur të Naim Frashërit “Fjalët e qiririt”. A shihni ndonjë element të ngjashëm me poezinë që po analizoni? Arsyetoni përgjigjen tuaj.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 24

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Studim teksti</i> “Poradeci”		Situata e të nxënës: Identifikimi i shpirtit të poetit me vendlindjen dhe atdheun	
Rezultatet e të nxënës sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënës • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare • Digiitale			

Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - zbulon mesazhet që përcillen me anë të poezive; - identifikon në tekst veçoritë të poezisë së peizazhit të autorit; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike; - analizon funksionin e simbolit të përdorur në poezi dhe interpreton kuptimet që merr; - ndërton me anë të një grafiku përshkallëzimin emocional të ndjenjës.	Fjalët kyçe: ▪ Ideal ▪ Përjetësi ▪ Përsosmëri ▪ Dashuri						
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Poezia ▪ Harta e Shqipërisë ▪ Harta e Ballkanit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Arte ▪ Gjuhë shqipe ▪ Filozofi ▪ Histori ▪ Gjeografi						
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Lexim dhe shpjegim teksti - Analizim - Punë e pavarur individuale - Pyetje-përgjigje - Ditari dypjesësh - Diskutime							
Organizimi i orës së mësimi Lexim dhe shpjegim teksti - Cilat janë disa nga emërtimet gjeografike (toponimet) që hasni në këtë poezi? - Për ç'moment të ditës bëhet fjalë në këtë poezi? Si motivohet kjo? - Si e përshkruan poeti natën që po bie? - Përse poeti përdor epitetet “plak” dhe “i përrallshëm” për lumin Drin? - Si e përshkruan autori heshtjen që bie me rënien e natës? Analizë - Lasgushi e cilëson Liqerin (liqenin) si “pa kufi(r)”. Përse mendoni se e bën këtë? - “Liqeri”, “Mali” dhe “Fshati” jepen si emra të përveçëm. Përse? Shpjego kuptimin e fjalës i vagëlluar dhe vlerën kuptimore që merr fjala kufi me shtimin e fonemës r (kufiri) I vagëlluar _____ Kufiri _____ - Në këtë përshkrim poetik të natyrës së vendlindjes, ka një varg që e lidh peizazhin me botën e brendshme të poetit. Gjejeni dhe komentojeni atë varg. Vargu _____ Komenti _____ - Analizoni vargun "Tërë fisi, tërë jeta, ra... u dergj... e zuri gjumi...". Për nga figuracioni _____ Për nga kuptimi _____ Punë e pavarur individuale Në poezi është përdorur disa herë figura e <i>retiçencës</i> (ndërprerje e realizuar me anë të tre pikave të vazhduara). Cila është vlera e përdorimit të kësaj figure? A ndikon ajo në ritmin e poezisë dhe si?							
<table><tr><th>Shembuj të përdorimit të <i>retiçencës</i></th><th>funksioni</th><th>Efektet ritmike</th></tr><tr><td> </td><td> </td><td> </td></tr></table>	Shembuj të përdorimit të <i>retiçencës</i>	funksioni	Efektet ritmike				
Shembuj të përdorimit të <i>retiçencës</i>	funksioni	Efektet ritmike					

- Përcaktoni llojin e strofave dhe vargut me të cilin është ndërtuar kjo poezi. Përse pikërisht ai lloj vargu? lloji i strofave _____ lloji i vargut _____ Reflektim - Diskutim - “Poezia “Poradeci” është një poezi kushtuar natyrës së vendlindjes së poetit, Pogradecit”. A mendoni se është plotësisht i saktë ky pohim? Çfarë do t’i shtonit apo do t’i ndryshonit këtij pohimi? Motivoni mendimin tuaj. - Duket sikur poezia ka një “lajthitje” gjeografike në vargun e fundit. Përse është fjala? A kemi të bëjmë vërtet me një gabim gjeografik apo poeti përcjell përmes atij imazhi ndonjë ide të rëndësishme? Cili është motivi që i sendërtohet kësaj poezie? Punë e pavarur individuale - Përcaktoni llojin e rimës së përdorur nga L. Poradeci në këtë poezi. - Nënvizoni fjalët e rralla në këtë poezi dhe pasi të gjeni kuptimin e tyre, jepni sa më shumë sinonime për secilën prej tyre. - Gjeni në tekstin e poezisë fjalë e figura që japin përfytyrimin e mbrëmjes dhe të rënies së natës. Gjeni në tekst fjalë e figura që na përcjellin atmosferën e qetësisë e të paqes. Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësim i punës së pavarur. Vlerësim i punës në grup Detyrat dhe puna e pavarur: - Në një hartë të Shqipërisë gjeni dhe shënoni të gjitha vendet e përmendura. Arsyetoni pastaj nëse kjo hartë fizike përputhet me hartën “shpirtërore” të Shqipërisë që përshkohet “mes për mes” prej lumit Drin. - Në një ekskursion të mundshëm në Pogradec, mundohuni që përmes fotografimit “të kapni” atë atmosferë që poetikisht e përcjell poezia “Poradeci”.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 25

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Studim teksti</i> “Ti po vjen që për së largu”		Situata e të nxënit: Diskutim me temë: Dashuria është jetë. Malli është pjesë e pandarë i dashurisë.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare • Digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; - zbulon mesazhet që përcillen me anë të poezive; - identifikon në tekst veçoritë të poezisë së dashurisë së autorit; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve gjuhësore e stilistike; - analizon funksionin e simbolit të përdorur në poezi dhe interpreton kuptimet që merr;		Fjalët kyçe:	

- ndërton me anë të një grafiku përshkallëzimin emocional të ndjenjës; - zbërthen kuptimin filozofik të Lasgushit mbi dashurinë.					
Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Poezia	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Arte ▪ Gjuhë shqipe ▪ Filozofi				
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh					
Organizimi i orës së mësimi <i>Poezia “Ti po vjen që prej së largu” bën pjesë në ciklin poetik Zemra e jetës të përmbledhjes poetike “Ylli i zemrës” të Lasgushit.</i> Pyetje-përgjigje - Ç’lloj poezie është “Ti po vjen që prej së largu” për nga tematika që trajton. Listo dy motive që evidentove. Lloji i poezisë: ▪ Erotike. Motive: ▪ I distancës/largësisë; ▪ I mallit. - Kujt i kushtohet kjo poezi? Cilat janë të dhënat që na ndihmojnë të përcaktojmë llojin e poezisë? <table border="1" data-bbox="159 1064 1481 1131"> <thead> <tr> <th data-bbox="159 1064 817 1097">Poezia i kushtohet</th><th data-bbox="817 1064 1481 1097">Lloji i poezisë</th></tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="159 1097 817 1131"></td><td data-bbox="817 1097 1481 1131"></td></tr> </tbody> </table>		Poezia i kushtohet	Lloji i poezisë		
Poezia i kushtohet	Lloji i poezisë				
Punë e pavarur individuale - Evidento subjektet lirike të kësaj poezie. Me ç’mjete gjuhësore shprehen ata? - subjektet lirike _____ - mjetet gjuhësore me të cilat shprehen: - Përcaktoni llojin e vargut me të cilin është ndërtuar kjo poezi. Përse autori zgjedh këtë lloj vargu (për nga gjatësia/aspekti metrik) për t’i shprehur vashës ndjenjat e tij? Lexim - Pyetje-përgjigje - Nga po vjen ajo? Si përjetohet ardhja e saj nga subjekti lirik? Me cilat detaje poeti karakterizon ardhjen e saj? ajo vjen _____ detajet _____ Punë me grupe Grupi 1 Gjeni emrat e disa bimëve e luleve në këtë poezi? Cila është vlera e përdorimit të tyre? - _____ Grupi 2 Cila është ndjenja mbizotëruese me të cilën shfaqet dashuria për vashën? - _____ Grupi 3 Si shprehet në tekstin e kësaj poezie, ndjesia e dorëzimit dhe e përkushtimit ndaj të dashurës? - _____ Analizë përmes shembujve - Ideja e largësisë fizike të së dashurës sjell përmallimin dhe përvuajtje. Si shprehen këto ndjenja në këtë poezi? Analizo vargjet e mëposhtme duke u ndalur më së shumti te fjalët e nënvizuara: - Nënë thembërzat e tua përgëzohet trëndelina, Shtrihet luleja mitare e zëmbakut që t’u fal.					

- Dhe të qaj me mall të rëndë poshtë teje pa pushim, Poshtë fillit të poleskës ku do shkeli këmba jote.
- Të m'a shkelësh hije-letë! të m'a shkelësh mes-për-mes ! ...
- Brenda lotëve të mija të të shoh të pasqyruar, E pastaj le të venitem, le të hesht, e le të vdes.
- Evidentoni në vargun “E pastaj le të venitem, le të hesht, e le të vdes”.
- figurat letrare _____
- tonin _____
- Shpjego kuptimin e vargut “Brenda lotëve të mija të të shoh të pasqyruar,”

Punë e pavarur individuale

Duke e analizuar me kujdes tekstin e kësaj poezie, hartoni një listë me cilësimet e ndjenjës që ushqen poeti për të dashurën.

- Në tekstin e kësaj poezie nuk përmendet fjala “dashuri”, por disa sinonime të saj. Gjejini ato dhe shpjegoni kuptimin e tyre kontekstual.

- Fjala “llaftari” është një nga fjalët kyç të fjalorit të poezisë lasgushiane. Çfarë vlere e domethënie ka në këtë poezi?
- llaftari _____
- domethënia _____
- vlere që merr _____
- Disa fjalë të kësaj poezie janë shkruar me vizë ndarëse në mes. Veçojini ato dhe thoni përse janë shkruar në këtë mënyrë nga autori. A është kjo një veçori gjuhësore e Lasgushit?

Diskutim

A mund të ndërtoni një portret apo figurë të vashës që dashuron poeti? Arsyetoni përgjigjen.

Vlerësimi: Vlerësimi i përgjigjeve me gojë. Vlerësim i punës në grup. Vlerësim i nxënësve

Detyrat dhe puna e pavarur:

Krahasoni këtë poezi të Lasgushit me ndonjë tjetër poezi të tij të dashurisë. Nxirrni disa përfundime lidhur me ngjashmëritë e dallimet mes tyre.

Poezitë e dashurisë të këtij lloji janë përcaktuar si “naimiane”, për shkak të ngjashmërisë me poezinë e dashurisë të Naim Frashërit.

- Krahaso poezinë e Lasgushit “Ti po vjen që prej së largu” me këngët 8, 9, 10 të poemthit “Bukuria” të Naim Frashërit dhe gjeni pikëtakime mes tyre, për nga:

- tematika që trajtojnë;
- vështrimi ndaj femrës;
- përjetimi i dashurisë;
- mjetet gjuhësore;
- mjetet stilistike;
- roli emancipues i shoqërisë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 26

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Test (tremujori i parë)</i>		Situata e të nxënësve:	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënësve • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare • Digjitale			

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - identifikon mjete gjuhësore dhe emërton stilistike të përdorura në tekst; - evidenton pikëtakime mes poezisë dhe krijimtarisë tradicionale; - shpjegon funksionin e përdorimit të mjeteve të përdorura në tekst; - zbërthen kuptimin filozofik të autorit për dashurinë; - shpjegon kuptimin e fjalëve të përdorura në tekst; - reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit.	Fjalët kyçe: - Identifiko - Shpjego - Argumento - Shkruaj - Interpreto - Motive - Lloj - Gjini - Metër - Kuptim - figuracion
Mjete: - Testi - Mjete shkrimi	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: - Arte - Filozofi - Gjuhë shqipe
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve: Punë e pavarur individuale	
Organizimi i orës së mësimi TEST Lasgush Poradeci “Syt' e Lumtur” Ishe vogëloshe...isha mituri... Kur më dole mbudhë, ti moj lumja ti! Vinte perëndimi me të vagëlluar Pa m'i shtire tinës ata syt' e shkruar. Ata syt' e shkruar, syte moj të fjetur, shtatë vjet me-radhe t'i kam përshëndetur. Kur më pe së pari, more-e m'u largove, Kur më pe së dyti, more-e m'u afrove, Kur më pe së treti, more-e më pushtove, Të putha në gushë, ti m'u turpërove, Papo ule kryet e shkove vajtove. Për pyetjet nga 1-6 rretho alternativën e saktë: 1. “Syt' e Lumtur” është lirikë : A) e peizazhit B) filozofike C) atdhetare D) erotike 2. Kuptimi i fjalës tinës (në vargun: Pa m'i shtire <u>tinës</u> ata syt' e shkruar.) është:	

1 pikë

1 pikë

- A) me hare
- B) me gaz
- C) hapur
- D) fshehurazi

3. Lloji i **rimës së** përdorur në tekst është :

1 pikë

- A) e puthur
- B) e kryqëzuar
- C) e alternuar
- D) vargjet nuk rimojnë

4. Cili është mjeti stilistik i përdorur në dy vargjet e dhëna:

1 pikë

*Pa m'i shtire tines **ata syt' e shkruar**.
ata syt' e shkruar, sytë moj të fjetur,*

- A) epanastrofeja
- B) similituda
- C) hiperbola
- D) krahasimi

5. Ç'pjesë ligjërate është fjala e nënvizuar **m'i shtire**:

1 pikë

- A) emër
- B) mbiemër
- C) folje
- D) ndajfolje

6. Veçori e gjuhës, në vargun **Vinte perëndimi me të vagëlluar**, është:

1 pikë

- A) ndryshimi i rendit të fjalëve
- B) mungesa e kryefjalës
- C) mungesa e foljes
- D) rendi tipik i fjalëve në gjuhën shqipe

7. Gjej në tekst një rast të përdorimit të anaforës dhe shpjego përse e ka përdorur autori:

2 pikë

anafora: _____

shpjegimi: _____

8. a) Zbërthe shkurtimisht kuptimin e Lasgushit për dashurinë duke iu referuar vargjeve të poezisë: **2 pikë**

b) Identifiko në tekst tri fjalët çelës me të cilat ndërtohet magjia e dashurisë.

3 pikë

9. Gjej në tekst një rast të përdorimit të reticencës dhe shpjego funksionin e përdorimit të saj.

2 pikë

Reticenca: _____
funksioni përdorimit: _____

10. Te këngët e dashurisë së Lasgushit ndjehen referencat (mbështetja) në poezitë e traditës. Argumento nëpërmjet detajeve këtë mbështetje (dy raste të tilla) **2 pikë**

11. Lasgushi di të huazojë nga folklori fjalë dhe shprehje të vjetra, t'u japë fuqi figurative dhe ndërtim strukturor të ri brenda kontekstit të dëshiruar. Zbulohet dy prej këtyre fjalëve. **2 pikë**

12. Me ç'mjete gjuhësore (subjekti lirik) identifikon vetveten dhe të dashurën? Jep nga një mjet gjuhësor për të dyja subjektet. **2 pikë**

Subjekti lirik: _____

E dashura: _____

Vlerësimi: Vlerësimi bëhet me notë dhe shënohet tek evidenca, duke e komentuar si notë testi.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 27

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa:12
Tema mësimore: <i>Bisedë letrare</i>		Situata e të nxënit: “Vallja e yjeve” Lasgush Poradeci	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare • Digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: - demonstroi njohje të kontekstit historik, kulturor, ekonomik, politik, shoqëror në të cilin është shkruar vëllimi; - analizon dhe interpreton elementet e përmbajtjes dhe të formës së tekstit, si: gjinia, tema dhe motivet. - reflekton, në mënyrë kritike, përmes analizave, interpretimit, vlerësimit dhe sintezës së tekstit		Fjalët kyçe: ▪ Risi ▪ Simbolizëm ▪ Traditë ▪ Lirikë ▪ Erotike ▪ Filozofike ▪ Peizazh	

Burimet: ▪ Teksti mësimor ▪ Vepra të plota ▪ Interneti ▪ Studime kritike ndaj veprës ▪ Analiza të veprës letrare	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Arte ▪ Gjeografi ▪ TIK ▪ Gjuhë shqip
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantim - Diskutim - Pyetje-përgjigje - Organizues grafik - Shkrim funksional - Të shkruarit tregues, përshkrues, shpjegues	
Organizimi i orës së mësimi Shënim: Nxënësit gjatë kësaj ore mësimore do të prezantojnë punën e tyre sipas detyrave paraprake individuale apo në grup, sipas modelit të mëposhtëm: Detyra individuale për çdo nxënës ▪ Kartela e tekstit; ▪ Autori; ▪ Rryma letrare; ▪ Shkurtimisht karakteristika të letërsisë modern simboliste dhe karakteristika të letërsisë tradicionale; ▪ Rrethanat e formimit të botëkuptimit të shkrimtarit; ▪ Temat; ▪ Linjat; ▪ Motivet. - Një ese me temë “Krijimtaria e Lasgushit dhe vendi i saj në letërsinë botërore”. Detyrat e dhëna sipas punëve në grupe G-1. Përshkruaj sfondin në të cilin zhvillohen krijimtaria e autorit ▪ sfondi ▪ historik ▪ kulturor ▪ politik ▪ social ▪ filozofik G-2. Analizo veçori të gjuhës së veprës. Gjuha - Veçori <i>Aspekte themelore të gjuhës në nivelin:</i> ▪ Leksikor ▪ Morfologjik	

- Sintaksor

G-3. Pasi të keni identifikuar mjetet stilistike shpjego kuptimin dhe funksionin e përdorimit të tyre.

Figurat letrare -Interpretimi i tyre

G-5.Vlerësime për krijimtarinë e autorit . - Kanë thënë për autorin. Lasgushi ka thënë.

G-6. Rrafshe krahasuese (me autorë shqiptarë dhe të huaj)

Vlerësimi: Vlerësimi për të nxënë (i vazhdueshëm)

Vlerësimi i nxënësit do të bëhet për punën individuale dhe në grup. Për punën individuale do të ketë një peshë prej 60% dhe për punën në grup rreth 40%.

Detyrat dhe puna e pavarur: Përshkruaj rrethanat/kontekstin e kohës kur jetoi e shkroi autori.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE 28

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: 12
Tema mësimore: <i>Përsëritje për maturën shtetërore</i>		Situata e të nxënit: <i>Letërsia botërore gjatë gjysmës së parë të shekullit XX</i>	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: • E komunikimit dhe të shprehurit • E të menduarit • E të nxënit • Për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin • Personale • Qytetare • Digjitale			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: ▪ demonstroi njohje të kontekstit historik, kulturor, politik, shoqëror në të cilin është zhvilluar letërsia gjatë gjysmës së parë të shek. XX; ▪ njeh dhe identifikon tipare të estetikës, në tekste të ndryshme të shkrimtarëve të gjysmës së parë të shek. XX; ▪ mbron idetë e tij duke i ilustruar me detaje dhe me shembuj nga teksti; ▪ bën pyetje dhe përgjigjet në mënyrë të përgjegjshme; ▪ krahason vepra të ndryshme të gjysmës së parë të shekullit XX për të evidentuar pikëtakime dhe dallime mes tyre; ▪ shpjegon zhvillimin e letërsisë së shekullit XX në vende të ndryshme ▪ interpreton, analizon, gjykon, vlerëson veprat e studiuara përgjatë periudhës.		Fjalët kyçe: ▪ Risi ▪ Larmi ▪ Lloje ▪ Gjini ▪ Tematikë ▪ Motive ▪ Revoltë ▪ Raport	
Burimet: ▪ Teksti mësimor		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:	

- Vepra të plota - Interneti - Studime kritike ndaj veprës - Analiza të veprës letrare	- Arte - Gjuhë shqipe - Qytetari - Psikologji - Histori - Gjeografi															
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Hartë koncepti - Analizim - Pyetje-përgjigje - Punë me grupe - Ditari dypjesësh																
Organizimi i orës së mësimit Informacion i strukturuar - Organizim grafik -Cilat janë rrethanat, historike-shoqërore në të cilat u zhvillua letërsia e gjysmës së parë të shekullit XX? Kushtet në të cilat u zhvillua letërsia botërore e gjysmës së parë të shekullit Konteksti Kushtet në të cilat u zhvillua letërsia shqiptare e gjysmës së parë të shekullit																
Punë e pavarur individuale - Veço karakteristikat kryesore për letërsinë e shekullit XX.																
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th style="width: 35%;"></th> <th style="width: 35%;">Letërsia botërore gjatë gjysmës së parë të shekullit XX</th> <th style="width: 30%;">Letërsia shqipe gjatë gjysmës së parë të shekullit XX</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Autorë</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Vepra</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Rrymat letrare</td> <td></td> <td></td> </tr> <tr> <td>Veçoritë karakteristike</td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>			Letërsia botërore gjatë gjysmës së parë të shekullit XX	Letërsia shqipe gjatë gjysmës së parë të shekullit XX	Autorë			Vepra			Rrymat letrare			Veçoritë karakteristike		
	Letërsia botërore gjatë gjysmës së parë të shekullit XX	Letërsia shqipe gjatë gjysmës së parë të shekullit XX														
Autorë																
Vepra																
Rrymat letrare																
Veçoritë karakteristike																
Punë me grupe Lexo tekstin e mëposhtëm dhe analizoje atë për nga veçoritë karakteristike të krijimtarisë së autorit. - Lloji i veprës - Drejtimi letrar/Shkolla a rryma letrare - Tema/motive - Veçori të gjuhës e stilit - Mesazhe - Risitë - Rëndësia e veprës																
Grupi 1 - fragment nga “I huaji” Sapo ai iku, rigjeta përsëri qetësinë time. Isha i dërmuar dhe u hodha mbi dyshekun tim. Mendoj se më kishte zënë gjumi pasi u zgjova dhe pashë yjet sipër kokës. Zhurmat e fshatit vinin deri tek unë. Aromat e natës, të tokës dhe të kripës freskonin tëmthat e mi. Paqja e mrekullueshme e kësaj vere të përgjumur futej tek unë si një vërshim i papërmbajtshëm. Në këtë moment që përkonte dhe me fillimin e agimit të ditës së re, ulërinë sirenat. Ato më njoftonin nisjen për në një botë tjetër, për të cilën nuk isha më indiferent. Për herë të parë, që prej shumë kohësh mendova për mamanë. E kuptova se përse në fund të një jete ajo kishte gjetur “një të fejuar”, se përse ajo kishte filluar të luante për të rifilluar edhe njëherë nga e para. Edhe atje, atje, përreth kësaj azileje ku shuheshin jetë, mbrëmja ngjante me një pushim melankolik. Kaq pranë vdekjes, mamaja duhet të jetë ndjerë e lirë dhe e gatshme për të rjetuar edhe njëherë gjithçka. Asnjë, por asnjë nuk kishte të drejtë të qante mbi të. Dhe unë gjithashtu u ndjeva gati për të jetuar përsëri. Sikur gjithë ky zemërim më kishte pastruar nga e keqja, më kishte boshatisur nga shpresa, përpara kësaj nate të mbushur me shenja dhe yje po i hapësja për herë të parë indiferencës së butë të kësaj bote.																

Grupi 2 - fragment nga “Metamorfoza” Kafka

Nuk i kishin mbetur as pesë minuta deri në shtatë e një çerek, kur dëgjoi zilen e derës së jashtme. “Ndonjë nga ata të firmës do të jetë”, - tha me vete. Shtangu ndërkohe që putërzat zunë të vallëzonin më shpejt. Për një çast zotëroi heshtja. “Nuk po ia hapin”, - mendoi Gregori, duke e ngrohur veten me një shpresë të kotë. Por, pas pak, kuptohet, shërbyesja shkoi si zakonisht me hap të vendosur të hapte derën. E njohu nga zëri, ishte prokuratori. E pse, vallë, që i dënuar të punonte në një firmë, ku mungesa më e vogël ngjallte menjëherë dyshimin më të madh? Nuk paska mes tyre të devotshëm e besnikë? A nuk që e mjaftueshme të dërgohej një çirak për të pyetur, në qenka kjo aq e domosdoshme, - po duhej të vinte prokuratori vetë, si për t’i treguar familjes së shkretë se hetimi i kësaj çështjeje kaq të dyshimtë mund t’i besohej vetëm mendjes së tij?

Grupi 3 - fragment nga - Oso Kuka, nga “Lahuta e Malcisë”

Njisi gjaku qi Oso Kuka
Sot ka derdhun ke ato suka
Si për mbret, si për dhe të parëve
Vlon sa vlon ndër dej të shqyptarëve.

Grupi 4 - fragment nga: “Erë trëndeline” Lasgushi

Sesi m’ju lëndon dashurija!
Sesi m’ju lëndon pa pushim!
O lotët e syve të mija!
O klithmëz e tingëllit t’im!

Ju shoqe të kohës mitare...
Mikesha... motriçka... pa faj!
Ju humbtë në mjegull për fare,
Dh’ u solla ndër mënd e po qaj!

As flak’ e shkëndijës q’ u shua,
As syri që nxihet e plas,
Nuk lanë-o ju vasha për mua
Vuratat e errëta pas:

Haj! flutur’ e zënë me duar
Një flutur sicila prej jush,
Më la në gishtrinj dyke shkuar
Pluhurin që ndrin posi prush...

Prezantim i detyrave në grup dhe diskutimi rreth tyre.

Vlerësimi: Vlerësim i përgjigjeve me gojë. Vlerësim i punës individuale dhe në grup


Detyrat dhe puna e pavarur: Detyra për periudhën e dytë semestrale.

Format e vlerësimit të njësisë mësimore

	Gjatë zhvillimit	Në përfundim
Fokusi i vlerësimit	Aftësimi për secilin prej kritereve të detyrës vlerësuese.	Vlerësimi me pikë sipas kritereve të rubrikës.
Kriteret e vlerësimit	Mësuesi/ja i përcakton (i specifikon më tej nëse u referohet rubrikave të sugjeruara), i diskuton dhe i miraton bashkë me nxënësin.	Përzgjedh dhe kombinon kriteret më përfaqësuese të formimit dhe ndërton rubrikën për vlerësimin e detyrës së dhënë.
Detyrat për vlerësim	Të larmishme dhe të përshkallëzuar në tri nivele vështirësie.	Koncepton detyrën vlerësuese që e mundëson nxënësin të demonstrojë arritjen e tij ndaj objektivave të njësisë.
Notat sipas pikëve për secilin nga kriteret e rubrikës përkatëse	Aftësim i nxënësit për të gjykuar objektivisht, bazuar në kritere, për detyrat e veta dhe të shokëve, të zhvilluara gjatë njësisë.	Nota e bazuar në pikët e marra për secilin nga kriteret e detyrës orienton qartë nxënësin për arritjet dhe mundësitë.

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Migjeni, fryma e re që solli në letërsinë shqipe, momentet kryesore të jetës dhe veprës së tij.		Situata e të nxënësve: Bisedë, diskutim rreth kontributit letrar të shkrimtarit: Vepra që i priu jetës së autorit.	
Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - përcakton rolin e Migjenit në letërsinë shqiptare; - klasifikon sipas gjinisë krijimtarinë e Migjenit; - analizon burimet kryesore që përcaktuan formimin e tij; - analizon motivet dhe kultet që theu Migjeni në letërsinë shqipe; - vlerëson rolin e shkrimtarit si novator në fushën letrare dhe në mendësinë e realitetit të asaj kohe.		Fjalët kyçe: ▪ Vitet 30 ▪ Realist ▪ Modernist ▪ Tema ekzistenciale ▪ Liri mendimi ▪ Nivel i lartë artistik ▪ Metrikë e re	
Burimet: ▪ Libri i nxënësit ▪ Burime nga interneti ▪ Kritika letrare ▪ Vepra		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Gjuhë shqipe ▪ Histori ▪ Tik ▪ Filozofi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Stuhi mendimesh - Praktike e drejtuar - Tabela e pyetjeve			
Organizimi i orës së mësimi Parashikimi: Stuhi mendimesh Nxënësit diskutojnë mbi letërsinë e viteve 30’ në Shqipëri, mbi kontekstin historik dhe letrar të kohës, pasi mësuesi/ja u ka dhënë si detyrë një orë më parë.			
KONTEKSTI HISTORIK		KONTEKSTI LETRAR	
• Shqipëria ishte nën regjimin e mbretit Zog. • Mentaliteti i prapambetur, aty-këtu gjurmë të lehta të qytetërimit ndikuar nga italianët. • Vendi i zhytur në varfëri të thellë ku vazhdonte lufta e ashpër mes feudalizmit dhe kapitalizmit.		• Qarku i veriut me shkrimtarët e njohur Gjergj Fishta dhe Ernest Koliqi • Qarku i jugut, ku shkrimtarët më të mëdhenj ishin Lasgush Poradeci, Fan Noli, Faik Konica. Gjinitë me të lëvuara ishin poezia, proza, poema. • Vazhdonte fryma himnizuese në letërsi, me prirje romantike e sentimentaliste.	

Shkrimtari i madh Ismail Kadare, për të sintetizuar Letërsinë e viteve 30', e formëson si dy kone me bazë të përbashkët, ku në kulmin sipër qëndronte Lasgush Poradeci, në bazë qëndronte Fan Noli dhe në kulmin poshtë qëndronte Migjeni.



L.Poradeci, poeti i qiellit të jetës shqiptare, ku i këndoi si askush tjetër Dashurisë dhe mallit si edhe aromës së vendlindjes.

Fan Noli pasqyroi purgatorin e tij shpirtëror, së bashku me purgatorin e jetës shqiptare, duke kërkuar ndjesë për dështimin e tij politik.

Migjeni pasqyroi ferrin e jetës shqiptare duke parë qartë ditë për ditë dhe duke vuajtur thellë e më thellë.

Ndërtimi i njohurive: Praktikë e drejtuar

Klasa ndahet në grupe duke përzgjedhur materialin në libër.

Grupi i parë: Vendi i Migjenit në letërsinë shqipe.

- ❖ Vendi i tij në letërsi është i veçantë, sepse ai nuk e idealizoi realitetin si shkrimtarët e mëparshëm që vazhdonin të qëndronin të lidhur me frymën romantike.
- ❖ Tek ai mbizotëron paraqitja realiste që te shkrimtarët e mëparshëm ishte anësore.
- ❖ Personazhet te vepra e tij nuk ishin heronj, por njerëz të thjeshtë, madje të rëndomtë.
- ❖ Në qendër të veprës së tij nuk është njeriu shqiptar, por njeriu si qenie ekzistenciale.
- ❖ Njeriu shfaqet i shqetësuar për fatin e tij, dilemat e vazhdueshme që e brejnë shpirtin e tij.
- ❖ Në qendër janë raportet e njeriut me shtetin, shoqërinë.
- ❖ Sintetizoi sëmundjen e tij personale me sëmundjen shoqërore, dhimbjen e tij me atë të gjithë atyre që vuajnë; përdori vargun e lirë të çliruar nga pengesat formale dhe nga mendësitë tradicionale.

Grupi i dytë: Momentet kryesore të jetës dhe veprës:

- ❖ Fëmijëria: Lindi më 23.10.1911 në Shkodër. Fëmijëria e tij ishte e trishtuar, e mbushur me vdekjen e njerëzve më të dashur nënës, babait vëllait.
- ❖ Arsimimi: Shkollën fillore e zhvilloi në Shkodër, më pas i vazhdoi në Tivar dhe në gjimnazin e Manastirit. Leximi i veprave të letërsisë klasike dhe moderne, veçanërisht të Dostojevskit, lanë gjurmë me krijimtarinë e tij. Në 1927-1932 studion në seminarin ortodoks të Manastirit.
- ❖ Vitet e punës. Meqenëse nuk siguroi dot një bursë, vendosi të punojë dhe emërohet mësues në Vrakë dhe më pas në Pukë. Njohja me jetën e malësorëve, do të bëhej si mbështetje kryesore për krijimtarinë e tij.
- ❖ Krijimtaria. Gjatë kësaj kohe ai shkroi vjersha, tregime, skica, që i botoi në disa gazeta dhe revista të kohës.
- ❖ “Vargjet e lira” e cila përmbledhonte vetëm krijimtarinë e tij poetike, u botua në vitin 1936 dhe do të ndalohej nga censura e saj kohe. Gjatë kësaj periudhe, ai do të vazhonte të shkruante edhe proza të cilat do të botohen pas vdekjes së autorit.
- ❖ Gjendja shëndetësore. Që kur ishte në seminar ai vuante nga sëmundja e mushkërive e cila iu rëndua kur ai filloi punën në Vrakë. Gjendja e tij shëndetësore do të krijonte një ndjenjë mosbesimi për të ardhmen, e cila do të pasqyrohej edhe në krijimet e tij.

Përforsimi i mësimit: Pyetje-përgjigje - diskutim

Nxënësit diskutojnë mbi krijimtarinë e Migjenit duke iu përgjigjur pyetjeve:

Cilat ishin kultet që theu Migjeni në letërsinë shqipe?

A i theu kultet morale, politike dhe shoqërore?

Cilat ishin kushtet që ndikuan në formësimin e tij?

Pse Migjeni solli novatorizëm në letërsinë shqipe?

Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për përgatitjen shkencore dhe punën në grup

Vlerësim diagnostikues dhe motivues

Detyrat dhe puna e pavarur: Sillni në klasë ilustrime nga vepra e Migjenit ku të ilustrohen elementet novatore të veprës së tij.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Analizë: “Vargjet e lira” “Novelat e qytetit të veriut”		Situata e të nxëniet: Bisedë dhe diskutim rreth strukturës, vlerave dhe stilit.	
Rezultatet e të nxëniet sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të shprehurit dhe komunikimit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë Kompetenca e të shkruarit			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: Nxënësi/ja: - diskuton rreh rolit të Migjenit në letërsinë shqipe; - krahason krijimtarinë e tij me atë të paraardhësve; - analizon ciklin poetik duke u ndalur në tematikën e tij dhe veçoritë e stilit; - analizon “Novelat e qytetit të veriut” temat filozofinë, strukturën dhe personazhet; - vlerëson rolin e novatorizmit të Migjenit në letërsinë shqipe.		Fjalët kyçe: ▪ Poezi ▪ Personazhe reale ▪ Metrikë e lirë ▪ Novatorizëm ▪ Skica ▪ Filozofi ekzistenciale	
Burimet: ▪ Libri i nxënësit ▪ Burime nga interneti ▪ Poema “Milosao”		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Gjuha shqipe ▪ Tik ▪ Filozofi	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim - Vëzhgim - Stuhi mendimesh - Punë në grupe			
Organizimi i orës së mësimi: Hapi I - Diskutim - Lexohen detyrat e shtëpisë për ilustrimet nga vepra e Migjenit. Migjeni theu kultet në letërsinë shqipe. Kultet shoqërore Kulti i besës, i trimërisë së malësorit fisnik dhe krenar në legjenda dhe në letërsinë e mëparshme është zëvendësuar me malësorin si një qenie të përvuajtur nga uria dhe shtypja shoqërore, ku dinjiteti i tij është përlulur përpara shenjtërisë së misrit dhe “engjëjve” që e ndajnë atë. Kultet morale u thyen që në momentin ku femrat shqiptare shisnin trupin e tyre në të njëjtën mënyrë si edhe ato në			

trotuaret e Londrës dhe Parisit, familjet shqiptare humbasin nderin dhe dinjitetin prej varfërisë që buronte prej problemeve shoqërore.

Kulti fetar u shemb thellësisht, pasi zoti që lutet për parajsën në qiell, nuk shihte ferrin që jetohej në tokë dhe murgesha kalonte rrugëve të qytetit si një engjëll i arratisur dhe shihej prej autorit si një femër sensuale që i ka mohuar vetes kënaqësitë e jetës.

Kulti himnizues patriotik i letërsisë së mëparshme, himnizimi krenaria për vendin dhe flamurin, këtu është zëvendësuar me një vend ku valojnë flamujt e melankolisë.

Hapi II - Stuhi mendimesh

Nxënësit përmbledhin mendimet e tyre rreth ciklit të poezive “Vargjet e lira”.

Hapi i III - Vëzhgim

Nxënësit pasi kanë lexuar materialin në libër dhe nga kërkimet në internet, plotësojnë skedën e tekstit poetik.

Titulli	“Vargjet e lira”
Autori	Migjeni
Lloji	Cikël poezish
Struktura	Parathënia e parathënies, “Kangët e ringjalljes”, “Kangët e mjerimit”, “Kangët e përndimit”, “Kangë më vete”, “Kangët e rinisë”, “Kangët e fundit”
Ciklet e poezive	Tematika motivet
Kangët e ringjalljes	Nevojat për ndryshim, besimi në ideale, raporti midis botës shpirtërore dhe realitetit.
Kangët e mjerimit	Problemet sociale, mjerimi fizik dhe shpirtëror, revolta e njeriut kundër fatit dhe kundër padrejtësive shtetërore e ndryshimi shoqërore.
Kangët e rinisë	Pesimizmi, goditja e shpresës, mungesa e besimit tek.
Kangë më vete	Në “Kangët e rinisë” shfaqet besimi te jeta, tek e ardhmja, te rinia, te ndryshimi.
Kangët e fundit	Raporti me traditën.
	Në “Kangët e fundit” shfaqet hapur humbja e shpresës, dhimbja për fatin e tij, dhimbja si parandjenjë e vdekjes që po vjen.
Konteksti historik e letrar	Poezitë janë shkruar dhe botuar në vitet 1930-1940 në Shkodër.
Sistemi i personazheve	Personazhe nga jeta reale: lypësit, të papunët, prostitutat, intelektualët e pashpresë, njerëz të rëndomtë.
Metrika	Vargu i lirë, herë i alternuar me varg të rimuar, herë i thyer i lirë në formë dhe në përmbajtje.

Hapi i IV - Praktikë e drejtuar

Lexohet materiali mbi pjesën në prozë dhe “Novelat e qytetit të veriut”. Nxënësit përmbledhin materialin. Tematika: Raporti i individit me shoqërinë, me mentalitetin e prapambetur me moralin hipokrit të saj trajtohen në novelën “Studenti në shtëpi”. Fati tragjik i një gruaje i rimarrë prej poezisë “Baladë qytetëse” e cila për të shpëtuar një plagë të madhe, mjerimin material, hap një plagë më të madhe, mjerimin shpirtëror dhe moral, trajtohet te novela “Historia e njënës nga ato” Tronditja e thellë e marrëdhënieve familjare, prishja e familjes, qelizës bazë të shoqërisë, trajtohet te novela “Bukën tonë të përditshme falma sot”. Që familja të mbijetojë fëmija, duhet goditur vetë themeli i familjes-besnikëria bashkëshortore. Përplasja mes mendësisë së re dhe një mjedisi të prapambetur jepet te novela “Të çelen arkapijat”. E REJA pra heqja e fereheve nuk i krijon asnjë lehtësim grave, përkundrazi i mbyll më shumë ato. Hapi V - Pyetje-përgjigje - Punë në grupe Grupi I - Punohen ushtrimet 11, 12 Grupi II - Ushtrimet 13-14 Grupi III - Ushtrimet 15-16 Vlerësimi: Vlerësohen nxënësit për përgatitjen shkencore dhe të menduarit kritik si edhe organizimin e punës në grup. Detyrat dhe puna e pavarur: Ndërtoni profilin e shkrimtarit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Studim teksti “Studenti në shtëpi”		Situata e të nxënit: Studim teksti, diskutim për jetën në lëvizje të përhershme dhe mentalitetit të prapambetur.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të shprehurit dhe komunikimit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të nxënit për të mësuar Kompetenca qytetare			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - diskuton mbi temën e trajtuar në këtë novelë; - portretizon personazhet; - përshkruan marrëdhëniet brenda familjes (babë-bir, burrë-grua, motër-vëlla); - analizon fjalët kyç që realizojnë ironinë; - evidenton mesazhin e pjesës dhe e interpreton atë; - analizon gjuhën stilistike dhe figuracionin.		Fjalët kyçe: ▪ Moral hipokrit ▪ Patriarkalizëm ▪ Konservatorizëm ▪ Çmitizim i heroit ▪ Ironi	

Burimet: ▪ Libri i nxënësit ▪ Interneti ▪ Vlerësime të kritikës	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Gjuhë ▪ Tik
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Diskutim - Lexim - Shpjegim - Punë në grupe - Tabela e figurave	
Organizimi i orës së mësimit Hapi 1 - Diskutim Diskutohet detyra e shtëpisë, ku nxënësit në bazë të të dhënave të jetës dhe veprës, si edhe analizave të poezisë dhe prozë, të krijojnë profilin e shkrimtarit si një shkrimtar novator që solli risi në formë dhe në përmbajtje, i cili çmitizoi heroin dhe theu kodet morale dhe shoqërore. Hapi II - Lexim i tekstit - Diskutim Nxënësit lexojnë fragmentin të ndarë në pjesë dhe diskutojnë atë.	
Nushi kthehet nga studimet jashtë shtetit dhe deri diku ky është një motiv i njohur në letërsinë pararendëse, por nëse më parë ata idealizonin gjithçka, këtu Nushit ndjenja e malit i zëvendësohet me ndjenjën e mërzisë, sikur gjithçka nuk kishte ndryshuar, çdo gjë i dukej më e vogël. Për herë të parë figura e babait lidhet në mënyrë figurative me natën dhe ndjesia e dashurisë ishte zëvendësuar më atë të respektit për hir të zakonit dhe traditës. Migjeni i bën një analizë sociologjike familjes duke treguar se çdo veprim sjell një kundërveprim, ashtu si edhe konservatorizmi i shtrënguar dhe patriarkalizmi do të sjellin reagime të tilla siç është hipokrizia. Rregullat e kanunit, ku fisheku në pajë ishte i pashmangshëm, ia lanë vendin indiferentizmit, shkeljes hapur të moralit dhe hipokrizisë së shoqërisë. Hapi III - Punë në grupe Nxënësit do të punojnë në grupe për të nxjerrë në pah: a- kundërvënien midis botës mashkullore dhe asaj femërore, mënyrën se si trajtohen nëna dhe Age si qenie të dorës së dytë në familje dhe shoqëri. Nëse mungon liria e komunikimit në familje, atëherë ajo kthehet përditë në një farsë e cila i largon përditë më shumë nga njëri-tjetri. Superioriteti mashkullor ndaj atij femëror jepet qartë në personazhin e nënës e cila jepet pa emër, si një hije e të shoqit. b- ironia, satira, sarkazma. Shfaqen si një reagim ndaj personazheve dhe jetës së tyre. Qëndrimi kritik që Migjeni mban ndaj shoqërisë e çon atë tek ironia, me të cilën fshikullon indiferencën e saj, si edhe shpreh ndjeshmërinë ndaj plagëve të saj. c- Nxënësit e këtij grupi përcaktojnë mesazhin nisur nga klithma e Migjenit i cili i kërkon shoqërisë ndryshimin jo të formës, por të thelbit të saj, që të mos vdesë çdo ditë nga hipokrizia dhe mashtrimi i vetvetes. E interpretojnë atë në disa plane në atë njerëzor, shoqëror, historik.	

Nushi kthehet nga studimet jashtë shtetit dhe deri diku ky është një motiv i njohur në letërsinë pararendëse, por nëse më parë ata idealizonin gjithçka, këtu Nushit ndjenja e malit i zëvendësohet me ndjenjën e mërzi, sikur gjithçka nuk kishte ndryshuar, çdo gjë i dukej më e vogël. Për herë të parë figura e babait lidhet në mënyrë figurative me natën dhe ndjesia e dashurisë ishte zëvendësuar më atë të respektit për hir të zakonit dhe traditës.

Migjeni i bën një analizë sociologjike familjes duke treguar se çdo veprim sjell një kundërveprim, ashtu si edhe konservatorizmi i shtrënguar dhe patriarkalizmi do të sjellin reagime të tilla siç është hipokrizia. Rregullat e kanunit, ku fisheku në pajë ishte i pashmangshëm, ia lanë vendin indiferentizmit, shkeljes hapur të moralit dhe hipokrizisë së shoqërisë.

Hapi III - Punë në grupe

Nxënësit do të punojnë në grupe për të nxjerrë në pah:

a- kundërvënien midis botës mashkullore dhe asaj femërore, mënyrën se si trajtohen nëna dhe Age si qenie të dorës së dytë në familje dhe shoqëri. Nëse mungon liria e komunikimit në familje, atëherë ajo kthehet përditë në një farsë e cila i largon përditë më shumë nga njëri-tjetri. Superioriteti mashkullor ndaj atij femëror jepet qartë në personazhin e nënës e cila jepet pa emër, si një hije e të shoqit.

b- ironia, satira, sarkazma. Shfaqen si një reagim ndaj personazheve dhe jetës së tyre. Qëndrimi kritik që Migjeni mban ndaj shoqërisë e çon atë tek ironia, me të cilën fshikullon indiferencën e saj, si edhe shpreh ndjeshmërinë ndaj plagëve të saj.

c- Nxënësit e këtij grupi përcaktojnë mesazhin nisur nga klithma e Migjenit i cili i kërkon shoqërisë ndryshimin jo të formës, por të thelbit të saj, që të mos vdesë çdo ditë nga hipokrizia dhe mashtrimi i vetvetes. E interpretojnë atë në disa plane në atë njerëzor, shoqëror, historik.

		ku veç ftohtësisë jepet edhe një ndjenjë armiqësie dhe neverie.
	Mobiliet ishin sikur mos me i pas prekë dora e njeriut, si me pas qenë të destinueme me u kalbë...	Krahasimet e përdorura në këtë pjesë tregojnë se mungesa e ndryshimit, mungesa e guximit dhe dëshirës për ndryshim, gjithçka po e çonte drejt shkatërrimit dhe ky shkatërrim material po paraprinte një shkatërrim më të madh, atë shpirtëror.
	Mashtrimi optik	Metafora e përdorur në mënyrë racionale shpjegon ndryshimin midis dy realiteteve: atij ky jetonte Nushi dhe atij ku jetonte familja e tij.
	Nderi është shampanjë... veç ujë jo..	Ironia e përdorur brenda metaforës shpjegon qartë moralin fals të shoqërisë që shitet shtrenjtë sa për sy e faqe, i detyruar dhe sipërfaqësor, i mbuluar me shkëlqimin e rremë dhe jo si diçka e natyrshme.

Vlerësimi: Vlerësim diagnostikues dhe vlerësim motivues me notë. Nxënësit do të vlerësohen për saktësinë e njohurive shkencore, të menduarin kritik si dhe organizimin e punës në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur: Rubrika detyra dhe këshilla.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ___/___/___

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Studim teksti “Një natë pa gjumë”		Situata e të nxënit: Studim teksti, bisedë mbi dilemat e njeriut dhe pesimizmin që e pushton para vdekjes.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të folurit dhe të komunikuarit Kompetenca e të shkruarit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - diskuton mbi dilemat dhe pesimizmin e autorit në këtë poezi; - zbulon kurbën poetike nëpër të cilën kalon dilema e poetit; - analizon rolin e thirrorit për realizimin e misionit poetik; - vlerëson mesazhet e rëndësishme që përcjell autori dhe veçoritë artistike të saj.		Fjalët kyçe: ▪ Natë ▪ Dritë ▪ Pishë ▪ Burrë ▪ Gjeli ▪ Jastëk ▪ Kushtrimi ▪ Dilema	
Burimet: ▪ Libri i nxënësit ▪ Vargjet e lira ▪ Interneti ▪ Vlerësime të kritikës		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Gjuhë shqipe ▪ Tik ▪ Arte	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Prezantimi i punës - Pyetje-përgjigje - Analizë - Ditar dypjesësh			
Organizimi i orës së mësimi ❖ Hapi I - Prezantimi i detyrave të shtëpisë. Nxënësit vlerësohen për detyrat e shtëpisë. ❖ Hapi II - Lexim i drejtuar - Pyetje-përgjigje Pasi nxënësit kanë lexuar dhe interpretuar poezinë: ✓ Cila është thirrja personale dhe universale që shprehin vargjet e para të këngës? ✓ Cila veçori artistike mbizotëron në këto vargje? ✓ Pse përdoret e përsëritur shprehja “pak dritë...”? ✓ Cila është gjendja shpirtërore e poetit që mbizotëron në këto vargje? ✓ Cilat janë veçoritë stilistike që tregojnë novatorizmin e autorit? ❖ Hapi III - Analizë e poezisë			

Kjo poezi i përket ciklit të këngëve të fundit ku tashmë dëshira, shpresa për ndryshim, krijimin e një bote të re dhe shkatërrimin e botës së vjetër është shuar dhe poeti përpiket të gjejë ngushëllimin e vetëm te jastëku, ku të prehet shpirti i trupit që lëngon.

Poezia është në formën e një monologu, pavarësisht thirrjeve të përcaktuara.

Poezia është një klithje që shprehet si një thirrje universale... *pak dritë*... dhe si një thirrje e përcaktuar... o shok, o vëlla, o burrë.

Thirrja e poetit del në dy forma: **a-** thirrje për ndryshim dhe shpresë në natën e jetës shqiptare dhe të jetës personale; **b-** lutje për qetësi personale... *pak dritë vetëm mëshirë të kesh*.


Vetmia e poetit është vetmi fizike dhe shpirtërore pasi *nuk kam pranë, burrë, hero* janë ideale të perealizuara dhe... *burri i tretun* tregon rënien e tij fizike.

Simboli i pishës së ndezur është simboli i dritës për të ndriçuar shpirtin, në rrafshin personal dhe në simbol të kushtimit dhe ndryshimit.

Thirrjet dhe pasthirrat tregojnë pamundësinë e realizimit të idealit të tij dhe tregohet te përdorimi i foljeve në mënyrën kushtore... *eh ta kisha pishën të madhe dhe të ndezur*... pra gjithçka ngelet në formën e dëshirës dhe ëndrrës.

Simboli i gjelit dhe i këngës së tij është i pranishëm në disa krijime të tij dhe gjithmonë dalin me funksion ironizues si te: “Matanë gardhit asgja të re” ku gjeli këndonte mbi pleh, dhe nuk sillte asnjë shpresë. Edhe këtu kënga e gjelit simbol i ëndërrimeve, bëhet e pabesueshme pasi nënteksti i saj flet qartë notat tragjike të jetës së tij që po shuhet.

Dilemat e poetit kalon sipas një kurbe të caktuar:



❖ Hapi i IV - Punë e pavarur

Kjo rubrikë do të plotësohet me anë të ditarit dypjesësh.

Analizoni vargjet

Vargu	Komenti
Burrë që shkatërron dhe ndërton sërish	Antonimia e foljeve krijon antitezën duke shprehur më qartë idealin e poetit dhe të brezit të tij për të shkatërruar botën e vjetër dhe për të ndërtuar botën e re.
Askush s'më dëgjon çirrem kot më kot	Ai ndjen dhimbje për vetminë e tij dhe të njerëzve, sepse nuk arrin t'ua ndriçojë mendjet dhe të kthehet në një lider

	shpirtëror.
Kur ti këndon thonë se është afër drita...	Simboli i shpresës për ndryshim, por që poeti tashme i ka humbur të gjitha.
O jastëk ty të rroki, të përqafoj...	I vetmi ngushëllim i shpirtit në prag të vdekjes.
Vlerësimi: Vlerësim diagnostikues, vlerësim individual i vazhduar, vlerësim për organizimin e punës në grup	
Detyrat dhe puna e pavarur: Rubrika “Detyra dhe këshilla”	

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Dt. ____/____/____

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: V	Klasa: XI
Tema mësimore: Studim teksti: “Poema e mjerimit”		Situata e të nxënit: Nëpërmjet studimit të tekstit, nxënësi arrin të kuptojë se kështu do të rritet vizioni dhe botëkuptimi i tij për jetën.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - diskuton mbi efektet që shkakton mjerimi në jetën e njerëzve; - rendit stadet e ndryshme të mjerimit në ciklin jetësor; - analizon tonin plot mllef që përdor poeti për të realizuar kontrastin e dy botëve që bashkëjetojnë, por që janë të skajshme; - vlerëson rolin e veçantë që ka ko poemë nga tekste e mëparshme si nga ana tematike dhe nga ajo formale.		Fjalët kyçe: ▪ Mjerim fizik ▪ Mjerim shpirtëror ▪ Mjerimi moral ▪ Padituri përbuzje ▪ Revolte ▪ Uni lirik ▪ Ritmi i brendshëm ▪ Mllef	

Burimet: ▪ Libri i nxënësit ▪ Materiale nga interneti ▪ Kritika letrare etj.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Gjuhë shqipe ▪ Histori ▪ Tik
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	
Prezantim - Lexim dhe shpjegim teksti - Rrjeti i diskutimit - Praktikë e drejtuar	
Organizimi i orës së mësimi: ❖ Hapi I - Prezantimi i detyrave të shtëpisë dhe vlerësimi i tyre ❖ Hapi II - Lexim dhe shpjegim teksti Poema lexohet nga nxënësit e ndarë në pjesë. Në këtë poemë, fati i njerëzve në skamje dhe mjerim jepet në lakuriqësi të plotë, deri në detaje. Poezia është ndërtuar nëpërmjet një toni plot mllef kundër kësaj të keqeje që duhet zhdukur nga faqja e dheut, se është turp i njerëzimit. Poezia është shkruar me varg të lirë. Ritmi i brendshëm arrihet nëpërmjet figurave tingëlluese si: anafora, shkallëzim, enumeracion. Në vargjet e poemës kemi jo vetëm një përshkrim realist dhe detajues të mjerimit, por edhe ndjeshmëri të thellë të unit të brendshëm të poetit, i cili bëhet bashkëvuajtës në mjerim. <i>dhimba paduruese që të bajnë të cmendesh...</i> Poeti jo vetëm konstaton, por edhe revoltohet në këtë pasqyrë mjerimi ku e vetmja alternativë është... <i>mjerimi s'don vetëm mëshirë... por don vetëm të drejtë...</i> ❖ Hapi i III - Punë në grupe ✓ Grupi I - Analizon portretin e mjerimit. • Portreti fizi: <i>mjerimi ka vulën e vet të shëmtueme...</i> • Portreti moral: <i>mjerimi asht një njollë...</i> • Portreti shpirtëror: <i>mjerimi s'ka gëzim, por ka vetëm dhimba</i> ✓ Grupi II - Raporti shkak-pasojë, pasojat që sjell mjerimi • Padituri, përbuzje – <i>fëmitë e padijes dhe flitë e përbuzjes</i> • Shkatërrim të dashurisë mëmësore – <i>e ama se don, por vetem mallkon</i> • Shkatërron fëmijërinë dhe ëndrrat e saj – <i>mjerimi pjek fëminë para se të burrhoet</i>	

• Shkatërron vlerat dhe moralin – <i>trupin përmendore e tregtis së ndyrë</i> • Shkakton depresion – <i>t'apin litarin të shkojsh fill e të varesh.</i> ✓ Grupi III - Analizë e figurave të përdorura • Figuracioni jepet i ashpër, i lakuriqtë, si mendimet e poetit për mjerimin. • Epitetet: <i>Fytyra të zbehta dhe sy të jeshilta, skaje të errëta, stoli e kobshme</i> • Krahasime dhe similituta: <i>mishnat si zhagë, dridhet porsi flaka e qiririt</i>
• Kontrasti: <i>midis njerëzve të varfër dhe kryqet dhe minaret e ngurta</i> <i>E mbi ta n'ajri ,si në qesendi</i> <i>Therrin qiellin kryqet dhe minaret e ngurta</i> <i>Profetë dhe shënjtit në fushqeta të shumëngjurma shkëlqejnë</i> • Hiperbola: <i>me bark shekulluer gjithmonë i pangishëm</i> • Metafora, metonimia: <i>mjerimi punon, punon natë e ditë</i>
Vlerësimi: Vlerësimi i nxënësve do të jetë i motivuar, pas tri orësh studim teksti, për detyrat e shtëpisë, si edhe për argumentet në diskutimin e dhënë. Do të jetë vlerësim i vazhduar, si edhe vlerësim për punën në grup.
Detyrat dhe puna e pavarur: Rubrika “Detyra dhe këshilla”

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

Fusha: Gjuhët dhe komunikimi	Lënda: Letërsi	Shkalla: VI	Klasa: XII
Tema mësimore: Bisedë letrare “Vargjet e lira” si simbol i lirisë së mendimit dhe letërsisë së re.		Situata e të nxënit: Diskutim, reflektime, përjetime në mënyrën se si letërsia ndikon mbi përvojat e ndryshme jetësore.	
Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe: Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit Kompetenca e të menduarit Kompetenca qytetare Kompetenca e të mësuarit për të nxënë			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - diskuton mbi rolin e Migjenit në letërsinë shqipe; - argumenton përse ai është një zë i veçantë në letërsinë shqipe; - analizon kultet që theu Migjeni në letërsinë dhe në jetën shqiptare; - vlerëson novatorizmin e tij në letërsinë shqipe.		Fjalët kyçe: ▪ Çmitizim ▪ Zgjim i ndërgjegjes ▪ Novatorizëm ▪ Varg i lirë ▪ Revoltë ▪ Realizëm modern	

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore Nxënësi/ja: - diskuton mbi rolin e Migjenit në letërsinë shqipe; - argumenton përse ai është një zë i veçantë në letërsinë shqipe; - analizon kultet që theu Migjeni në letërsinë dhe në jetën shqiptare; - vlerëson novatorizmin e tij në letërsinë shqipe.	Fjalët kyçe: ▪ Çmitizim ▪ Zgjim i ndërgjegjes ▪ Novatorizëm ▪ Varg i lirë ▪ Revoltë ▪ Realizëm modern
Burimet: ▪ Tekste letrare ▪ Kritika letrare ▪ Interneti ▪ Vepra e plotë	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: ▪ Histori ▪ Gjuhë shqipe ▪ Filozofi ▪ Tik

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve


Pema e mendimeve - Diskutim - Punë në grupe

Organizimi i orës së mësimi

Kjo bisedë letrare do të zhvillohet për drejtimin e realizmit.

Hapi I - Diskutim - Stuhi mendimesh

Nxënësit do të diskutojnë mbi krijimtarinë e Migjenit, duke i përmbledhur njohuritë e tyre në skemën e mëposhtme.



❖ **Hapi II - Pyetje-përgjigje**

- Çfarë formimi arsimor mori Migjeni?
- Në ç' drejtime vlerësohet Migjeni si një zë i veçantë në letërsinë shqiptare të kohës?
- Cili është kuptimi i dyfishtë që përmban titulli?
- Në ç' raport e vendos poeti vetveten me *vulkanin e fashitun* dhe *kangët e pakëndueme*?
- Nëpër cilat shkallë kalon ideja e zgjimit të *Kangët e ringjalljes*?
- Si realizohet tema e mjerimit si realitet dhe si vuajtje personale e poetit?
- Ku e kërkon Migjeni shpresën për një jetë të re?
- Çfarë shpreh cikli *Kangët e rinisë*?
- Në ç' trajta shfaqet gruaja dhe dashuria?
- Si përshkruhet rënia shpirtërore dhe fizike e poetit të *Kangët e fundit*?

❖ **Hapi III - Praktikë e drejtuar - punë në grupe**

➤ **Grupi I - Analizoni poezinë e revoltës “Recital i malësorit”**

Është poezi e revoltës ku vargu kryesor... O si nuk kam një grusht të fuqishëm... dhe një... grusht të fortë del në dy variante si një grusht i paligjshëm për ta tronditur malin që hesht... Është një revoltë e individit që kërkon ndryshimin në kërkim të lirisht të lumturisë, të qeshjes. Thirrja këtë herë do një ndërrim të madh, kërkesë për të dalë nga statusi i trashëgimitarit të vuajtjes dhe durimit, por nga kërkesa personale, ai kalon në një kërkesë universale dhe ideale; *të lëvizë malin që hesht*. Po a mund të kuptohet malësori pa malin?

Pra në këtë këndvështrim, mali dhe malësori marrin kuptime të tjera më të thella...

➤ **Grupi II - Analizoni poezinë “Kangë skandaloze”**

Kjo poezi trajton temën e mjerimit shpirtëror. Autori e ka theksuar qartë që në titull se kjo poezi është skandaloze, sepse thyen kultin e shenjtë fetar. Figurën e murgeshës e shih jo si të shenjtë, si një shërbëtore e zotit, por si një femër sensuale me dëshira dhe pasione të fshehura dhe kjo është skandaloze. Ateizmi i tij del hapur dhe revolta e tij më e qartë se kurrë në vargun: *Mos u lut për mue se du pash më pash me i bi ferrit...*, sepse ferri i vërtetë ishte aty mbi tokë.

➤ **Grupi III- Analizoni poezinë “Baladë qytetse”**

Në këtë poezi shfaqet më dukshëm mjerimi fizik dhe shpirtëror, fati i gruas në situatat jetësore më të rënda. Sfondi i saj është vendosur natën, ku një grua si hije vallëzon një valle marrëzie nëpër rrugët e qytetit... me veshje dhe me shpirt të grisur duke gërrshetur mjerimin fizik dhe moral. Në strofën e fundit shpërthen revolta e poetit në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, por nëpërmjet figuracionit... *një za varri një jehonë nëpër rrugët e qytetit tonë...*

Vlerësimi:

Vlerësohen nxënësit për mënyrën e të nxënës të njohurive, për aftësitë e të shprehurit dhe mbi të gjitha të argumentuarit.

Detyrat dhe puna e pavarur: Mblidhni materiale rreth letërsisë shqiptare pas viteve 40' dhe ndërtoni një referat.